



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 631 Akti

Nr. 755 Vendimi
Tiranë, më 5.4.2024

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Roland Ilia	Kryesues
Genta Tafa (Bungo)	Relatore
Suela Zhegu	Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Etmonda Hoxha, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs, në datën 4.4.2024, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Luljeta Kolonja**, aktualisht gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2015, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Genta Tafa (Bungo), vlerësoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe analizoi provat shkresore të paraqitura në

vijim të rezultateve të hetimit dhe në seancë dëgjimore, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, bazuar në paragrafin 5 të nenit 179/b të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në pikën 5 të nenit 3 dhe në pikën 1 të nenit 5 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

2. Subjekti i rivlerësimit Luljeta Kolonja, aktualisht me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, është subjekt rivlerësimi, që i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

3. Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni) në datën 15.12.2020 zhvilloi procedurën e shpërndarjes me short të çështjeve në trupa gjykues, nga ku rezultoi se subjekti i rivlerësimit Luljeta Kolonja do t'i nënshtrohej procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Genta Tafa (Bungo), Roland Ilia dhe Suela Zhegu. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionerja Genta Tafa (Bungo).

4. Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 24.12.2020 u caktua me mirëkuptim kryesues z. Roland Ilia, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit.

5. Në referim të pikës 1 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për subjektin e rivlerësimit Luljeta Kolonja nisi procesi i rivlerësimit dhe hetimi i thelluar administrativ.

6. Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV, “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt vlerësimi deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të.

7. Procesi i vlerësimit të kontrollit të figurës, në përputhje me kreun V, “Kontrolli i figurës”, të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 34 të këtij ligji, ka për objekt verifikimin e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse subjekti ka/ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të përcaktuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

8. Procesi i vlerësimit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun VI, “Vlerësimi i aftësive profesionale”, të ligjit nr. 84/2016, ka për objekt vlerësimin e

veprimtarisë etike dhe profesionale të subjektit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin nr. 84/2016 dhe me legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

9. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komision janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI); Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK); Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ). Këto raporte janë administruar nga relatorja me fillimin e hetimit administrativ.

10. Në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave dërgoi raportin¹ e hollësishëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit Luljeta Kolonja. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, është konstatuar se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor për burimin financiar të pasurive;*
- *ka mosdeklarime të pasurive;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

11. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, AKSIK-ja ka dërguar raportin² për subjektin e rivlerësimit, në përfundim të të cilit ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit Luljeta Kolonja.

12. Këshilli i Lartë Gjyqësor ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor dhe, në zbatim të nenit 43 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar një raport³ të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.

13. Në vijim, relatorja e çështjes ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm mbi të tria kriteret: vlerësimi i pasurisë; kontrolli i figurës; vlerësimi i aftësive profesionale.

14. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe provat e grumbulluara për kriterin e vlerësimit të pasurisë, kontrollit të figurës dhe vlerësimit të aftësive profesionale, në datën 7.3.2024 vendosi: (i) përfundimin e hetimit kryesisht për të tria kriteret për subjektin e rivlerësimit; (ii) njoftimin e subjektit të rivlerësimit për t’u njohur me materialet e dosjes; (iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur

¹ Me shkresën nr. *** prot., datë 28.2.2018.

² Raporti nr. *** prot., datë 21.11.2017, deklasifikuar plotësisht me vendim të KDZH-së nr. ***, datë 14.10.2022.

³ Me shkresën nr. *** prot., datë 26.7.2019.

prova dhe shpjegime, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në pikën 5 të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

15. Subjekti i rivlerësimit u njoftua në datën 7.3.2024 mbi të drejtën e saj për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkonte marrjen e provave të reja ose thirrjen e dëshmitarëve lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit u njoh me aktet e dosjes në datën 11.3.2024, ndërsa në datën 24.3.2024 ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe provave të reja në përgjigje të rezultateve të hetimit.

16. Pas shqyrtimit të shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore⁴.

II. SEANCA DËGJIMORE

17. Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore publike me njoftimin e bërë elektronikisht me *email*, në datën 27.3.2024.

18. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në datën 4.4.2024, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs.

19. Subjekti i rivlerësimit Luljeta Kolonja mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur dhe parashtruar shpjegimet dhe opinionin individual në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj. Në përfundim të shpjegimeve dhe parashtrimeve, subjekti kërkoi nga Komisioni konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

20. Znj. Luljeta Kolonja ka qenë bashkëpunuese në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj, duke u përgjigjur në kohë, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ.

20.1 Subjekti i rivlerësimit ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur, ka qenë korrekte dhe e gatshme për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

21. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

⁴ Vendimi i ndërmjetëm nr. 3, datë 27.3.2023.

21.1 Referuar vendimit nr. 2/2017⁵ të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016 rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

22. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*, të dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI; (ç) deklaratat periodike të dorëzuara ndër vite dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja, të cilat gjenden në dosjen e këtij subjekti, dërguar në Komision; (d) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (dh) raportet e kontrollit të figurës të dorëzuar pranë Komisionit nga AKSIK-ja; (e) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar pranë Komisionit nga KLGJ-ja; (ë) denoncimet e publikut; (f) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të depozituara në protokollin e Komisionit apo nëpërmjet postës elektronike, si dhe ato gjatë seancës dëgjimore, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

A. VLERËSIMI I PASURISË

23. Pas marrjes së raportit të hollësishëm dhe të arsyetuar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit nga ILDKPKI-ja, u procedua me hetimin administrativ për vlerësimin e pasurisë së këtij subjekti. Hetimi i kryer nga Komisioni është përqendruar në vërtetësinë e deklarimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, si dhe burimin e ligjshëm të krijimit të këtyre pasurive.

23.1 Subjekti ka filluar detyrën në datën 21.10.2003 në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec. Në deklaratën *Vetting*, të dorëzuar në ILDKPKI në datën 26.1.2017, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë deklaruar se zotërojnë këto pasuri:

24. Tokë bujqësore⁶ e llojit arë me nr. pasurie ***, me sipërfaqe 1097 m², e ndodhur në Buçimas, Pogradec, e regjistruar në ZVRPP-në Pogradec, në emër të babait të subjektit, z. H. T. Kjo pasuri në bashkëpronësi është fituar në bazë të Aktit të Marrjes së Tokës në Pronësi nr. ***, datë 7.9.1992, dhënë për familjen e shtetasit H.A.T dhe pjesa takuese e subjektit ka qenë 1/6. Me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 30.10.2006, pasuria nr. *** është shitur për çmimin 240,000 lekë. Pjesa takuese: 1/6.

⁵ “41. Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Posaçëm i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se: “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Posaçëm i Apelit, Komisioneri Publik, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse”.

⁶ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: (i) certifikatën familjare datë 1.8.1991 të familjes T. Akti i Marrjes së Tokës në Pronësi nr. ***, datë 7.9.1992, në B, Pogradec; (ii) certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, z. k. ***. Kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 30.10.2006.

Burimi i krijimit: Akti i Marrjes së Tokës në Pronësi nr. ***, datë 7.9.1992, dhënë për familjen e shtetasit H.T.

Hetimi⁷/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni

25. Me Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi nr. ***, datë 7.9.1992, babai i subjektit, z. H.T, ka përfituar në cilësinë e kryefamiljarit dhe përfaqësuesit të familjes bujqësore parcelat e ndodhura në fshatin B, si vijon:

- nr. **, me sip. 1100 m², e llojit arë;
- nr. **, me sip. 994 m², e llojit arë;
- nr. **, me sip. 2312 m², e llojit arë;
- nr. **, me sip. 3124 m², e llojit arë.

Në total ka përfituar 7530 m².

25.1 Bazuar në certifikatën familjare datë 20.1.2017, familja e babait të subjektit në datën 1.8.1991 përbëhej nga 6 anëtarë, përfshirë edhe subjektin e rivlerësimit.

25.2 Në datën 13.4.2001, babai i subjektit është pajisur me certifikatë pronësie për tokën arë, me sipërfaqe të regjistruar 1097 m² dhe nr. pasurie ***, z. k. ***.

26. Me kontratë shitjeje nr. ***, datë 30.10.2006, anëtarët e familjes së shtetasit H.T e kanë shitur këtë pasuri për çmimin 240,000 lekë, i cili deklarohet i shlyer përpara redaktimit të kontratës, jashtë zyrës noteriale. Nga aktet e vëna në dispozicion nga ASHK Pogradec rezulton se kontratës së shitjes i është bashkëlidhur certifikata familjare e datës 20.10.2006, e cila paraqet përbërjen e familjes së kryefamiljarit H.T në këtë datë dhe jo përbërjen familjare të datës 1.8.1991.

27. Subjekti, në përgjigje të pyetësorit standard⁸, ka deklaruar: “Në datën 30.10.2006 kam marrë shumën prej 40,000 lekësh nga shitja me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 30.10.2006, të tokës bujqësore të llojit arë, me nr. pasurie ***, e ndodhur në B, Pogradec”.

27.1 Subjekti i ka bashkëlidhur përgjigjes së saj praktikën e shitjes së pasurisë, ku evidentohet mandatar-këtimi nr. ***, datë 22.11.2006, përmes të cilit shtetasi H.T ka arkëtuar vlerën 1,200 lekë si tatim i shitjes së pasurisë së paluajtshme, si dhe mandatar-këtimin nr. ***, datë 22.11.2006, përmes të cilit blerësi B.K ka paguar vlerën 2,750 lekë për kalimin e pronësisë dhe pajisjen me dokumentacion pronësie.

28. Në përfundim të hetimit, konkludohet se nuk lindin dyshime apo paqartësi në lidhje me këtë pasuri të subjektit. Subjekti ka kryer deklarim të saktë dhe në përputhje me ligjin.

29. Tokë bujqësore⁹ në bashkëpronësi, e llojit arë, me nr. pasurie **, me sipërfaqe 1004 m², ndodhur në B, Pogradec, e regjistruar në ZVRPP-në Pogradec në emër të babait të subjektit, z. H.T. Kjo pasuri është fituar në bazë të Aktit të Marrjes së Tokës në Pronësi nr. ***, datë 7.9.1992, dhënë për familjen e shtetasit H.A.T dhe pjesa takuese e subjektit ka qenë 1/6. Me

⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 28.1.2021, drejtuar ASHK-së; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 17.2.2021, e ASHK Drejtoria Vendore Pogradec.

⁸ Pasuria është deklaruar rregullisht në deklaratat periodike vjetore.

⁹ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: (i) certifikatë familjare datë 1.8.1991; (ii) Akti i Marrjes së Tokës në Pronësi nr. ***, datë 7.9.1992; (iii) certifikatë për vërtetim pronësie nr. **, z. k. ***. Harta treguese e regjistrimit. Kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 8.1.2010.

kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 8.1.2010, pasuria nr. ***, me sipërfaqe 1004 m², është shitur. Çmimi i shitjes: 620,000 lekë.

Burimi i krijimit: Akti i Marrjes së Tokës në Pronësi nr. ***, datë 7.9.1992.

Hetimi¹⁰/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni

30. Në datën 13.4.2001, babai i subjektit është pajisur me certifikatë pronësie për tokën arë, me sipërfaqe të regjistruar 1004 m² dhe nr. pasurie ***, z. k. ***. Me kontratë shitjeje nr. ***, datë 8.1.2010, pasuria është shitur për çmimin 620,000 lekë, i cili deklarohet i shlyer përpara redaktimit të kontratës, jashtë zyrës noteriale.

30.1 Nga aktet e vëna në dispozicion nga ASHK Pogradec rezulton se kontratës së shitjes i është bashkëlidhur certifikata familjare e datës 7.1.2010, e cila paraqet përbërjen e familjes së kryefamiljarit H.T në këtë datë dhe jo përbërjen familjare të datës 1.8.1991. Sipas kësaj certifikate, anëtarët e familjes së kryefamiljarit H.T janë L e M.T.

30.2 ASHK Pogradec ka vënë në dispozicion pasqyrën llogaritëse të tatimit për kalimin e të drejtës së pronësisë, nga ku rezulton se tatimi për t'u paguar për shitjen e realizuar është në vlerën 45,740 lekë. Referuar mandatarëkëtimin nr. ***, datë 14.1.2010, të depozituar nga subjekti në përgjigje të pyetësorit standard, rezulton se kjo vlerë është paguar nga shtetasi H. T.

30.3 Subjekti, në përgjigje të pyetësorit standard¹¹, ka deklaruar: *“Në datën 8.1.2010 kam marrë shumën prej 103,000 lekësh nga shitja me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 8.1.2010, të tokës bujqësore të llojit arë, me nr. pasurie ***, e ndodhur në B, Pogradec”*.

30.4 Bazuar në këtë deklaram të subjektit, Komisioni ka përfshirë në analizën financiare vlerën 103,000 lekë të përfituar nga subjekti i rivlerësimit si anëtare e familjes bujqësore e babait të saj H.T, me 1/6 pjesë takuese.

31. Në përfundim të hetimit, konkludohet se nuk lindin dyshime apo paqartësi në lidhje me këtë pasuri të subjektit. Subjekti ka kryer deklaram të saktë dhe në përputhje me ligjin.

32. Tokë bujqësore¹² e llojit arë, me nr. pasurie ***, me sipërfaqe 2312 m², ndodhur në B, Pogradec, e regjistruar në ZVRPP-në Pogradec në emër të babait të subjektit, z. H.T. Kjo pasuri është fituar në bazë të Aktit të Marrjes së Tokës në Pronësi nr. ***, datë 7.9.1992, dhënë për familjen e shtetasit H.A.T dhe pjesa takuese e subjektit ka qenë 1/6. Në këtë pasuri ku subjekti gëzonte të drejtën e bashkëpronësisë, ndodhej një shtëpi banimi njëkatëshe, me sipërfaqe ndërtimi 244 m², në proces legalizimi, e ndërtuar në vitin 1998 me kontributin e prindërve të subjektit dhe pjesëtarëve të tjerë të familjes të babait të saj. Pasuria nr. ***, me sipërfaqe 2312 m², në të cilën ishte shtëpia e banimit njëkatëshe, është shitur me kontratën e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 17.3.2011. Pjesa takuese: 1/6.

Burimi i krijimit: Akti i Marrjes së Tokës në Pronësi nr. ***, datë 7.9.1992.

¹⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 28.1.2021, drejtuar ASHK-së; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 17.2.2021, e ASHK Drejtoria Vendore Pogradec.

¹¹ Pasuria është deklaruar rregullisht në deklaratat periodike.

¹² Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: (i) certifikatë familjare datë 1.8.1991, e familjes T; (ii) Akti i Marrjes së Tokës në Pronësi nr. ***, datë 7.9.1992; (iii) certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, z. k. ***, (iv) kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 17.3.2011; (v) shkresë nr. *** prot., datë 24.10.2016, e Drejtorisë së ALUIZNI-t Korçë.

Hetimi¹³/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni

33. Në datën 15.2.2000, babai i subjektit është pajisur me certifikatë pronësie për tokën arë, me sipërfaqe të regjistruar 2312 m² dhe nr. pasurie ***, z. k. ***.

34. Me kontratë shitjeje nr. ***, datë 17.3.2011, pasuria është shitur për çmimin 5,000,000 lekë, i cili deklarohet i shlyer në zyrën noteriale në datën e lidhjes së kontratës. Nga aktet e vëna në dispozicion nga ASHK Pogradec rezulton se kontratës së shitjes i është bashkëlidhur certifikata familjare e datës 17.1.2011, e cila paraqet përbërjen e familjes së kryefamiljarit H.T në këtë datë dhe jo përbërjen familjare të datës 1.8.1991. Sipas kësaj certifikate, anëtarë të familjes së kryefamiljarit H.T janë L e M.T.

34.1 Në përmbajtje të kontratës së shitjes evidentohet se mbi këtë tokë arë nga ana e palës shitëse është ndërtuar një shtëpi njëkatëshe, e cila është në proces legalizimi dhe shitësit janë dakord që ajo të priset dhe të ndërpresin veprimet administrative për legalizimin e saj. Shitësit deklarojnë se në çmimin e shitjes përfshihet edhe vlera e shtëpisë së banimit.

35. Në DPV-në e vitit 2011, subjekti ka deklaruar: *“Pasuria nr. *** tokë arë, e ndodhur në fshatin B, Pogradec, me sip. 2312 m², në të cilën ishte një shtëpi e formës njëkatëshe në proces legalizimi, është shitur me kontratën e shitblerjes datë 17.3.2011. Çmimi i shitjes 5,000,000 lekë. Pjesa takuese 1/5”*. Në këtë deklaram periodik subjekti ka deklaruar gjithashtu gjendje cash 1,000,000 lekë, e krijuar nga shitja e pasurisë nr. ***.

35.1 Në lidhje me këtë shitje, në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti ka deklaruar: *“Në datën 17.3.2011 kam marrë shumën prej 1,000,000 lekësh nga shitja me kontratën e shitblerjes datë 17.3.2011 të tokës bujqësore, e llojit arë me nr. pasurie ***, e ndodhur në B, Pogradec. Kjo shumë pas realizimit të kontratës së shitjes më është dhënë nga ana e prindërve të mi”*.

35.2 Subjekti i ka bashkëlidhur përgjigjes së saj “Pasqyrën llogaritëse të tatimit për kalimin e të drejtës së pronësisë”, sipas së cilës tatimi për t’u paguar është 462,549 lekë.

35.3 Subjekti ka bashkëlidhur gjithashtu mandatin e depozitimit në arkë datë 18.3.2011 nga Tirana Bank, përmes të cilit shtetasi H.T ka paguar vlerën 462,550 lekë, me përshkrimin “Tatim shitjeje ZVRPP”.

36. Komisioni ka evidentuar se në kontratën e shitjes së pasurisë nr. *** mungon nënshkrimi i subjektit të rivlerësimit por, pavarësisht këtij fakti, subjekti ka deklaruar se ka përfituar 1,000,000 lekë nga shitja e kësaj pasurie, vlerë e cila përkon me 1/5 pjesë takuese të vlerës totale të shitjes së pasurisë.

37. E pyetur në lidhje me këtë konstatim, në përgjigje të pyetësorit nr. 1, subjekti ka deklaruar: *“...referuar praktikës noteriale të noterit që ka hartuar kontratën e shitblerjes, shitja e tokës bujqësore prej 2312 m² është kryer bazuar në gjendjen familjare të kryefamiljarit H.T në kohën e shitjes, ku në këtë kohë unë nuk isha në përbërjen familjare të babait tim H.T, për shkak të martesës sime në datën 8.10.2007... Për shkak të marrëdhënieve shumë të mira dhe mirëkuptimit me familjarët, prindërit, motrat dhe vëllain, bashkëpronarë në pasurinë nr. ***, në kushtet e nevojës time për t’u strehuar në një banesë më të mirë, pasi jetoja në një banesë të vjetër të bashkëshortit, në bashkëpronësi me familjarët e tjerë të bashkëshortit, u ra dakord*

¹³ Shkresë nr. *** prot., datë 28.1.2021, drejtuar ASHK-së; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 17.2.2021, e ASHK Drejtoria Vendore Pogradec.

që unë të merrja 1/5 pjesë të çmimit të shitjes së pasurisë, në vlerën 1,000,000 (një milion) lekë, shumë të cilën më pas e përdora për porosinë e apartamentit të banimit ku jetoj aktualisht”.

38. Bashkëlidhur përgjigjes së saj, subjekti ka paraqitur:

- deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 21.7.2021, e deklaruës M.T, e cila deklaron se subjekti ka përfituar nga shitja e tokës bujqësore shumë 1,000,000 lekë;
- deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 7.8.2021, e deklaruës A.T, e cila deklaron se subjekti ka përfituar nga shitja e tokës bujqësore shumë 1,000,000 lekë;
- deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 14.9.2023, e deklaruësve H.T dhe F. T, të cilët deklarojnë se subjekti ka përfituar nga shitja e tokës bujqësore shumë 1,000,000 lekë;
- certifikatë vdekjeje datë 13.9.2023, lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile, Njësia Administrative B, Pogradec;
- vërtetim datë 16.9.2023 i noterit publik Th.B, i cili deklaron se në përpilimin e kontratave të shitjes së pasurisë së paluajtshme të llojit tokë bujqësore janë mbajtur parasysh kërkesat e ligjit nr. 8337, datë 30.4.1998, “Për kalimin në pronësi të tokës bujqësore, pyjore, livadheve dhe kullotave”. Në bazë të nenit 5 të këtij ligji në përcaktimin e anëtarëve të familjes, që përbëjnë familjen bujqësore, merret parasysh gjendja aktuale e familjes bujqësore. Për këtë arsye, kërkohet që kontratës t’i bashkëngjitet si dokument certifikata e përbërjes familjare, që vërteton se cilët janë anëtarët e familjes në çastin e përpilimit të kontratës. Edhe në rastin e përpilimit të kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 17.3.2011, ka marrë parasysh kërkesat e nenit 5 të ligjit nr. 8337, datë 30.4.1998, për të përcaktuar anëtarët e familjes bujqësore.

39. Nga hetimi i Komisionit në lidhje me llogaritë bankare të babait dhe vëllait të subjektit, ka rezultuar se:

- a. Nga nxjerrja e llogarisë së vëllait të subjektit në Raiffeisen Bank konstatohen dy depozitime:
 - në datën 17.3.2011 (e cila përkon me kontratën e shitjes së tokës bujqësore), në shumë 12,365,000 lekë, si burim janë deklaruar të ardhurat nga shitja e tokave dhe emigracioni;
 - në datën 25.3.2011, në shumë 2,000,000 lekë, si burim janë deklaruar të ardhura nga shitja e tokës bujqësore.
- b. Nga nxjerrja e llogarisë së babait të subjektit në Tirana Bank konstatohet një depozitim në shumë 3,000,000 lekë, në datën 6.4.2011, me burim të deklaruar shitje pasurie tokë.

39.1 Në total, në periudhën 25.3.2011 – 6.4.2011, vëllai dhe babai i subjektit kanë depozituar shumë 5,000,000 lekë, e cila korrespondon me vlerën e shitjes së pasurisë objekt verifikimi.

39.2 Në lidhje me këtë konstatim subjekti, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, ka deklaruar se familjarët e saj i kanë dhënë shumë 1,000,000 lekë prej gjendjes *cash* të marrë nga shitja e pasurisë nr. ***, ndërsa depozitimet në bankë janë bërë nga ana e tyre pasi i kanë dhënë këtë shumë.

39.3 Në lidhje me këtë shumë, nëse mbledhim të ardhurat nga shitja e tokave bujqësore, duket se vëllai dhe babai i subjektit kanë pasur të ardhura për të depozituar shumë 5,000,000 lekë.

Në lidhje me objektin e ndërtuar mbi këtë pasuri

40. Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar se objekti shtëpi mbi pasurinë nr. *** është ndërtuar në vitin 1998 me kontributin e prindërve dhe pjesëtarëve të tjerë të familjes të babait të saj. Bashkëlidhur deklaratës *Vetting* subjekti ka paraqitur shkresën e Drejtorisë së ALUIZNI-t Korçë, nga përmbajtja e së cilës rezulton se në datën 14.2.2005 shtetasi H.T ka dorëzuar pranë kësaj Drejtorie formularin e vetëdeklarimit për legalizimin e objektit 1-katësh banesë + garazh, me sip. 244 m², të ndërtuar në pronën e tij private. Në këtë vetëdeklarim babai i subjektit ka deklaruar si vijon:

- viti i ndërtimit 1998, funksioni i objektit banesë + garazh;
- sipërfaqe e zënë 2313 m²;
- sipërfaqe ndërtimi 244 m²;
- koeficienti i shfrytëzimit të truallit 5%;
- numri i kateve mbi tokë 1 kat, nën tokë 0 kat;
- kushte të tjera (do të ndërtojë një kat tjetër).

41. Referuar ortofotove të fotografimeve ajrore, të vëna në dispozicion nga ASIG-u¹⁴, duket se në ortofotot e viteve 2001, 2007, 2016 dhe 2019, mbi pasurinë arë pozicionohet një objekt ndërtimor, i cili nuk duket të ketë pësuar ndryshime nga njëri vit i fotografimit në tjetrin.

42. Në lidhje me koston e ndërtimit të këtij objekti, si dhe të ardhurat e familjarëve të saj, të cilat kanë mundësuar ndërtimin e objektit, në përgjigje të pyetësorit nr. 1 subjekti ka deklaruar: *“Lidhur me koston e ndërtimit të banesës, si dhe shpenzimet përkatëse të çdo viti, babai im nuk disponon asnjë lloj dokumentacioni provues, kjo për shkak të kohës shumë të largët të ndërtimit. Referuar deklaratimeve të babait tim, banesa ka filluar të ndërtohet në muajt e verës të vitit 1997 dhe ka përfunduar ndërtimi në vitin 1998. Po referuar deklaratimeve të babait tim, pjesa më e madhe e materialeve për ndërtimin e banesës janë siguruar në vitin 1997 dhe kostoja totale e ndërtimit të banesës ka qenë rreth 1,300,000 (një milion e treqind mijë) lekë.*

*I vetmi dokumentacion që ekziston për banesën e ndërtuar në pasurinë nr. *** është praktika dokumentare që disponon ish-ALUIZNI, aktualisht ASHK Drejtoria Vendore Pogradec, ku ndodhen vetëdeklarimi për legalizim i vetëdeklaruesit H.T, certifikata familjare, datë 8.2.2005, certifikata për vërtetim pronësie datë 15.2.2000, mandatarkëtimi nr. **, datë 4.2.2005, praktikë e cila më është vënë në dispozicion me shkresën nr. *** prot., datë 12.9.2023, të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Pogradec”.*

42.1 Në lidhje me burimin, subjekti ka deklaruar se ka shërbyer shitja e shtëpisë së mëparshme dhe të ardhurat nga pensioni i prindërve të saj.

43. Bashkëlidhur përgjigjes së saj, subjekti ka paraqitur:

- vërtetimin nr. *** prot., datë 12.9.2023 dhe tabelën përmbledhëse nga DRSSH Korçë;
- vërtetimin nr. *** prot., datë 12.9.2023 dhe tabelën përmbledhëse nga DRSSH Korçë.

44. Komisioni në lidhje me këtë pasuri ka kryer një analizë financiare¹⁵ për ndërtimin e pasurisë banesë në Pogradec, duke iu referuar EKB-së dhe duke konsideruar koston e ndërtimit për vitin 1998, në vlerën 20,715 lekë/m². Nga analiza financiare duket se prindërit e subjektit nuk kanë pasur të ardhura të mjaftueshme për krijimin e kësaj pasurie në shumën -1,669,057.34 lekë, por duke marrë në konsideratë:

¹⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 27.4.2023; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 4.5.2023, e ASIG-ut.

¹⁵ Për më shumë detaje shihni tabelë nr. 1 të rezultateve të hetimit.

- i. moshën e subjektit në kohën e ndërtimit të kësaj pasurie;
- ii. faktin se kjo pasuri nuk ka qenë një pasurie e krijuar me kontributin apo në pronësi të subjektit;
- iii. subjekti nuk ka qenë në detyrë në kohën e krijimit të kësaj pasurie,

- Komisioni vlerëson se subjekti nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi, apo që ky rezultat negativ të konsiderohet në vlerësimin e kriterit të pasurisë, si dhe nuk mund të shërbejë si shkak për marrjen e masës disiplinore ndaj subjektit të rivlerësimit.

45. Në përfundim të hetimit, konkludohet se nuk lindin dyshime apo paqartësi në lidhje me këtë pasuri të subjektit. Subjekti ka kryer deklaram të saktë dhe në përputhje me ligjin.

46. Tokë bujqësore¹⁶ në bashkëpronësi, e llojit arë, me nr. pasurie ***, me sipërfaqe 3120 m², ndodhur në B, Pogradec, e regjistruar në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Pogradec në emër të babait të subjektit, z. H.T. Kjo pasuri është fituar në bazë të Aktit të Marrjes së Tokës në Pronësi nr. ***, datë 7.9.1992, dhënë për familjen e shtetasit H.A.T dhe pjesa takuese e subjektit ka qenë 1/6. Me kontratën e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 24.10.2013, pasuria nr. ***, me sipërfaqe 3120 m², është shitur. Çmimi i shitjes: 624,000 lekë.

Burimi i krijimit: Kjo pasuri është fituar në bazë të Aktit të Marrjes së Tokës në Pronësi nr. ***, datë 7.9.1992.

Hetimi¹⁷/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni

47. Në datën 13.4.2001, babai i subjektit është pajisur me certifikatë pronësie për tokën arë, me sipërfaqe të regjistruar 3120 m² dhe nr. pasurie ***, z. k. ***. Me kontratë shitjeje nr. ***, datë 24.10.2013, pasuria është shitur për çmimin 624,000 lekë, i cili deklarohet i shlyer para redaktimit të kontratës, jashtë zyrës së noterisë. Nga aktet e vëna në dispozicion nga ASHK Pogradec rezulton se kontratës së shitjes i është bashkëlidhur certifikata familjare e datës 17.1.2011, e cila paraqet përbërjen e familjes së kryefamiljarit H.T në këtë datë dhe jo përbërjen familjare të datës 1.8.1991.

48. Subjekti, në përgjigje të pyetësorit standard¹⁸, ka deklaruar: *“Në datën 24.10.2013 kam marrë shumën prej 104,000 lekësh nga shitja me kontratën e shitblerjes datë 24.10.2013, të tokës bujqësore të llojit arë me nr. pasurie ***, e ndodhur në B, Pogradec”*.

48.1 Subjekti i ka bashkëlidhur përgjigjes së saj pasqyrën llogaritëse të tatimit për kalimin e të drejtës së pronësisë nga ZVRPP Pogradec, sipas së cilës vlera e tatimit për t’u paguar për këtë transaksion është zero lekë.

48.2 Komisioni ka përfshirë në analizën financiare vlerën 104,000 lekë, të përfituar nga subjekti i rivlerësimit si anëtare e familjes bujqësore e babait të saj H.T, me 1/6 pjesë takuese.

49. Në përfundim të hetimit, konkludohet se nuk lindin dyshime apo paqartësi në lidhje me këtë pasuri të subjektit. Subjekti ka kryer deklaram të saktë dhe në përputhje me ligjin.

¹⁶ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: (i) certifikatë familjare datë 1.8.1991; (ii) Akti i Marrjes së Tokës në Pronësi nr. ***, datë 7.9.1992; (iii) certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, z. k. ***. Harta treguese e regjistrimit; (iv) kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 24.10.2013.

¹⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 28.1.2021, drejtuar ASHK-së; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 17.2.2021, e ASHK Drejtoria Vendore Pogradec.

¹⁸ Pasuria është deklaruar rregullisht në deklaratat periodike vjetore.

50. Automjet¹⁹ tip “Fiat Bravo”, blerë në vitin 2005 me të ardhurat nga paga. Për automjetin është paguar vlera e zhdoganimit sipas deklaratës së zhdoganimit datë 7.6.2005. Automjeti është hequr përfundimisht nga qarkullimi nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit të Transportit Rrugor Korçë, në datën 14.12.2015, për arsye jashtë përdorimi. Çmimi i blerjes: 200,000 lekë. Vlera e zhdoganimit: 152,896 lekë. Pjesa takuese: 100%.

Burimi i krijimit: Blerë në vitin 2005 me të ardhurat nga paga.

Hetimi²⁰/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni

51. Me kontratë shitblerjeje automjeti nr. ***, datë 2.6.2005, subjekti i rivlerësimit ka blerë automjetin tip “Fiat Bravo”, vit prodhimi 1996, me targë PG *** B, për çmimin 200,000 lekë²¹, vlerë e cila deklarohet e likuiduar jashtë zyrës noteriale. Referuar deklaratës doganore Import 4, vlera e zhdoganimit është 152,896 lekë, e cila është paguar në datën 7.6.2005 me urdhërderdhjen nr. ***, në Raiffeisen Bank. Në total, për blerjen e këtij automjeti subjekti ka paguar vlerën 352,896 lekë. Referuar vërtetimit nr. *** prot., datë 14.12.2015, “Për heqjen e përhershme të mjetit nga qarkullimi”, ky automjet është hequr përfundimisht nga qarkullimi në datën 14.12.2015, për arsye jashtë përdorimi.

52. Komisioni ka kryer një analizë financiare²² për mundësinë e subjektit dhe personave të lidhur me të për blerjen e automjetit tip “Fiat Bravo”, në vlerën totale 352,896 lekë. Nga analiza financiare rezulton se subjekti ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për blerjen e këtij automjeti.

53. Në përfundim të hetimit, konkludohet se nuk lindin dyshime apo paqartësi në lidhje me këtë pasuri të subjektit. Subjekti ka kryer deklaram të saktë dhe në përputhje me ligjin, si dhe ka pasur të ardhura të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie.

54. Apartament²³ banimi me sipërfaqe 127 m², i ndodhur në Pogradec, Lagjja Nr. *, rruga “A.X”, porositur sipas kontratës së sipërmarrjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 2.10.2012. Apartamenti i banimit nuk është regjistruar në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme. Pagesat për porosinë e apartamentit janë kryer nga subjekti dhe bashkëshorti. Vlera: 6,000,000 lekë. Pjesa takuese: 50%.

Burimi i krijimit i deklaruar nga subjekti: *“Burimi i të ardhurat për pagesat e kryera nga ana ime, në gjendje cash në masën 1,000,000 lekë, si dhe kursimet nga paga për periudhat janar – shtator 2012 dhe janar – maj 2013, në masën 405,500 lekë”.*

¹⁹ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: (i) kontratë shitjeje nr. ***, datë 2.6.2005; (ii) deklaratë doganore datë 7.6.2003, në vlerën 152,195 lekë; urdhër derdhjeje në Raiffeisen Bank, datë 7.6.2003, nga znj. Luljeta Kolonja, për zhdoganim në vlerën 153,202 lekë; (iii) leje qarkullimi të mjetit me targë PG *** B; (iv) vërtetim nr. ***prot., datë 14.12.2015, nga DRSHTR Korçë.

²⁰ Shkresë nr. *** prot., drejtuar DPSHTRR-së; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 17.2.2021, e DPSHTRR-së.

²¹ Referuar përmbajtjes së deklaratës doganore Import 4, vlera statistikore e mjetit është 202,000 lekë.

²² Shihni tabelën nr. 2 të rezultateve të hetimit.

²³ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: (i) kontratë sipërmarrjeje nr. ***, datë 2.10.2012; (ii) njoftim debitimi datë 2.10.2012 në Raiffeisen Bank, në shumën 1,255,500 lekë. Depozitim në llogari personale datë 2.10.2012, Raiffeisen Bank. Depozitim në llogari personale datë 8.5.2013, Raiffeisen Bank, në vlerën 150,000 lekë. (iii) njoftim debitimi datë 8.5.2013 në Raiffeisen Bank, në shumën 150,000 lekë; (iv) njoftim debitimi datë 5.3.2013 në Raiffeisen Bank, në shumën 200,000 lekë; (v) urdhërpaguesë datë 3.10.2012, në Union Bank; (vi) urdhërpaguesë datë 28.1.2013, në Union Bank; (vii) aktmarrëveshje nr. ***, datë 25.10.2016 dhe datë 25.10.2016.

Burimi i krijimit i deklaruar nga bashkëshorti i subjektit: *“Të ardhurat për pagesat e kryera nga ana ime janë pakësimi i llogarive bankare në Union Bank, në datën 2.10.2012, me 12,500 euro, konvertuar në 1,746,250 lekë; pakësimi i llogarisë bankare tek Union Bank, në datën 25.1.2013, me 13,650 euro, konvertuar në 1,902,810 lekë; si dhe pakësimi i gjendjes cash në masën 2,000 USD, në shumën 200,000 lekë, në datën 1.3.2013”.*

Hetimi²⁴/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni

55. Me kontratë sipërmarrjeje nr. ***, datë 2.10.2012, bashkëshorti i subjektit ka porositur nga shoqëria “L” sh.p.k. apartament banimi me sip. 127 m², në objektin e ndodhur në Lagjen nr. *, rruga “A.X”, Pogradec. Referuar përmbajtjes së kësaj kontrate, afati i përfundimit të punimeve nga shoqëria sipërmarrëse është data 30.5.2013.

55.1 Çmimi është 6,000,000 lekë dhe do të paguhet në këto afate:

- Në datën 2.10.2012 do të paguhet shuma 3,000,000 lekë.
- Në momentin e përfundimit të instalimeve elektrike dhe hidraulike do të paguhet shuma 2,400,000 lekë.
- Diferenca e çmimit prej 600,000 lekësh do të paguhet nga blerësi në çastin e regjistrimit të apartamentit pranë ZVRPP-së Pogradec dhe redaktimit të kontratës së shitblerjes. Matjet e sipërfaqes do të kryhen në përfundim të ndërtimit të apartamentit.

56. Në datën 25.10.2016 është nënshkruar aktmarrëveshja nr. ***, datë 25.10.2016. Në përmbajtje të kësaj aktmarrëveshjeje palët deklarojnë se në bazë të kontratës së sipërmarrjes duhet të kryente të gjitha punimet për ndërtimin e apartamentit, por në marrëveshje mes tyre sipërmarrësi ka lejuar që një pjesë e punimeve dhe materialeve të kryhen dhe blihen nga vetë porositësi. Materialet e blera nga porositësi janë llogaritur me koston e ndërtimit dhe janë në vlerën totale 357,000 lekë. Kjo vlerë është zbritur nga diferenca e çmimit prej 750,000 lekësh që ka mbetur për t’u paguar.

57. Me kontratë shitjeje nr. ***, datë 6.9.2017, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj kanë finalizuar transaksionin e blerjes së apartamentit nga shoqëria “L” sh.p.k.

58. Referuar të dhënave të vëna në dispozicion nga FSHU-ja, rezulton se në emër të shtetasit G.K rezulton kontratë e hapur në datën 27.12.2013. Sipas dokumentacionit që i bashkëlidhet përgjigjes së FSHU-së, rezulton se kërkesa për hapjen e kontratës në datën 27.12.2013 është bërë nga shtetasi L.H, administrator i shoqërisë ndërtuese. Ndërsa, në datën 13.3.2015, me kërkesën nr. *** prot., është bërë ndryshimi i klientit në emër të shtetasit G.K.

59. Në lidhje me gjendjen e konfliktit të interesit, Komisioni ka administruar informacion²⁵ nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec. Në përgjigjen e saj, Gjykata informon se nga verifikimet

²⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 27.4.2023, drejtuar ASHK Drejtoria Vendore Pogradec; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 2.5.2023, e ASHK Drejtoria Vendore Pogradec; shkresë nr. *** prot., datë 28.1.2021, drejtuar FSHU-së; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 5.2.2021, e FSHU-së; shkresë nr. *** prot., datë 27.4.2023, drejtuar FSHU-së; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 5.5.2023, e FSHU-së; shkresë nr. *** prot., datë 28.1.2021, drejtuar UKT-së, UKK-së dhe UKP-së; shkresë kthim përgjigjeje nr. k-*** prot., datë 9.2.2021, e UKT-së; shkresë kthim përgjigjeje nr. ** prot., datë 8.2.2021, e UKK-së; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 11.2.2021, e UKP-së; shkresë nr. *** prot., datë 27.4.2023, drejtuar UKP-së; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 19.5.2023, e UKP-së.

²⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 27.4.2023, drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 11.5.2023, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec.

e kryera rezulton se subjekti ka gjykuar çështjen civile, me kërkues shoqërinë “L” sh.p.k., me objekt “Lëshimin e urdhrin të ekzekutimit për vendimin nr. **, datë 8.1.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, për shpenzimet gjyqësore”.

59.1 Me vendimin nr. (**) – **, datë 16.3.2016, subjekti ka vendosur pranimin e kërkesës dhe lëshimin e urdhrin të ekzekutimit për titullin ekzekutiv “vendim gjyqësor”, për pikën e dispozitivit lidhur me shpenzimet gjyqësore në ngarkim të paditësit, i cili detyrohet të paguajë në favor të të paditurit “L” sh.p.k. shumën prej 40,000 lekësh, si shpenzime për ndihmën juridike me avokat. Në lidhje me këtë gjykim, subjekti, në përgjigje të pyetëorit nr. 1, ka sqaruar se ka natyrën e një gjykimi gracioz, pa palë kundërshtare.

60. Për sa më sipër, duket se subjekti ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit bazuar në nenin 72 të Kodit të Procedurës Civile dhe neneve 3 dhe 5 të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, pasi ka gjykuar një çështje, ndërkohë që i detyrohej kërkuesit shumën 393,000 lekë, si dhe ishte ende në marrëdhënie interesi, për sa kohë nuk ishte lidhur ende kontrata e shitblerjes për apartamentin. Në lidhje me këtë konstatim, subjektit i janë kërkuar shpjegime.

61. Subjekti, pas dërgimit të rezultateve të hetimit, ka sqaruar se ka qenë harresë pjesëmarrja në gjykimin e çështjes civile, me kërkues shoqëria “L” sh.p.k., me objekt “Lëshimin e urdhrin të ekzekutimit për vendimin nr. **, datë 8.1.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, për shpenzimet gjyqësore”, harresë e shkaktuar nga ngarkesa e çështjeve që ka pasur për shqyrtim në mars të vitit 2016, kjo sipas kalendarit të planifikimit të gjykimeve të këtij muaji. Përpos kësaj rrethane, gjykimi për lëshimin e urdhrin të ekzekutimit ka natyrën e një gjykimi gracioz, pa palë kundërshtare dhe subjekti në këtë gjykim ka zbatuar ligjin procedural civil, nenet 510/2/a dhe 511/1 të Kodit të Procedurës Civile, ku vetëm ka verifikuar nëse vendimi gjyqësor nr. **, datë 8.1.2015, për të cilin kërkohet lëshimi i urdhrin të ekzekutimit, ishte i formës së prerë dhe nëse përmbante detyrim. Gjithashtu, shumën e shpenzimeve për ndihmën juridike me avokat, e cila duhej të ekzekutohej në mënyrë të detyrueshme në favor të shoqërisë “L” sh.p.k., nëpërmjet lëshimit të urdhrin të ekzekutimit, ka qenë në një vlerë të vogël prej 40,000 lekësh.

62. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson se ajo ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit, por duke marrë në konsideratë:

- a. llojin e gjykimit, i cili është një gjykim pa palë, si dhe ka të bëjë thjesht me lëshimin e urdhrin të ekzekutimit;
- b. faktin që ky është vetëm një rasti i izoluar;
- c. vlerën e ulët të vendimit për të cilin është kërkuar lëshimi i urdhrin të ekzekutimit;
- d. jurisprudencën e Kolegjit²⁶,

– vlerëson se ky rast nuk është i mjaftueshëm sa të konsiderohet se subjekti ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë në atë nivel për të aplikuar nenin 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, apo të përbëjë shkak autonom për marrjen masën disiplinore ndaj saj.

Në lidhje me burimin e të ardhurave për blerjen e këtij apartamenti

²⁶ Vendim nr. 42/2022.

63. Komisioni ka hetuar dhe kryer një analizë të hollësishme për burimin e të ardhurave për pagesat e kryera nga vetë subjekti i rivlerësimit, në vlerën totale 1,405,500 lekë.

63.1 Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar se burimi i të ardhurave të saj, të cilat kanë mundësuar kryerjen e pagesave për blerjen e apartamentit, përbëhet nga:

a. Gjendja *cash* në vlerën 1,000,000 lekë, e krijuar nga shitja e pasurisë nr. *** me anë të kontratës së shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 17.3.2011. Kursimet nga paga për periudhën janar – shtator 2012, në masën 255,500 lekë.

i) Në lidhje me burimin e gjendjes *cash* (shitja e tokës bujqësore dhe banesës së prindërve të subjektit), në shumën 1,000,000 lekë, ajo është trajtuar gjerësisht në pikën 32 të këtij vendimi, në të cilin është trajtuar pasuria tokë bujqësore me sipërfaqe 2312 m².

ii) Në lidhje me kursimet nga paga për periudhën janar – shtator 2012, në shumën 255,500 lekë, subjekti ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për të kursyer këtë shumë sipas analizës financiare²⁷ të kryer nga Komisioni.

Subjekti, me mandatin e depozitimit datë 2.10.2012, ka depozituar *cash* në llogarinë e saj në Raiffeisen Bank vlerën 1,255,500 lekë. Në po të njëjtën datë ka transferuar në llogarinë bankare të shoqërisë “L” sh.p.k. pagesën e vlerës 1,255,500 lekë, me përshkrimin “Likuidim pjesor për blerje apartamenti, në bazë të kontratës nr. ***, datë 2.10.2012”.

Për sa më sipër, subjekti ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për të kryer pagesat në vitin 2012.

b. Kursimet nga paga për periudhën janar – maj 2013, në masën 150,000 lekë

Në datën 8.5.2013, subjekti ka depozituar në llogarinë e saj personale në Raiffeisen Bank shumën 150,000 lekë. Për pasojë, është kryer analiza financiare lidhur me mundësinë e saj për të kursyer vlerën 150,000 lekë për periudhën janar – maj 2013. Nga analiza financiare²⁸ rezulton se subjekti ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për të kursyer këtë shumë, për rrjedhojë ajo ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për pagesën e kështit të apartamentit, në shumën 150,000 lekë.

64. Në lidhje me burimin e të ardhurave për pagesat e kryera nga bashkëshorti i subjektit, në vlerën totale 3,844,500 lekë

64.1 Në seksionin “Detyrimet financiare” të deklaratës *Vetting*, bashkëshorti i subjektit ka deklaruar *detyrimin për porosinë për ndërtimin e apartamentit të banimit sipas kontratës së sipërmarrjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 2.10.2012. Është paguar shuma 1,746,250 lekë, duke konvertuar 12,500 euro të depozitës tek Union Bank, me kursin 139.7 lekë dhe transferuar në favor të sipërmarrësit sipas urdhërpagesës (transfertës) datë 3.10.2012 të Union Bank dhe vërtetimit datë 20.1.2017 të Union Bank. Në vazhdim është paguar shuma 1,902.810 lekë, duke konvertuar 13,650 euro të depozitës tek Union Bank, me kursin 139.4 lekë dhe transferuar në favor të sipërmarrësit. Në vazhdim është paguar shuma 200,000 lekë, duke pakësuar gjendjen *cash* prej 2,000 USD exchange në lekë, në datën 1.3.2013, sipas dëftesës së këmbimit valutor datë 1.3.2013. Shuma në lekë është depozituar dhe transferuar në Raiffeisen Bank në datën 5.3.2013 në favor të sipërmarrësit.*

²⁷ Shihni tabelën nr. 3 të rezultateve të hetimit.

²⁸ Shihni tabelën nr. 4 të rezultateve të hetimit.

65. Në lidhje me burimin shumave të mësipërme, bashkëshorti i subjektit ka deklaruar në deklaratën *Vetting* të gjitha lëvizjet e llogarive bankare, që nga momenti i krijimit të tyre në vitin 2004 deri në momentin e pakësimit të tyre për blerjen e apartamentit.

65.1 Më konkretisht, bashkëshorti i subjektit ka deklaruar si vijon:

a. Gjendje në depozitë tek Raiffeisen Bank²⁹, në vlerën 45,380.11 USD, në datën 1.12.2004. “Depozita tek Raiffeisen Bank e sipërcituar, e cila nga interesat kishte arritur shumën 46,181.26 USD, është mbyllur nëpërmjet tërheqjes nga ana ime e të gjithë shumës në datën 30.1.2006”.

Burimi i krijimit: Kjo depozitë është krijuar me të ardhurat nga emigracioni në SHBA.

Konstatimi i ILDKPKI-së

- *Mungesë dokumentacioni justifikues ligjor për burimin financiar nga emigracioni, në shumën 60,000 USD, deklaruar nga bashkëshorti G.K. Gjithashtu, është e paqartë mënyra e transferimit të këtyre shumave.*
- b. Gjendje në depozitë tek ProCredit Bank sh.a.³⁰, në vlerën 15,950 USD, në datën 2.6.2004.** “Kjo depozitë është krijuar në datën 15.5.2004 nga ana e nënës time Dh.K, ku unë kam pasur cilësinë e personit të autorizuar. Në datën 19.12.2007, depozita tek ProCredit Bank sh.a., që kishte arritur shumën 17,050 USD, është tërhequr nga ana ime”.

Burimi i krijimit: Kjo depozitë është krijuar me të ardhurat nga emigracioni në SHBA.

Konstatimi i ILDKPKI-së

- *Deklarim i pasaktë në deklaratën e interesave private të viteve 2003 – 2004, lidhur me depozitën dyemërore në ProCredit Bank, në vlerën 15,950 USD. Subjekti ka deklaruar depozitë në Raiffeisen Bank në vlerën 60,000 USD.*
- c. Gjendje në depozitë të hapur në datën 19.12.2007, në Societe Generale Albania Bank³¹, në shumën 16,000 USD**

Burimi i krijimit: Mbyllja e depozitës tek ProCredit Bank sh.a., në shumën 17,050 USD, po në datën 19.12.2007. Kjo depozitë është mbyllur nëpërmjet tërheqjes së të gjithë shumës 16,427 USD, në datën 3.8.2009.

Konstatimi i ILDKPKI-së

- *Deklarim i pasaktë në deklaratën e interesave private të vitit 2007, lidhur me depozitën në Societe Generale Albania Bank, në vlerën 16,427 USD.*
- d. Gjendje në depozitë në Union Bank³², e hapur në datën 26.5.2009, në shumën 20,800 USD dhe e mbyllur në datën 13.11.2009 nëpërmjet tërheqjes se vlerës 20,907 USD**

²⁹ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës nxjerrje llogarie bankare, datë 23.11.2009, të Raiffeisen Bank, në emër të G ose Dh.K.

³⁰ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës nxjerrje llogarie bankare nga ProCredit Bank, datë 2.10.2016.

³¹ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës nxjerrje llogarie bankare datë 12.10.2016 nga Societe Generale Albania Bank.

³² Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës vërtetimin datë 20.1.2017 nga Union Bank dhe nxjerrje llogarie në dollar në Union Bank.

Burimi i krijimit: Gjendja *cash* nga mbyllja e depozitës në Raiffeisen Bank, në shumën 46,181.26 USD, në datën 30.1.2006.

e. Gjendje³³ në depozitë në Union Bank, e hapur në datën 13.11.2009, në shumën 37,000 USD. Gjendja e kësaj depozite është konvertuar nga dollar në euro dhe anasjelltas, nëpërmjet këmbimit të brendshëm të Union Bank, është shtuar nga këto veprime dhe njëkohësisht ka vazhduar të jetë depozitë kursimi sipas afateve 26.5.2010 – 24.8.2010, 16.9.2010 – 16.10.2010, 21.10.2010 – 19.1.2011, 20.10.2011 – 25.5.2012 dhe 25.5.2012 – 2.10.2012. Në datën 2.10.2012, gjendja e depozitës ka qenë 32,198.37 euro.

Burimi i krijimit: Gjendja *cash* nga mbyllja e depozitës në Raiffeisen Bank, në shumën 16,427 USD, e tërhequr në datën 3.8.2009 nga Societe Generale Albania Bank dhe shuma 20,907.66 USD, e tërhequr në datën 13.11.2009 nga Union Bank.

f. Pakësohet gjendja e depozitës tek Union Bank³⁴, e sipërcituar, në datën 2.10.2012. Konkretisht shuma prej 12,500 euro e kësaj depozite është konvertuar tek Union Bank me kursin e konvertimit 139.7 lekë, në vlerën 1,746,250 lekë, ku kjo shumë në lekë, nëpërmjet urdhërpagesës (transfertës) datë 3.10.2012 të Union Bank, është transferuar në favor të subjektit “L” sh.p.k., si pagesë për porosinë e një apartamenti banimi, në bazë të kontratës së sipërmarrjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 2.10.2012.

g. Pakësohet gjendja e depozitës tek Union Bank³⁵, e sipërcituar, në datën 25.1.2013. Konkretisht shuma prej 13,650 euro e kësaj depozite është konvertuar tek Union Bank me kursin 139.4 lekë, në vlerën 1,902,810 lekë, ku kjo shumë në lekë, nëpërmjet urdhërpagesës (transfertës) datë 28.1.2013 të Union Bank, është transferuar në favor të subjektit “L” sh.p.k., si pagesë tjetër për porosinë e një apartamenti banimi, në bazë të kontratës së sipërmarrjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 2.10.2012.

h. Gjendja *cash* në USD³⁶, e krijuar nga mbyllja në datën 30.1.2006 e depozitës tek Raiffeisen Bank, është pakësuar për kryerjen e pagesës në vlerën 200,000 lekë (2,000 USD konvertuar në lekë në datën 1.3.2013, më pas depozituar dhe transferuar nga Raiffeisen Bank në datën 5.3.2013) në favor të subjektit “L” sh.p.k., për porosinë e apartamentit të banimit, sipas kontratës së sipërmarrjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 2.10.2012.

i. Pakësim tjetër i gjendjes *cash* në USD, për kryerjen e pagesës nga bashkëshorti, në vlerën 277,632 lekë, sipas faturës nr. ***, datë 21.12.2013, për dritare dhe dyer të jashtme, për apartamentin e banimit të porositur, të sipërcituar (3,000 USD konvertuar në lekë sipas faturave të këmbimit valutor datë 25.11.2013 dhe datë 20.12.2013).

³³ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: (i) nxjerrje llogarie bankare, datë 19.1.2017, nga Union Bank, në dollar; (ii) nxjerrje llogarie bankare, datë 19.1.2017, nga Union Bank, në euro.

³⁴ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës nxjerrje llogari bankare, datë 19.1.2017, në Union Bank, në monedhën lekë.

³⁵ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës nxjerrje llogarie bankare, datë 19.1.2017, në Union Bank, në monedhën lekë.

³⁶ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: (i) faturë me TVSH nr. ***, datë 21.12.2013, në vlerën 277,632 lekë; faturë me TVSH nr. ***, datë 27.12.2014, në vlerën 89,590 lekë; faturë me TVSH nr. ***, datë 11.11.2013, në vlerën 37,140 lekë; faturë me TVSH nr. ***, datë 15.11.2013, në vlerën 38,275 lekë; faturë me TVSH nr. ***, datë 23.11.2013, në vlerën 34,475 lekë; (ii) faturë këmbimi valutor datë 11.12.2014, të shumës 2,000 USD, pas këmbimit në vlerën 224,000 lekë; (iii) faturë këmbimi valutor datë 20.12.2013, të shumës 1,000 USD, pas këmbimit në vlerën 102,400 lekë; (iv) faturë këmbimi valutor datë 25.11.2013, të shumës 2,000 USD, pas këmbimit në vlerën 206,800 lekë.

- j. Pakësim tjetër i gjendjes *cash* në USD**, duke u kryer pagesa nga bashkëshorti për çelësa, priza etj., bojëra lysterje të mureve, laminat për dysheme, matësin e dritave dhe ujit për apartamentin e banimit të porositur të sipërcituar, sipas faturës tatimore të shitjes nr. ***, datë 27.12.2014 dhe kuponëve tatimorë. Për këto pagesa janë bërë 2,000 USD konvertuar në lekë (224,000 lekë), në datën 11.12.2014, sipas faturës së këmbimit valutor datë 11.12.2014.
- k. Pakësim tjetër i gjendjes *cash* në USD**, duke u kryer pagesa nga bashkëshorti për dyer, pajisje tualeti, mobilim apartamenti, kuzhine, elektroshtëpiake etj., për apartamentin e banimit të porositur, të përmendur sipas faturës tatimore të shitjes nr. ***, datë 19.4.2015, nr. ** datë 14.6.2015, nr. **, datë 26.6.2015 dhe nr. ** datë 6.7.2015, si dhe kuponëve tatimorë. Për këto pagesa janë bërë 5,000 USD konvertim, sipas faturave të këmbimit valutor datë 6.4.2015 dhe datë 16.7.2015.

66. Nga verifikimi i deklaratave periodike vjetore të bashkëshortit të subjektit, rezulton se:

- i. Në deklaratën para fillimit të detyrës të vitit 2004, bashkëshorti G.K ka deklaruar *60,000 USD në Raiffeisen Bank*, me burim të ardhurat nga emigracioni.
- ii. Në DPV-në e vitit 2004, bashkëshorti G.K ka deklaruar *depozitë bankare 60,000 USD*, me burim të ardhurat nga emigracioni, likuiditete në Raiffeisen Bank.
- iii. Në DPV-në e vitit 2005, bashkëshorti G.K ka deklaruar: *“Interesa për depozitën në Raiffeisen Bank, të cilat i kam tërhequr nga banka në janar 2006, në vlerën 1,100 USD (shitesë gjatë vitit 2005)”*.
- iv. Në procesverbalin e datës 24.11.2009 në ILDKPKI, bashkëshorti i subjektit, z. G.K, ka deklaruar: *“Në vitet 1999 – 2004 (gusht) kam jetuar në Amerikë... Gjatë kësaj periudhe kam punuar, ku jam paguar me çeqe dhe në cash. Shumicën e tyre e kam ruajtur ...vazhdimisht kam bërë transferta në drejtim të Shqipërisë në favor të nënës time Dh.K. Shuma totale e të ardhurave të hyra në Shqipëri është rreth 60,000 USD, të cilat i kam deklaruar në deklarinimin tim të parë dhe i kam pasur në depozita në ProCredit Bank, rreth 15,000 USD dhe në Raiffeisen Bank, rreth 45,000 USD”*.

67. Si burim për llogaritë e mësipërme, si dhe gjendjen *cash*, bashkëshorti i subjektit ka deklaruar kursimet e krijuara nga emigracioni, në një vlerë totale prej 60,000 USD.

67.1 Për të provuar burimin e ligjshëm të këtyre të ardhurave, subjekti ka depozituar:

- a) Dokumentacion (në gjuhën angleze) i lëshuar nga shoqëria “C.C.T.I” lidhur me të ardhurat e përfituara nga shtetasi G.K, si i punësuar pranë kësaj shoqërie për periudhën mars 2001 – mars 2004. Nga përmbajtja e këtij dokumentacioni rezulton se bashkëshorti i subjektit ka përfituar këto të ardhura neto, në shumën totale 52,219.13 USD.
- b) Dokumentacion (në gjuhën angleze) i lëshuar nga shoqëria “H.F.S.I.B.P.M” lidhur me të ardhurat e përfituara nga shtetasi G.K, si i punësuar pranë kësaj shoqërie për periudhën gusht 2003 – mars 2004. Nga përmbajtja e këtij dokumentacioni rezulton se bashkëshorti i subjektit ka përfituar të ardhura neto në shumën 1,797.76 USD.
- c) Në përgjigje të pyetësorit nr. 1 ka bashkëlidhur:
 - formularin W-2 të deklaratës mbi të ardhurat dhe tatimet, lëshuar nga punëdhënësi, shoqëria “C.C.T.I”, për vitet 2001 – 2002 – 2003;

- dokumentin Sigurimet Shoqërore, certifikuar nga punëdhënësi, shoqëria “C.C.T.I”, për vitin 2001 vërtetimi i lëshuar në datën 28.12.2001, për vitin 2002 vërtetimi i lëshuar në datën 27.12.2002, për vitin 2003 vërtetimi i lëshuar në datën 24.12.2003, për vitin 2004 vërtetimi i lëshuar në datën 12.3.2004;
 - formularin W-2 të deklaratës mbi të ardhurat dhe tatimet, lëshuar nga punëdhënësi “H.F.S.I.B.P.M” për vitin 2003;
 - vërtetimin e pagës lëshuar nga “H.F.S.I.B.P.M” për vitin 2003;
 - dokumentin që vërteton se shtetasi G.K ka qenë i pajisur me numër pune ***, si dhe kartë autorizimi punësimi nr. ***, e vlefshme nga data 12.12.2000 deri më 11.12.2001, kartë autorizimi punësimi nr. ***, e vlefshme nga data 28.12.2001 deri më 27.12.2002, kartë autorizimi punësimi nr. ***, e vlefshme nga data 28.12.2002 deri më 27.12.2003.
- d) Nxjerrje llogarie (në gjuhën angleze) nga Citizens Bank, për periudhën 13.12.2003 – 15.1.2004, ku rezulton se shtetasi G.K ka pasur gjendje në llogarinë rrjedhëse shumë 793.58 USD, si dhe në llogarinë depozitë shumë 24,266.53 USD. Gjendja e të dyja llogarive në datën 15.1.2004 është 0 (zero).

68. Komisioni, bazuar në deklaratimet e subjektit, si dhe në dokumentacionin e depozituar prej saj, ka kryer një analizë financiare mbi mundësitë e bashkëshortit të saj për të krijuar si kursim shumë 60,000 USD.

Tabela nr. 1

	Mars 2001 – mars 2004
Të ardhurat totale	\$ 54,016.89
Të ardhurat e “C.C.T.I”, mars 2001 – mars 2004	\$ 52,219.13
Të ardhurat e “H.F.S.I”, gusht 2003 – mars 2004	\$ 1,797.76
Shpenzime	\$ 26,088.50
Shpenzime jetike 1 person	\$ 26,088.50
Mundësia për kursime	\$ 27,928.39

68.1 Nga analiza financiare duket se bashkëshorti i subjektit ka pasur mundësi për kursim në shumë 27,928.39 USD, e cila përafrohet me gjendjet e llogarive të tij në vitin 2004, në SHBA, në vlerën 25,060 USD, si dhe me transferimet e kryera nga shtetasi Gj.R.

68.2 Për sa më sipër, duket se bashkëshorti i subjektit nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për të kursyer shumë 60,000 USD, në vlerën 32,071.61 USD, në vitin 2004.

69. Pas kalimit të barrës së provës, subjekti pretendoi³⁷ se: “Bashkëshorti, për të ardhurat nga emigracioni nga puna në SHBA, disponon dokumentacionin ligjor, duke mbuluar me këtë dokumentacion të ardhurat totale në shumë 54,016.89 USD, të krijuara nga punësimi i tij i ligjshëm në SHBA nga marsi i vitit 2001 deri në mars të vitit 2004...”

Sipas deklaratimeve të bashkëshortit për periudhën tetor 1999 – shkurt 2001, për arsye të procedurës që ndiqej për dhënien e të drejtës së qëndrimit në SHBA, njëkohësisht edhe të drejtës për t’u punësuar për të realizuar të ardhura, ka punuar në mënyrë informale, pa numër sigurimi shoqëror, si të gjithë emigrantët e tjerë. Njëkohësisht, edhe pasi është pajisur me autorizim punësimi në mars të vitit 2001, ka vazhduar të punojë, përveçse në mënyrë të ligjshme, edhe në mënyrë informale, duke kryer dy punë deri në mars të vitit 2004 dhe më pas deri në gusht të vitit 2004 vetëm një punë informale, me qëllim për të realizuar sa më shumë të

³⁷ Për më shumë referojuni parashtrimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti pas kalimit të barrës së provës.

ardhura...

Në lidhje me dokumentin nxjerrje llogarie nga Citizens Bank për periudhën 13.12.2003 – 15.1.2004, është pasqyruar se bashkëshorti ka pasur gjendje për këtë periudhë në llogarinë rrjedhëse nr. *** shumën prej 793.58 USD dhe në llogarinë e kursimit nr. *** shumën prej 24,266.53 USD. Në këtë dokument nuk pasqyrohen të dhëna për lëvizjet e këtyre llogarive bankare, në mënyrë që të konstatohet koha e krijimit të tyre, depozitimet në momentin e krijimit, si dhe depozitimet apo tërheqjet e kryera që nga koha e krijimit të tyre dhe deri në fund, në datën 15.1.2004...

Sipas bashkëshortit, llogaria e kursimit pa afat nr. *** është krijuar në mars të vitit 2001 me marrjen e autorizimit për punësim dhe fillimin e pagimit të tij me çek...

Fakti që llogaria e kursimit nr. *** ka ekzistuar në vitin 2001, provohet nga deklarata e kombinuar tatimore e vitit 2001, lëshuar nga Citizens Bank. Në këtë dokument është pasqyruar llogaria nr. ***, me të ardhura interesi 18.05. Bashkëshorti ka pasur edhe llogari të tjera bankare në SHBA përveç llogarisë rrjedhëse nr. *** dhe llogarisë së kursimit nr. ***, të sipërcituara. Sipas dokumentit deklarata e kombinuar taksash, e vitit 2003, lëshuar nga Citizens Bank, rezulton se bashkëshorti ka pasur llogarinë nr. ***, me shumë interesi në këtë llogari 49.68. Nga këto dokumente duket se bashkëshorti ka pasur edhe shuma të tjera në dollar, gjendje në sistemin bankar, të cilat kanë gjeneruar interesa përveç shumës totale prej 25,060.11 USD, gjendje në llogarinë rrjedhëse nr. *** dhe në llogarinë e kursimit nr. ***...

...Nga mbërritja në SHBA në tetor të vitit 1999 dhe deri në vitin 2002 bashkëshorti ka jetuar në banesën e kushëririt të tij Gj.R, në adresën *** B.St.M NH *** USA (Gj.R është kushëri i bashkëshortit që ka kryer edhe transfertat në Shqipëri për llogari të nënës së bashkëshortit), duke ndarë shpenzimet e jetesës për qira dhe ushqim bashkë me familjen e tij...”

69.1 Subjekti ka pretenduar pamundësinë objektive për të provuar me dokumentacion të gjitha të ardhurat e përfituara nga bashkëshorti nga puna në SHBA për periudhën tetor 1999 – gusht 2004 ku, me të ardhurat e mbuluara me dokumentacion ligjor, gjithmonë të depozituara dhe jo të shpenzuara në shumën 54,016.13 USD, dhe një pjesë të të ardhurave nga punësimi informal është kursyer shuma 60,000 USD, dërguar nga bashkëshorti në Shqipëri herë pas here. Subjekti ka shpjeguar se: *“Në lidhje me pamundësinë objektive të kihet parasysh që këto të ardhura janë realizuar nga bashkëshorti 20 dhe më shumë se 20 vjet më parë në një shtet të huaj, në largësi të madhe gjeografike nga Shqipëria dhe bashkëshorti im i ardhshëm në atë kohë ka punuar, përveçse në mënyrë të ligjshme, edhe në mënyrë informale, ku për punësimin informal jo për shkak të vullnetit të tij nuk disponon dokumentacion të përfitimit të të ardhurave. Në këtë situatë faktike ka pretenduar subjekti, gjendet në kushtet e nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.*

70. Subjekti ka depozituar:

- i. Deklaratë e kombinuar tatimore e vitit 2001, lëshuar nga Citizens Bank, sipas së cilës shtetasi G.K ka pasur 3 llogari aktive në fund të vitit 2001:
 - a. llogaria nr. ***, me të ardhura nga interesat 184.25 USD;
 - b. llogaria nr. ***, me të ardhura nga interesat 64.13 USD;
 - c. depozitë nr. ***, me të ardhura nga interesat 18.05.

- ii. Deklaratë e kombinuar tatimore e vitit 2003, lëshuar nga Citizens Bank, sipas së cilës shtetasi G.K ka pasur 2 llogari aktive në fund të vitit 2003:
 - a. llogaria nr. ***, me të ardhura nga interesat 49.68 USD;
 - b. depozitë nr. ***, me të ardhura nga interesat 85.93 USD.

71. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit dhe provat e paraqitura prej saj, vlerëson se nuk është paraqitur asnjë provë për të provuar pagesën e detyrimeve tatimore për të ardhurat e pretenduara si të krijuara nga dypunësimi i bashkëshortit.

71.1 Në lidhje me pretendimin për pamundësi objektive, Komisioni vlerëson se neni 32/2 aplikohet vetëm në ato raste kur provohet ekzistenca e një shkakut të parashikuar nga ky nen, ndërkohë që në rastin e subjektit kemi të bëjmë me të ardhura informale, ekzistenca e të cilave nuk mund të provohet me dokumentacion, për sa kohë rezulton që nuk janë paguar detyrimet tatimore. Komisioni, edhe në lidhje me pretendimin e subjektit se bashkëshorti i saj ka ndarë shpenzimet e jetesës, vlerëson se ai është i pambështetur në prova, për rrjedhojë nuk do të merret në konsideratë në analizë financiare, por do të mbahet në vëmendje nga Komisioni, në vlerësimin tërësor të burimit të krijimit të shumës 60,000 USD.

72. Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka provuar me dokumentacion provues të ardhurat e plota të bashkëshortit, të krijuara nga puna e tij në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Në lidhje me këto të ardhura, duke marrë në konsideratë se:

- a. bashkëshorti i subjektit ka pasur llogari bankare në SHBA, duke filluar të paktën nga viti 2001, si dhe ka përfituar interesa nga gjendja e këtyre llogarive;
- b. një pjesë e këtyre të ardhurave (shuma prej 15,940 USD) provohet se është transferuar nëpërmjet sistemit bankar në vitin 2004;
- c. ato janë krijuar në vitet 1999 – 2004, kohë kur subjekti nuk ka qenë e martuar apo në një marrëdhënie me bashkëshortin e saj, gjithashtu janë krijuar kryesisht përpara se subjekti të fillonte detyrën;
- d. bashkëshorti i subjektit këto të ardhura i ka pasur të depozituara në llogari bankare që në vitin 2004;
- e. tërheqja e gjendjes në Raiffeisen Bank është deklaruar në vitin 2008 si gjendje *cash* dhe në vijim është deklaruar saktësisht përdorimi i saj;
- f. gjendja në ProCredit Bank është transferuar në llogari të tjera të bashkëshortit në banka të tjera, duke u përdorur më pas për blerjen e apartamentit;
- g. kursimet e krijuara nga këto të ardhura në shumën 60,000 USD janë deklaruar rregullisht nga bashkëshorti i subjektit në deklaratat periodike, por edhe përpara ILDKPKI-së;
- h. nuk ngrihen dyshime, si dhe nuk provohet që këto të ardhura të jenë krijuar nga veprime të kundërligjshme të bashkëshortit të subjektit,

– si dhe në përputhje edhe me jurisprudencën e deritanishme³⁸ të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, trupi gjykues konstaton se pavarësisht problematikave që mund të rezultojnë si pasojë e analizës financiare për provueshmërinë e ligjshmërisë së të ardhurave të personit të lidhur, nga hetimi administrativ në Komision nuk u ngritën dyshime lidhur me krijimin e këtyre të ardhurave nga aktivitete të kundërligjshme të personit të lidhur, për rrjedhojë nuk mund të

³⁸ Shihni vendimet nr. 19/2022 dhe nr. 15/2021.

ngarkohet me përgjegjësi subjekti për mungesën e dokumentacionit të plotë për provimin e burimit të plotë të krijimit të këtyre të ardhurave përpara njohjes së saj me bashkëshortin.

73. Në lidhje me deklaratimet e bashkëshortit të subjektit për lëvizjet e llogarive bankare, që kanë shërbyer për shlyerjen e pagesave të apartamentit, Komisioni ka kryer një hetim³⁹ të plotë, nga ku ka rezultuar se:

i) Raiffeisen Bank informon se bashkëshorti i subjektit dhe nëna e tij kanë qenë mbajtës të llogarive, si vijon:

- Dh.K ka pasur llogari pranë Raiffeisen Bank, e cila mbart si çelje të llogarisë nr. ***-ALL-***, që fillon me kreditimin në datën 11.2.2005, me komentin “Teprica e ***”, në shumën 300,000 lekë;
- Dh.K dhe G.Ka kanë pasur një llogari dyemërore pranë Raiffeisen Bank, e cila mbart si çelje të llogarisë nr. ***-USD-***, që fillon me kreditimin në datën 11.2.2005, me komentin “Teprica e ***”, në shumën 45,380.11 USD.

Shuma e mësipërme, së bashku me interesat, në datën 31.1.2006 ka qenë në vlerën 46,181.26 USD, e cila tërhiqet nga bashkëshorti i subjektit.

Bashkëshorti i subjektit nga verifikimi i deklaratimeve periodike të viteve 2006 dhe 2007 nuk rezulton të ketë deklaruar kursime *cash*.

Nga informacioni i vënë në dispozicion nga Raiffeisen Bank⁴⁰ në lidhje me tepricat e mbartura në çeljet e llogarive, rezulton se:

- G.K ka pasur depozitë kursimi pranë ish-Bankës së Kursimeve me nr. libeze ***, me afat 3-mujor, me gjendje në datën 31.12.1999, në vlerë 20,101.20 DEM, konvertuar me kursin e këmbimit 69.92 në vlerën 1,405,475.90 lekë.

Në lidhje me këtë llogari subjekti, në pyetësin nr. 1, deklaron se bashkëshorti i saj është larguar në shtator të vitit 1999 dhe në tetor ka qenë në SHBA, ku ka jetuar deri në gusht të vitit 2004. Ai është në pamundësi objektive të japë informacion për të ardhurat e kësaj depozite, pasi nga ana e Raiffeisen Bank nuk disponohet dokumentacion, si dhe nëna e tij ka ndërruar jetë, e cila ka pasur dy llogari në DEM në vitet 2000 dhe 2001.

Në lidhje me këtë llogari, për sa kohë ajo është krijuar përpara martesë, si dhe nuk përdoret si burim, Komisioni nuk mund të vijojë më tej hetimin, pasi kjo llogari nuk ndikon në procesin e rivlerësimit të subjektit.

ii) ProCredit Bank informon se nëna e bashkëshortit të subjektit ka pasur llogari rrjedhëse nr. ***, në të cilën bashkëshorti i subjektit ka qenë person i autorizuar.

Nga verifikimi i nxjerrjes së kësaj llogarie bankare, konstatohet se:

- në datën 19.5.2004, në këtë llogari janë kredituar 975 USD, me transfertë “R.I.M.T”;
- në datën 2.6.2004, në këtë llogari janë kredituar 14,965 USD, me transfertë “R.I.M.T”.

³⁹ Shkresë nr. ***prot., datë 28.1.2021, drejtuar bankave të nivelit të dytë; shkresë nr. *** prot., datë 21.2.2021, e Raiffeisen Bank; shkresë nr. *** prot., datë 31.5.2023, drejtuar Raiffeisen Bank; shkresë nr. *** prot., datë 14.6.2023, e Raiffeisen Bank; shkresë kthim përgjigjeje nr. OP-*** prot., datë 11.2.2021, e ProCredit Bank; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 15.2.2021, e Union Bank; shkresë kthim përgjigjeje nr. ***/tbo-*** prot., datë 3.2.2021, e OTP Bank.

⁴⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 31.5.2023, drejtuar Raiffeisen Bank; shkresë nr. *** prot., datë 14.6.2023, e Raiffeisen Bank.

Në përgjigje të pyetësorit nr. 1, subjekti deklaron se këto transfertat janë kryer nga shtetasi Gj. R, i cili është djali i tezes së bashkëshortit. Për të provuar deklarinimet e saj, subjekti ka vënë në dispozicion:

- a. Shkresën kthim përgjigjeje nr. OP-*** prot., datë 18.9.2023, të ProCredit Bank, në lidhje me transfertat ndërkombëtare të kryera në llogarinë nr. *** të shtetases Dh.K, nëpërmjet së cilës banka konfirmon se:
 - transfertat e datës 19.5.2004, me përfituese Dh.K, të shumës 975 USD, është kryer nga urdhëruesi Gj.R përmes llogarisë së tij në C.B of R.I.P;
 - transfertat e datës 2.6.2004, me përfituese Dh.K, të shumës 14,965 USD, është kryer nga urdhëruesi Gj.R përmes llogarisë së tij në C.B of R.I.P.
- b. Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.9.2023, nëpërmjet së cilës shtetasi Gj.R deklaron se: *“Unë me shtetasin G.K jam në lidhje gjinie, pasi ai është djali i tezes time. Gjatë kohës që kushëriri im G.P.K ka qenë në SHBA në të njëjtin qytet ku jetoja edhe unë, ai më ka transferuar nga llogaria e tij e bankës në llogarinë time shuma monetare në USD, të cilat unë ia kam transferuar me transfertë bankare në llogarinë bankare të nënës së tij (tezes sime) Dh.S.K. Gjithashtu i kam sjellë tezes sime sa herë që vija në Shqipëri shuma monetare në USD, të cilat më janë dhënë nga kushëriri G.K”.*
 - Në datën 31.8.2004, shuma totale prej 15,950 USD është tërhequr për të hapur depozitë me afat 1-mujor, me nr. ***, e cila ka gjeneruar interesa periodikë.
 - Në datën 19.12.2007, pas maturimit fondet e depozitës me afat kalojnë në llogarinë rrjedhëse, në shumën 17,053.74 USD.
 - Në datën 19.12.2007, bashkëshorti i subjektit tërheq shumën 17,050 USD.

74. Komisioni ka kryer një analizë financiare mbi mundësinë e krijimit të depozitave në Raiffeisen Bank dhe ProCredit Bank, në total në shumën 61,320 USD.

Tabela nr. 2

	Mars 2001 – mars 2004
Të ardhurat totale	\$ 54,016.89
Të ardhurat C. C.T.I, mars 2001 – mars 2004	\$ 52,219.13
Të ardhurat H.F serv T, gusht 2003 – mars 2004	\$ 1,797.76
Shpenzime	\$ 87,408.50
Shpenzime jetike për 1 person	\$ 26,088.50
Depozitat 45,000 USD dhe 16,000 USD	\$ 61,320.00
Mundësia për kursime	\$ -33,391.61

74.1 Në analizën financiare janë përfshirë:

- të ardhurat e dokumentuara nga punësimi i shtetasit G.K në SHBA;
- shpenzimet jetike janë konsideruar sipas të dhënave statistikore të mundësuar nga B of C. C.P.S, A.S and E.S, si dhe të dhënave të mundësuar nga motori i kërkimit *Google*⁴¹.

⁴¹ [Cost of Living in B, N dhe B, NH: Cost of Living, Prices for Rent & Food \[2023\] \(livingcost.org\) SOURCE: U.S. B of the C, C.P.S, A.S and E.S. For information on confidentiality protection, sampling error, nonsampling error, and definitions, see <www2.census.gov/programs-surveys/cps/techdocs/cpsmar19.pdf>Footnotes are available at <www.census.gov/topics/income-poverty/poverty/guidance/poverty-footnotes/cps-historic-footnotes.html>.](https://www2.census.gov/programs-surveys/cps/techdocs/cpsmar19.pdf)

75. Nga analiza financiare rezulton se bashkëshorti i subjektit nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme në shumën 33,391.61 USD për të krijuar depozitat në vitin 2004, në vlerën 61,320 USD.

76. Pas kalimit të barrës së provës, subjekti pretendoi⁴² se në deklaratën para fillimit të detyrës të vitit 2004, bashkëshorti ka deklaruar se shuma 60,000 USD e ndodhur në bankë ka si burim të ardhurat nga emigracioni. Në përputhje me deklaratën para fillimit të detyrës, në DPV-në e vitit 2004, bashkëshorti ka deklaruar se depozita prej 60,000 USD e ka burimin me të ardhurat nga emigracioni.

76.1 Në procesverbalin e datës 24.11.2009 në ILDKPKI, bashkëshorti ka deklaruar se shuma e të ardhurave, rreth 60,000 USD, të cilat i ka deklaruar në deklarinimin e tij të parë dhe i ka pasur në depozitë në ProCredit Bank rreth 15,000 USD dhe në Raiffeisen Bank rreth 45,000 USD, rrjedh nga punësimi në SHBA për periudhën 1999 – gusht 2004, ku ka punuar me dokumente të rregullta dhe ka kryer edhe punë të tjera informale, ku është paguar me çeqe, dhënë *cash*.

76.2 Në unison me deklarinimet në deklaratën para fillimit të detyrës, në DPV-në e vitit 2004, si dhe në procesverbalin e datës 24.11.2009 në ILDKPKI, në deklaratën *Vetting*, bashkëshorti ka deklaruar se depozita në Raiffeisen Bank, në shumën 45,380.11 USD, gjendje në datën 1.12.2004, dhe depozita në ProCredit Bank, në shumën 15,950.00 USD, gjendje në datën 2.6.2004, kanë si burim krijimi të ardhurat e tij nga emigracioni në SHBA, për periudhën fundi i vitit 1999 – gusht 2004, ku ka punuar si i siguruar dhe i pasiguar.

76.3 Nga sa më sipër, rezulton se bashkëshorti ka qenë koherent për sa i përket burimit të të ardhurave të tij, të cilat i ka pasur në sistemin bankar, konkretisht si depozitë në Raiffeisen Bank në vlerën 45,380.11 USD, gjendje kjo e datës 1.12.2004, depozitë e krijuar para datës 1.12.2004, dhe depozitë në ProCredit Bank në vlerën 15,950.00 USD, gjendje kjo e datës 2.6.2004, depozitë e krijuar në datën 15.5.2004, duke theksuar se burim janë të ardhurat nga emigracioni në SHBA. Në lidhje me burimin e të ardhurave të bashkëshortit të saj, subjekti dha të njëjtat shpjegime, të trajtuar më lart në pikën 69 të këtij vendimi.

77. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, mbështetur edhe në konkluzionet në pikën 72 të këtij vendimi, për sa kohë kemi të bëjmë me pasuri të krijuara para martesë, në përputhje edhe me jurisprudencën e deritanishme⁴³ të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, çmon se periudha në të cilën bashkëshorti ka investuar për krijimin e depozitave, ka qenë përtej kohës kur personi i lidhur dhe subjekti ishin në kushtet e bashkësisë ligjore, dhe kur subjekti dhe personi i lidhur vepronin financiarisht në autonomi të plotë.

77.1 Trupi gjykues konstaton se pavarësisht problematikave që mund të rezultojnë si pasojë e analizës financiare për provueshmërinë e ligjshmërisë së të ardhurave të personit të lidhur, që kanë shërbyer si burim për krijimin e llogarive bankare, nga hetimi administrativ në Komision nuk u ngritën dyshime lidhur me krijimin e këtyre të ardhurave nga aktivitete të kundërligjshme të personit të lidhur. Si rrjedhojë, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk është në kushtet e dijenisë dhe të pranimit të faktit që ka pranuar të përdorë si burim të ardhura, për të cilat ka ditur se janë krijuar me burime të kundërligjshme, situatë kjo që do ta bënte të cenueshëm besimin e publikut për subjektin e rivlerësimit.

⁴² Për më shumë referojuni parashtrimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti pas kalimit të barrës së provës.

⁴³ Shihni vendimet nr. 19/2022 dhe 15/2021.

78. OTP Bank informon se bashkëshortit i subjektit ka krijuar një depozitë pranë kësaj banke. Nga verifikimi i nxjerrjes së llogarisë bankare të bashkëshortit të subjektit, konstatohet se:

- Në datën 19.12.2007 depoziton nën komentin “Derdhje *cash*” shumën 16,000 USD, duke çelur depozitë kursimi me afat 24-mujor. Kjo shumë e ka burimin nga tërheqja e kryer në po të njëjtën datë pranë ProCredit Bank, nga llogaria bankare e nënës së bashkëshortit të subjektit.
- Në datën 3.8.2009 mbyll depozitën dhe tërheq *cash* të gjithë tepricën e saj prej 16,427 USD.

79. Union Bank ka vënë në dispozicion të Komisionit nxjerrjet e llogarive bankare (dollar/lekë/euro) të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit në këtë bankë. Nga verifikimi i tyre konstatohet se, në datën 26.5.2009, bashkëshorti i subjektit, nën komentin “Depozitim *cash*”, depoziton shumën 20,800 USD, e cila tërhiqet në datën 13.11.2009 së bashku me interesat, në vlerën 20,907.66 USD.

80. Bashkëshorti i subjektit ka deklaruar në DPV-në e vitit 2008 për herë të parë se ka kursime *cash* në shumën 42,000 USD, me burim nga mbyllja e llogarisë në Raiffeisen Bank.

81. Në DPV-në e vitit 2009, bashkëshorti i subjektit deklaroi:

- *Mbyllur depozita bankare në datën 3.8.2009 tek Banka Popullore, në vlerën 16,427.80 USD.*
- *Mbyllur depozita bankare në datën 13.11.2009 tek Union Bank (e krijuar në datën 26.5.2009, në shumën 20,800 USD, nga gjendja e mëparshme në *cash* prej 42,000 USD), në vlerën 20,907.66 USD.*
- *Gjendja më 31.12.2009 në depozitën bankare të Union Bank (krijuar në datën 13.11.2009 nga mbyllja e depozitës po në këtë bankë në datën 13.11.2009 dhe mbyllja e depozitës te Banka Popullore, datë 3.8.2009), në shumën 37,113.86 USD.*
- *Gjendja *cash* më 31.12.2009, e mbetur pas depozitimit të shumës 20,800 USD, e krijuar në datën 26.5.2009 tek Union Bank, në vlerën 21,200 USD.*

82. Nga deklaratimet e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit duket se si burim për depozitimin e shumës 20,800 USD ka shërbyer gjendja *cash* e pretenduar prej tij, e cila është krijuar nga tërheqja e shumës 42,000 USD në Raiffeisen Bank.

83. Në lidhje me shumën 42,000 USD, të pretenduar si gjendje *cash*, konstatohet se:

- i. Bashkëshorti i subjektit në datën 31.1.2006 ka tërhequr nga Raiffeisen Bank shumën 46,181.26 USD.
- ii. Në DPV-të e viteve 2006 dhe 2007, as subjekti dhe as bashkëshorti i saj nuk rezultojnë të kenë deklaruar kursime *cash*.
- iii. Në DPV-në e vitit 2008, bashkëshorti i subjektit deklaroi për herë të parë kursime *cash* në vlerën 42,000 USD.
- iv. Nga analiza financiare e kryer nga Komisioni duket se bashkëshorti i subjektit nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për krijimin e depozitave, për rrjedhojë edhe të gjendjes së pretenduar *cash* në vitin 2008.

83.1 Bazuar sa më sipër, gjendja *cash* në vlerën 42,000 USD, e deklaruar nga bashkëshorti i subjektit në vitin 2008, nuk do të përfshihet në analizë financiare, për rrjedhojë ai nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për krijimin e depozitës në Union Bank, në shumën 20,800 USD.

84. Pas kalimit të barrës së provës, subjekti pretendoi⁴⁴ se mospasqyrimi nga ana e bashkëshortit në DPV-në e vitit 2006, si dhe më pas në atë të vitit 2007, i gjendjes *cash* të krijuar nga mbyllja e depozitës së tij tek Raiffeisen Bank në datën 30.1.2006, përbën vetëm një pasaktësi në deklaram nga ana e bashkëshortit, pasi ka perceptuar se tërheqja nga banka rrjedhimisht prezumohet gjendje *cash* dhe kishte vetëm ndryshim të vendit të ruajtjes nga sistemi bankar në banesë, pasaktësi e cila sipas bashkëshortit ka rrjedhur nga mungesa e njohurive të duhura, si dhe mungesa e trajnimeve për situata të tilla. Fakti që jemi para një pasaktësie në deklaram nga ana e bashkëshortit, rrjedhur nga mungesa e njohurive dhe e trajnimeve, mbështetet edhe nga procesverbalin mbi shpjegimet e bashkëshortit në ILDKPKI, i datës 24.11.2009. Nga ky procesverbal rezulton se ILDKPKI-ja kishte konstatuar se bashkëshorti kishte mbyllur në datën 19.12.2007 depozitën tek ProCredit Bank dhe kishte kaluar shumën në Bankën Popullore, duke hapur depozitë tek kjo e fundit po në datën 19.12.2007, ndërkohë që këtë ndryshim e kishte pasqyruar në DPV-në e vitit 2008. Në lidhje me këtë konstatim, në procesverbalin mbi shpjegimet në ILDKPKI të datës 24.11.2009, bashkëshorti ka deklaruar: *“Në bazë të njohurive të mia për ligjin, meqenëse nuk kishte ndryshime të vlerave dhe isha i instruktuar gabim, nuk i pasqyrova këto lëvizje në deklaramin e vitit 2007. Por, një vit më vonë, pas pjesëmarrjes në trajnimet e organizuara nga ana juaj u informova se duheshin deklaruar të gjitha ndryshimet, për këtë arsye i kam deklaruar në vitin 2008...”*.

84.1 Pasaktësia në deklaram nga ana e bashkëshortit lidhur me mosdeklaramin në DPV-në e vitit 2006, si dhe më pas në DPV-në e vitit 2007, të gjendjes *cash*, të krijuar nga mbyllja e depozitës tek Raiffeisen Bank në datën 30.1.2006, në shumën 46,181.26 USD, është rregulluar nga ana e bashkëshortit menjëherë pas pjesëmarrjes në trajnimet përkatëse, në DPV-në e vitit 2008, ku bashkëshorti ka deklaruar gjendje *cash* në shumën 42,000 USD, e krijuar nga mbyllja e depozitës bankare tek Raiffeisen Bank.

84.2 Subjekti ka theksuar se me mbylljen e depozitës tek Raiffeisen Bank, në datën 30.1.2006, gjendja *cash* e bashkëshortit, e krijuar nga tërheqja e depozitës gjatë viteve 2006 dhe 2007, nuk është përdorur për krijimin e ndonjë pasurie tjetër, pasi edhe nga hetimi i thelluar administrativ nuk ka rezultuar që të kenë pasuri të tjera përveç atyre të deklaruara. Gjithashtu, subjekti sqaron se kjo gjendje *cash*, e krijuar nga tërheqja e depozitës në Raiffeisen Bank, në datën 30.1.2006, nuk është përdorur gjatë viteve 2006 dhe 2007 për asnjë lloj ndryshimi në planimetrinë e ndërtesës, pasurisë nr. *** të ndodhur në Pogradec, Lagjja Nr. *, rruga “**Janari”, si dhe nuk është përdorur për asnjë investim në përmirësimin e strukturës së ndërtesës, pasurisë nr. ***, e cila është në bashkëpronësi të bashkëshortit me familjarët e tij dhe në vitet 2006 e 2007 bashkëshorti zotëronte vetëm 1/4 pjesë.

85. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, duke marrë në konsideratë faktet e mëposhtme:

⁴⁴ Për më shumë referojuni parashtrimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti pas kalimit të barrës së provës.

- a. llogaria bankare që ka shërbyer për krijimin e gjendjes *cash* është deklaruar rregullisht nga bashkëshorti i subjektit;
- b. bashkëshorti i subjektit në vitin 2008 ka deklaruar gjendjen *cash*, duke korrigjuar në këtë mënyrë pasaktësinë e vitit 2006;
- c. pas vitit 2008 bashkëshorti i subjektit ka deklaruar saktësisht pakësimin e kësaj gjendjeje *cash*;
- d. burimi i krijimit të kësaj shume janë të ardhurat e bashkëshortit të subjektit të krijuara para martese;
- e. subjekti dhe bashkëshorti i saj nuk kanë kryer asnjë investim gjatë viteve 2006 – 2007, me përjashtim të blerjes së apartamentit, pagesa e të cilit është bërë nëpërmjet sistemit bankar;
- f. mungesën e njohurive të subjekteve në lidhje me deklarin gjatë viteve të para të hyrjes në fuqi të ligjit nr. 9049/2003;
- g. deklarinmet e bashkëshortit në ILDKPKI, ku ai ka deklaruar gjendjen *cash*,

– vlerëson se subjekti nuk gjendet në kushtet e një pretendimi të krijimit të gjendjes *cash* në banesë, bazuar thjesht në mundësitë hipotetike financiare sipas analizave financiare, pasi në këtë rast të ardhurat janë të provuara, që rrjedhin nga gjendja në llogaritë bankare, si dhe janë të papërdorura për ndonjë destinacion alternativ. Në këto kushte, bazuar në parimin e objektivitetit, këto burime nuk mund të injorohen nga Komisioni, pasi penalizimi i subjektit për thjesht faktin e mosdeklarimit me korrektësi për shtimin apo pakësimin e gjendjes *cash* në vetëm 2 vite, në rrethanat konkrete, do të ishte joproporcional.

85.1 Gjithashtu, në kushtet kur vërehet se kjo pasaktësi në deklarinmet e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit gjendet në deklarinmet periodik të interesave, në mbështetje të qëndrimit të mbajtur nga Kolegji në çështje të ngjashme⁴⁵, e cila përbën tashmë jurisprudencë të konsoliduar të tij, Komisioni vlerëson se një deklarinmet i pasaktë në deklarinmet e mëparshme periodike të interesave nuk mund të konsiderohet se është bërë në kundërshtim me përcaktimin e shkronjës “a” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, për rrjedhojë, nuk është element i mjaftueshëm për t’u konsideruar si një shkak i vetëm dhe i veçuar, që prodhon situatën e deklarinmet të pamjaftueshëm, në kuptim të pikës 3 të nenit 61 të këtij ligji. Për më tepër, këto pasaktësi janë korrigjuar prej bashkëshortit të subjektit pranë organit përgjegjës, por edhe në deklarinmetat periodike në vitet në vijim. Për sa më sipër, Komisioni krijoi bindjen se shuma prej 42,000 USD ka ekzistuar si kursim *cash* dhe se subjekti ka pasur mjaftueshëm burime për ekzistencën e këtij kursimi. Tërësia e veprimeve të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur (bashkëshortit) krijojnë bindjen e arsyeshme se pasaktësitë në deklarinmet vjetore mbeten shkak i veçuar, të pashoqëruara me dyshime të arsyeshme për deklarinmet të rremë apo fshehje pasurie nga ana e subjektit të rivlerësimit dhe, për pasojë, krijoi bindjen se ato duhen pranuar duke u përfshirë në analizën financiare të subjektit.

86. Komisioni ka kryer një analizë financiare, duke përfshirë shumën 42,000 USD si kursim *cash*, paraqitur në tabelën si vijon:

Tabela nr. 3

Periudha	26.5.2009
Pasuria	232,564.00

⁴⁵ Vendimet nr. 9/2020 (JR), datë 26.6.2020, nr. 16/2020 (JR), datë 13.7.2020 dhe nr. 31/2020 (JR), datë 18.11.2020, të Kolegjit.

Depozitë 20,800 USD	1,954,784.00
<i>Ndryshim likuiditeti</i>	<i>(1,722,220.00)</i>
Detyrime	0.00
Pasuria neto	232,564.00
Të ardhura	622,247.34
Të ardhurat e subjektit nga paga	337,961.60
Të ardhura e bashkëshortit të subjektit	284,285.74
Shpenzime	360,072.67
Shpenzime jetike për 3 persona	170,775.00
TIMS	89,297.67
Shpenzime mobilimi pa fatura, sipas Pst	100,000.00
Mundësia për kursime	29,610.67

86.1 Nga analiza financiare rezulton se bashkëshorti i subjektit ka pasur të ardhura të mjaftueshme për krijimin e depozitës në Union Bank.

87. Depozita e mësipërme është mbyllur në datën 13.12.2009. Në datën 13.11.2009, bashkëshorti i subjektit depoziton shumën 37,000 USD. Kjo shumë, bazuar në deklaratimet e bashkëshortit të subjektit në DPV-në e vitit 2009, e ka burimin nga tërheqja e shumës së mësipërme, si dhe tërheqja e shumës 16,427 USD në OTP Bank. Bashkëshorti i subjektit gjatë viteve 2010 – 2012 ka kryer konvertime të shumës së mësipërme, duke krijuar depozita në euro dhe në dollar. Në datën 25.5.2012, bashkëshorti i subjektit gjendjen në vlerën 40,200.06 USD e konverton me kurs preferencial në euro, duke krijuar një depozitë në shumën 31,968.24 euro.

87.1 Në datën 2.10.2012, bashkëshorti i subjektit kryen kalim të shumës 12,500 euro në llogarinë e tij në lekë, këmbyer me kurs preferencial 139.7, në vlerën 1,746,250 lekë. Kjo shumë transferohet në datën 3.10.2012 në llogarinë e shoqërisë “L” sh.p.k.

87.2 Në datën 25.1.2013, bashkëshorti i subjektit kryen kalim të shumës 13,650 euro në llogarinë e tij në lekë, këmbyer me kurs preferencial 139.4, në vlerën 1,902,810 lekë. Kjo shumë transferohet në datën 28.1.2013 në llogarinë e shoqërisë “L” sh.p.k.

88. Në lidhje me pakësimin e gjendjes cash

Bashkëshorti i subjektit ka deklaruar se gjendjen *cash* të mbetur pas depozitimit të shumës 20,800 USD në Union Bank e ka përdorur për pagesën e apartamentit në vlerën 200,000 lekë, ndërsa pjesën tjetër e ka përdorur për të kryer punime në këtë apartament.

Në deklaratat periodike vjetore bashkëshorti i subjektit, në lidhje me likuidimin e apartamentit, si dhe përdorimin e gjendjes *cash*, ka deklaruar si vijon:

- Në DPV-në e vitit 2012 deklarohet se ka paguar shumën 1,746,250 lekë, e cila ka si burim llogarinë e tij në euro në Union Bank (bashkëshorti i subjektit ka konvertuar llogarinë në USD prej 40,200 në vlerën në euro prej 31,968).
- Në deklaratën pas largimit nga funksionit në vitin 2013 deklarohet se ka paguar shumën 1,900,000 lekë, me burim llogarinë e tij në euro në Union Bank.
- Në DPV-në e vitit 2013, bashkëshorti i subjektit deklarohet se ka pakësuar gjendjen *cash*, në shumën 5,000 USD.
- Në DPV-në e vitit 2014, bashkëshorti i subjektit deklarohet se ka pakësuar gjendjen *cash*, në shumën 2,000 USD.

- Në DPV-në e vitit 2015, bashkëshorti i subjektit deklaroi se ka pakësuar gjendjen *cash*, në shumën 5,000 USD.
- Në DPV-në e vitit 2016 bashkëshorti i subjektit deklaroi se ka pakësuar gjendjen *cash*, në shumën 1,000 USD.

Komisioni nuk ka përfshirë në analizë financiare pakësimin e gjendjes *cash* në vitet në vijim, por nuk i ka kaluar barrë prove subjektit, pasi nuk ndikonte në analizë financiare.

ANALIZA FINANCIARE

89. Komisioni ka kryer një analizë financiare për mundësinë e subjektit dhe personave të lidhur me të për blerjen e apartamentit, duke u bazuar në burimet e deklaruara në deklaratën *Vetting*. Në këtë analizë nuk janë përfshirë kursimet *cash* të deklaruara nga bashkëshorti i subjektit në vitin 2008, në shumën 42,000 USD, duke qenë se: (i) nuk provohet burimi i ligjshëm i tyre; (ii) as subjekti dhe as bashkëshorti nuk kanë deklaruar gjendje *cash* në DPV-të e viteve 2006 e 2007.

Në këto kushte:

- Për vitin 2012 nuk është konsideruar shuma 1,746,250 lekë, e cila ka si burim llogarinë e krijuar në Union Bank në vitin 2009, për të cilën ka rezultuar se bashkëshorti i subjektit nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për krijimin e saj.
- Për vitin 2013 nuk është konsideruar shuma 200,000 lekë, për të cilën është deklaruar si burim gjendja *cash* e bashkëshortit të subjektit, si dhe nuk është konsideruar shuma 1,900,000 lekë, e cila ka si burim llogarinë e krijuar në Union Bank në vitin 2009, për të cilën ka rezultuar se bashkëshorti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për krijimin e saj.

90. Për rrjedhojë, duket se subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme në shumën 1,746,250 lekë në vitin 2012 dhe në shumën 2,100,000 lekë në vitin 2013, për pagesën e kësteve për blerjen e këtij apartamenti.

91. Pas kalimit të barrës së provës, subjekti pretendoi⁴⁶ se:

i) Në DPV-në e vitit 2012, bashkëshorti ka deklaruar se ka paguar në datën 3.10.2012 shumën 1,746,250 lekë (1,750 lekë komision bankar), për porosinë e apartamentit të banimit sipas kontratës së sipërmarrjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 2.10.2012, shumë e cila ka si burim pakësimin e llogarisë tek Union Bank, në datën 2.10.2012, me 12,500 euro, konvertuar me kursin 1 euro = 139.7 lekë.

ii) Në deklaratën pas largimit nga funksioni në vitin 2013, bashkëshorti ka deklaruar se ka paguar në datën 28.1.2013 shumën 1,902,810 lekë (2,810 lekë komision bankar) për porosinë e apartamentit të banimit sipas kontratës së sipërmarrjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 2.10.2012, shumë e cila ka si burim pakësimin e llogarisë tek Union Bank, në datën 25.1.2013, me 13,650 euro, konvertuar me kursin 1 euro = 139.4 lekë.

iii) Në DPV-në e vitit 2013, bashkëshorti ka deklaruar se ka paguar nëpërmjet Raiffeisen Bank shumën 200,000 lekë, në datën 5.3.2013, për porosinë e apartamentit të banimit sipas kontratës së sipërmarrjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 2.10.2012, shumë e cila ka si burim pakësimin e

⁴⁶ Për më shumë referojuni parashtrimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti pas kalimit të barrës së provës.

gjendjes *cash* të bashkëshortit në dollar, ku ka konvertuar 2,000 USD në lekë, në datën 1.3.2013.

iv) Lidhur me pagesat për porosinë e apartamentit të banimit, deklaratet e bashkëshortit në deklaratën *Vetting* kanë qenë në unison me deklaratet e bëra në DPV-në e vitit 2012, deklaratën pas largimit nga funksioni në vitin 2013, si dhe në DPV-në e vitit 2013.

v) Lidhur me llogarinë bankare të bashkëshortit tek Union Bank, ku nga shuma e kësaj llogarie janë kryer pagesat prej bashkëshortit në shumat 1,746,250 lekë dhe 1,902,810 lekë, për porosinë e apartamentit të banimit sipas kontratës së sipërmarrjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 2.10.2012, subjekti thekson se kjo llogari ka burim fillestar të ligjshëm depozitën e bashkëshortit në Raiffeisen Bank, në shumën 45,380.11 USD, gjendje në datën 1.12.2004, dhe depozitën tek ProCredit Bank në shumën 15,950.00 USD, gjendje në datën 2.6.2004, ku këto dy depozita, siç dhe ka deklaruar, kanë si burim të ardhurat e bashkëshortit nga puna në SHBA për periudhën fundi i vitit 1999 – gusht 2004.

92. Komisioni pasi analizoi shpjegimet e subjektit, duke marrë në konsideratë konkluzionin në pikën 85 të këtij vendimi, ku ka vendosur përfshirjen në analizën financiare të gjendjes *cash* në shumën 42,000 USD, ka kryer edhe një herë analizën financiare, si vijon:

Tabela nr. 4

Periudha	3 tetor 2012	Maj 2013
Pasuria	2,154,192.19	-3,343,375.83
Apartament 127 m ²	6,000,000.00	0.00
<i>Ndryshim likuiditeti</i>	<i>-3,845,807.81</i>	<i>-3,343,375.83</i>
Detyrime	3,000,000.00	-2,250,000.00
Detyrim ndaj shoqërisë “L” sh.p.k., për blerje apartamenti	6,000,000.00	0.00
Shlyerje detyrimi ndaj shoqërisë “L” sh.p.k.	-3,000,000.00	-2,250,000.00
Pasuria neto	-845,807.81	-1,093,375.83
Të ardhura	1,468,701.48	779,554.55
Të ardhurat e subjektit nga paga	802,897.90	409,871.16
Të ardhura e bashkëshortit të subjektit	665,803.58	369,683.39
Shpenzime	480,939.79	272,851.03
Shpenzime jetike	348,870.00	176,280.00
TIMS	67,069.79	65,321.03
Shpenzime për shkollimin e fëmijëve	65,000.00	31,250.00
Mundësia për kursime	1,833,569.51	1,600,079.35

92.1 Në përfundim rezulton se subjekti dhe bashkëshorti i saj kanë pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për blerjen e këtij apartamenti.

93. Në pyetësin standard, subjekti ka depozituar aktmarrëveshjen nr. ***rep., nr. *** kol., datë 25.10.2016, nënshkruar midis shtetasve L.H dhe G.K, sipas së cilës sipërmarrësi njih shpenzimet e kryera nga shtetasi G.K, në shumën 357,000 lekë, për punime në apartament dhe këtë shumë ia zbrit detyrimin të mbetur prej 750,000 lekësh. Në përfundim palët dakordësohen që detyrimi i mbetur ndaj shoqërisë “L” sh.p.k. është 393,000 lekë.

93.1 Referuar dokumentacionit të administruar gjatë hetimit, rezulton se deri në nënshkrimin e deklaratës *Vetting* subjekti dhe bashkëshorti i saj kanë paguar në favor të shoqërisë “L” sh.p.k. vlerën 5,250,000 lekë.

93.2 Nga nxjerrjet e llogarive bankare pranë Raiffeisen Bank rezulton se, në datën 6.9.2017, subjekti ka depozituar në llogarinë e saj të pagës shumë 400,000 lekë dhe po në këtë datë kalon shumë 393,300 lekë për llogari të shtetasës B.S, nën komentin “Kalim shume sipas aktmarrëveshjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 25.10.2016 dhe kontratës së sipërmarrjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 2.10.2012”.

94. Komisioni ka kryer analizën financiare lidhur me mundësinë e subjektit dhe bashkëshortit të saj për pagesën e kësaj vlere, e cila sipas deklarimeve të saj në DPV-në e vitit 2017 e ka burimin nga gjendja *cash* e deklaruar në vitin 2016, në shumë 400,000 lekë. Referuar analizës financiare, rezulton se subjekti ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e gjendjes *cash* prej 400,000 lekësh.

95. Në përfundim të hetimit, në lidhje me pasurinë apartament, konkludohet se nuk lindin dyshime apo paqartësi në lidhje me këtë pasuri të subjektit. Subjekti ka kryer deklarim të saktë dhe në përputhje me ligjin, si dhe ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për krijimin e saj.

96. Gjendje *cash*⁴⁷ në masën 1,000,000 lekë, e krijuar nga shitja e pasurisë tokë arë nr. ***, me anë të kontratës së shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 17.3.2011. E gjithë kjo gjendje *cash* është shpenzuar për të paguar porosinë e apartamentit të banimit sipas kontratës së sipërmarrjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 2.10.2012, nëpërmjet depozitimit në llogari personale datë 2.10.2012 dhe njoftimit të debitimit datë 2.10.2012 (transferim) tek Raiffeisen Bank, në përfitim të subjektit “L.” sh.p.k. Vlera: 1.000.000 lekë. Pjesa takuese: 100%. Trajtuar në pikën 32 të këtij vendimi.

97. Gjendje *cash*, aktualisht në masën 400,000 lekë

Burimi i krijimit: Gjendje e mbartur ndër vite dhe e krijuar nga kursimet nga paga.

Hetimi/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni

98. Nga verifikimi i deklarimeve periodike, subjekti ka deklaruar në vitin 2004 gjendje *cash* në shumë 150,000 lekë dhe në vitin 2006 gjendje *cash* në shumë 300,000 lekë. Ndërkohë, në lidhje me kursimet *cash* të vitit 2011, ato janë trajtuar në pikën 32 të këtij vendimi. Në DPV-në e vitit 2016, subjekti deklaroi pakësim të kursimeve në shumë 50,000 lekë, duke deklaruar në përfundim gjendje *cash* në shumë 400,000 lekë.

98.1 Në lidhje me shumë 450,000 lekë, duke qenë se ajo është krijuar në vitet 2004 dhe 2006, Komisioni ka kryer një analizë financiare mbi mundësinë e krijimit të këtyre kursimeve në këto vite, duke përfshirë të ardhurat e prindërve.

Tabela nr. 5

	Viti 2004	Viti 2006
Pasuria	150,000.00	355,248.63
Automjet tip “Fiat Bravo”		
<i>Ndryshim likuiditeti</i>	<i>150,000.00</i>	<i>355,248.63</i>
Detyrime	0.00	0.00
Pasuria neto	150,000.00	355,248.63

⁴⁷ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratën njoftim debitimi datë 2.10.2012 në Raiffeisen Bank, në shumë 1,255,500 lekë, nga Luljeta Kolonja, me përshkrimin “Likuidim pjesor për blerje apartamenti në bazë të kontratës nr. ***, datë 2.10.2012”, me përfitues “L” sh.p.k.

Të ardhura	1,019,382.00	1,334,470.00
Të ardhurat e subjektit nga paga	801,786.00	835,642.00
Të ardhura nga shitja e pasurive të paluajtshme, familja bujqësore		240,000.00
Të ardhurat e shtetasit H.T (babai)	105,234.00	122,310.00
Të ardhura e shtetasit L.T (nëna)	112,362.00	136,518.00
Të ardhura e shtetasit F.T (vëllai)	-	-
Të ardhura e shtetasit M.T (motra)	-	-
Shpenzime	375,856.00	568,534.17
Shpenzime jetike	375,856.00	438,228.00
TIMS	0.00	130,306.17
Mundësia për kursime	493,526.00	410,687.20

98.2 Referuar analizës financiare, rezulton se subjekti ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e gjendjes *cash* prej 400,000 lekësh.

99. Në përfundim të hetimit, konkludohet se nuk lindin dyshime apo paqartësi në lidhje me këtë pasuri të subjektit. Subjekti ka kryer deklaram të saktë dhe në përputhje me ligjin, si dhe ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për krijimin e saj.

100. Gjendje⁴⁸ në llogarinë rrjedhëse të pagës në Raiffeisen Bank, në datën 23.1.2017. Kjo gjendje konstatohet nga vërtetimi datë 19.1.2017 i Raiffeisen Bank dhe nxjerrja e llogarisë së kësaj banke, datë 23.1.2017. Vlera: 286.56 lekë. Pjesa takuese: 100%.

Hetimi⁴⁹/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni

101. Nga nxjerrjet e llogarive bankare të subjektit pranë Raiffeisen Bank rezulton se subjekti disponon llogari page nr. ***-ALL-***, e cila është çelur në datën 1.4.2005 dhe gjendja e saj në datën 23.1.2017 është 286.56 lekë.

102. Në përfundim të hetimit, konkludohet se nuk lindin dyshime apo paqartësi në lidhje me këtë pasuri të subjektit. Subjekti ka kryer deklaram të saktë dhe në përputhje me ligjin.

DETYRIME FINANCIARE

103. Detyrim për apartamentin e banimit sipas kontratës së sipërmarrjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 2.10.2012. Shuma e detyrimit financiar në bazë të kontratës së sipërmarrjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 2.10.2012 dhe aktmarrëveshjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 25.10.2016, që ka mbetur pa shlyer ndaj sipërmarrësit, subjektit “L” sh.p.k., është 393,000 lekë.

Kjo çështje është trajtuar në pikën 93 të këtij vendimi.

DEKLARIMI I BASHKËSHORTIT TË SUBJEKTIT, Z. G.K

❖ Deklarimi i pasurive

104. Bashkëshorti i subjektit ka deklaruar: *“Gjendje në depozitë tek Raiffeisen Bank, në vlerën 45,380.11 USD. Kjo gjendje është në datën 1.12.2004. Depozita në shumën e përmendur ka qenë me dy emra, Dh.K nëna ime dhe G.K dhe është krijuar në kohën që kam qenë në SHBA, nga ku unë herë pas here transferoja nëpërmjet njerëzve të njohur që vinin në Shqipëri të ardhurat e siguruar nga punësimi, në favor të nënës time Dh.K, që jetonte në Pogradec.*

⁴⁸ Subjekti ka depozituar vërtetimin datë 19.1.2017, shoqëruar me nxjerrjen e llogarisë në Raiffeisen Bank.

⁴⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 28.1.2021, drejtuar bankave të nivelit të dytë; shkresë nr. *** prot., datë 21.2.2021, e Raiffeisen Bank.

Depozita tek Raiffeisen Bank e sipërcituar, e cila nga interesat kishte arritur shumën 46,181.26 USD, është mbyllur nëpërmjet tërheqjes nga ana ime të të gjithë shumës në datën 30.1.2006”.

Gjendje në depozitë tek ProCredit Bank sh.a., në vlerën 15,950 USD, në datën 2.6.2004. Kjo depozitë është krijuar në datën 15.5.2004 nga ana e nënës sime Dh.K, ku unë kam pasur cilësinë e personit të autorizuar. Në datën 19.12.2007, depozita tek ProCredit Bank sh.a., që kishte arritur shumën 17,050 USD, është tërhequr nga ana ime.

Gjendje në depozitë, hapur në datën 19.12.2007 tek Societe Generale Albania Bank, në shumën 16,000 USD.

Gjendje në depozitë tek Union Bank, hapur në datën 26.5.2009, në shumën 20,800 USD, dhe e mbyllur në datën 13.11.2009 nëpërmjet tërheqjes se vlerës 20,907 USD.

Gjendje në depozitë e hapur tek Union Bank në datën 13.11.2009, në shumën 37,000 USD. Gjendja e kësaj depozite tek Union Bank është konvertuar nga USD në euro dhe anasjelltas, nëpërmjet exchange të brendshëm të Union Bank është shtuar nga këto veprime dhe njëkohësisht ka vazhduar të jetë depozitë kursimi sipas afateve 26.5.2010 – 24.8.2010, 16.9.2010 – 16.10.2010, 21.10.2010 – 19.1.2011, 20.10.2011 – 25.5.2012, 25.5.2012 – 2.10.2012. Në datën 2.10.2012, gjendja e depozitës ka qenë 32,198.37 euro.

*Pakësohet gjendja e depozitës tek Union Bank, e sipërcituar, në datën 2.10.2012. Konkretisht, shuma prej 12,500 euro e kësaj depozite është konvertuar tek Union Bank me kursin e konvertimit 139.7 lekë, në vlerën 1,746,250 lekë ku, kjo shumë në lekë, nëpërmjet urdhërpagesës (transfertës) datë 3.10.2012 të Union Bank, është transferuar në favor të subjektit “L” sh.p.k., si pagesë për porosinë e një apartamenti banimi, në bazë të kontratës së sipërmarrjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 2.10.2012.*

*Pakësohet gjendja e depozitës tek Union Bank, e sipërcituar, në datën 25.1.2013. Konkretisht, shuma prej 13,650 euro e kësaj depozite është konvertuar tek Union Bank me kursin 139.4 lekë, në vlerën 1,902,810 lekë ku, kjo shumë në lekë, nëpërmjet urdhërpagesës (transfertës) datë 28.1.2013 të Union Bank, është transferuar në favor të subjektit “L” sh.p.k., si pagesë tjetër për porosinë e një apartamentit banimi, në bazë të kontratës së sipërmarrjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 2.10.2012.*

Gjendja e llogarisë rrjedhëse e hapur në datën 2.10.2012 tek Union Bank, vetëm me qëllim për të kryer transfertat e pagesave nga llogaria e depozitës e sipërcituar në llogarinë e subjektit “L” sh.p.k., është 0 lekë.

*Gjendja cash në USD, e krijuar nga mbyllja në datën 30.1.2006 e depozitës tek Raiffeisen Bank, është pakësuar për kryerjen e pagesës në vlerën 200,000 lekë. (2,000 USD exchange në lekë, datë 1.3.2013, më pas depozituar dhe transferuara nga Raiffeisen Bank datë 5.3.2013) në favor të subjektit “L” sh.p.k., për porosinë e apartamentit të banimit sipas kontratës së sipërmarrjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 2.10.2012.*

*Pakësim tjetër i gjendjes cash në USD për kryerjen e pagesës nga unë në vlerën 277,632 lekë, sipas faturës nr. *** datë 21.12.2013, për dritare dhe dyer të jashtme për apartamentin e banimit të porositur të sipërcituar (3,000 USD exchange në lekë, sipas faturave të këmbimit valutator datë 25.11.2013 dhe datë 20.12.2013).*

Pakësim tjetër i gjendjes cash në USD, duke u kryer pagesa nga unë për çelësa, priza etj., bojëra, lyerje të mureve, laminat për dyshemenë, matësin e dritave dhe të ujit, për apartamentin

*e banimit të porositur, të sipërcituar, sipas faturës tatimore të shitjes nr. ***, datë 27.12.2014 dhe kuponëve tatimorë. Për këto pagesa janë bërë 2,000 USD exchange në lekë (224,000 lekë), në datën 11.12.2014, sipas faturës së këmbimit valutor datë 11.12.2014.*

*Pakësim tjetër i gjendjes cash në USD, duke u kryer pagesa nga unë për dyer, pajisje banjë, mobilim apartamenti, kuzhine, elektroshtëpiake etj., për apartamentin e banimit të porositur, të përmendur sipas faturës tatimore të shitjes nr. ***, datë 19.4.2015, nr. **, datë 14.6.2015, nr. **, datë 26.6.2015 dhe nr. **, datë 6.7.2015, si dhe kuponëve tatimorë. Për këto pagesa janë bërë 5,000 USD Exchange, sipas faturave të këmbimit valutor datë 6.4.2015 dhe datë 16.7.2015”.*

104.1 Të gjitha këto llogari të deklaruara nga bashkëshorti i subjektit, si dhe lëvizjet e kryera janë analizuar në pikat 54 e në vijim të këtij vendimi, ku trajtohet gjerësisht burimi i pasurisë apartament.

105. Gjendje cash në dollar, aktualisht në shumën 8,000 USD. Pjesa takuese: 100%.

Hetimi/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni

106. Komisioni ka kryer analizën financiare për mundësinë e krijimit të shumës 8,000 USD në vitin 2016. Bazuar në analizën financiare⁵⁰, bashkëshorti i subjektit ka pasur mundësi financiare për krijimin e depozitës 8,000 USD në Union Bank.

107. Në përfundim të hetimit, konkludohet se nuk lindin dyshime apo paqartësi në lidhje me këtë pasuri të bashkëshortit të subjektit. Bashkëshorti i subjektit ka kryer deklaram të saktë dhe në përputhje me ligjin.

108. Gjendje⁵¹ në llogarinë rrjedhëse të pagës në Raiffeisen Bank, në datën 23.1.2017, në shumën 327.67 lekë. Pjesa takuese: 100%.

Hetimi/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni

109. Nga nxjerrja e llogarisë së bashkëshortit të subjektit në Raiffeisen Bank rezulton se gjendja në datën 23.1.2017 është 327.67 lekë.

110. Në përfundim të hetimit, konkludohet se nuk lindin dyshime apo paqartësi në lidhje me këtë pasuri të bashkëshortit të subjektit. Bashkëshorti i subjektit ka kryer deklaram të saktë dhe në përputhje me ligjin.

111. Truall dhe ndërtesë⁵² me sipërfaqe 72 m², regjistruar në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Pogradec, me nr. pasurie ***, e ndodhur në Pogradec, Lagjja Nr. *, rruga “*** Janari”. Pjesa takuese: ¼.

Burimi i krijimit: “*Kjo pasuri është përfituar me trashëgimi nga trashëgimlënësi, babai im P. K dhe është në bashkëpronësi, ku pjesa ime takuese është ¼*”.

⁵⁰ Referojuni tabelës nr. 8 të rezultateve të hetimit.

⁵¹ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: vërtetimin datë 19.1.2017, të Raiffeisen Bank; nxjerrje llogarie bankare datë 23.1.2017, të Raiffeisen Bank.

⁵² Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: (i) certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, datë 6.10.2008; (ii) vendim nr. ***, datë 5.12.1995, për çeljen e trashëgimisë pas vdekjes së shtetasit P.K; (iii) vendim nr. **, datë 7.5.1991, për dhënien e lejes për ndërtime e meremetime; (iv) deklaratë personale nga shtetasja Dh.K; (v) vërtetim nr. ***, datë 20.9.2000; (vi) vërtetim nr. ***, datë 20.9.2000.

Hetimi⁵³/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni

112. Në datën 11.12.1995, me vendimin gjyqësor nr. *** është lëshuar dëshmia e trashëgimisë për të ndjerin P.K, sipas së cilës janë përcaktuar si trashëgimtarë ligjorë të radhës së parë bashkëshorti i subjektit dhe familjarët e tij (nëna, motra dhe vëllai), të cilët kanë trashëguar ¼ pjesë takuese mbi pasuritë e lëna nga i ndjeri.

112.1 Me vendimin nr. **, datë 7.5.1991, “Mbi dhënie leje ndërtimi e meremetime”, të këshillit popullor të qytetit, është miratuar kërkesa e nënës së bashkëshortit të subjektit për të kryer punime të brendshme, meremetime, si dhe të shtojë një aneks.

ASHK Pogradec⁵⁴ ka vënë në dispozicion planimetritë e dy kateve të kësaj ndërtese, të hartuara në vitin 1997: planimetrinë e katit përdhe me sipërfaqe 72 m² dhe planimetrinë e katit të parë me sipërfaqe 72 m².

112.2 Ky fakt pasqyrohet edhe në kërkesën për regjistrimin e pronësisë, e cila është firmosur nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, ku deklarohet lloji i pasurisë shtëpi banimi, e formës dykatëshe.

112.3 Kjo pasuri rezulton e regjistruar në bashkëpronësi të shtetasve Dh.K, D.K, K.K dhe G.K, me nr. ***, z. k. ***.

112.4 Nga deklaratimet e subjektit, por edhe të bashkëshortit të saj, konstatohet se ata kanë deklaruar si adresë banimi këtë banesë për vitet 2007 – 2014. Ky fakt është konfirmuar nga subjekti edhe në pyetësorin standard.

113. Bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit nuk rezulton të ketë deklaruar në deklaratën *Vetting* se banesa përbëhet nga 2 kate, secili me sipërfaqe 72 m².

113.1 Komisioni ka administruar nga ASIG-u⁵⁵ kuotat mbi lartësinë e ndërtimit, nga verifikimi i të cilave konstatohet se kjo banesë ka pasur ndryshime në planimetrinë e saj pas vitit 2007. Në lidhje me këtë konstatim, subjekti, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, ka sqaruar se: “*Banesa është ndërtuar në vitin 1880 dhe përbëhet nga kati përdhe dhe kati i parë, që ishin ¼ e një ndërtese me çati. Rreth vitit 1960 babai i bashkëshortit, për të pasur një hyrje më vete, tek ¼ pjesë takuese e ndërtesës dy kate me çati ka bërë ndërhyrje në banesë, duke ndërtuar shkallë hyrjeje për në katin e parë dhe në aneks. Në vitin 1991 është bërë shtesë një aneks në katin përdhe...*”.

113.2 Subjekti deklaron se nuk ka bërë asnjëherë ndërhyrje/investime/ndryshime në planimetrinë e banesës. Ndërhyrja e fundit që është bërë është ajo e vitit 1990. Në deklaratën *Vetting*, për të dhënat e pasurisë, bashkëshorti i saj është bazuar në certifikatën e pasurisë, ku nuk specifikohet numri i kateve.

114. Shpjegimet e subjektit në lidhje me këtë banesë nuk përputhen as me të dhënat e ASIG-ut dhe as me të dhënat e ortofotove të administruar nga geoportali <https://geoportal.asig.gov.al/map/?auto=true>, nga ku konstatohet se banesa ka ndryshime nga viti 2007 në vitin 2015, por edhe nga viti 2001 në vitin 2007. Më konkretisht, banesa në vitin

⁵³ Shkresë nr. *** prot., datë 17.2.2021, drejtuar ASHK-së; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 17.2.2021, e ASHK-së Pogradec; shkresë nr. *** prot., datë 7.12.2023, drejtuar Autoritetit Shtetëror për Informacion Gjeohapësinor; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 12.12.2023, e ASIG-ut.

⁵⁴ Nr. *** prot., datë 3.10.2014.

⁵⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 27.4.2023; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 4.5.2023, e ASIG-ut.

2007 ka një planimetri të ndryshme nga ajo e vitit 2015, fakt që konfirmohet edhe nga shkresat e ASIG-ut, por përveç planimetrisë duket se asaj i është bërë investim, duke iu shtuar edhe çatia në një pjesë tjetër të sipërfaqes.

115. Për sa më sipër, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit, pasi duket se:

- i. Subjekti gjatë hetimit nuk ka deklaruar ndryshimet e bëra në planimetrinë e objektit, si dhe investimet në përmirësimin e strukturës së saj.
- ii. Ndryshimet në këtë pasuri janë bërë para vitit 2007, por edhe pas vitit 2007, kohë e cila përkon me tërheqjen e depozitës së bashkëshortit të subjektit në Raiffeisen Bank.
- iii. Bashkëshorti i subjektit nuk ka deklaruar saktë në deklaratën *Vetting* se kjo pasuri përbëhet nga dy kate, secili me sipërfaqe 72 m².

116. Pas kalimit të barrës së provës, subjekti parashtrroi⁵⁶ se: *“...Ndryshimi i cili duket nëpërmjet fotografimit ajror në pasurinë ndërtesë me nr. *** pasurie ka të bëjë me një tendë plastike, të vendosur ngjitur me pjesën e çatisë prej llamarine për ruajtjen nga shiu dhe dielli, e cila nuk përbën ndryshim në volumin e ndërtesës dhe në planimetrinë e saj dhe vlera e kësaj tende sipas kohës së vendosjes ka qenë 34,815 lekë. Kjo tendë plastike është e dukshme edhe në fotot e ndërtesës me nr. pasurie ***, për pjesën e jashtme që i kam paraqitur së bashku me përgjigjet e pyetësorit nr. 2. Për të vërtetuar që në pasurinë ndërtesë me nr. *** pasurie nuk është bërë asnjë lloj ndryshimi në planimetrinë e ndërtesës, si dhe asnjë lloj investimi në përmirësimin e strukturës së saj, ju paraqes bashkëngjitur shpjegimeve aktin e ekspertimit të hartuar mbi bazën e kërkesës sime datë 12.3.2024, nga eksperti i licencuar, inxh. G.B, i regjistruar në regjistrin elektronik të ekspertëve të Ministrisë së Drejtësisë... Në lidhje me konstatimin tuaj se bashkëshorti nuk ka deklaruar saktë në deklaratën *Vetting* se pasuria nr. *** përbëhet nga dy kate, secili me sipërfaqe 72 m², ju shpjegoj se në deklaratën *Vetting* për të dhënat e pasurisë bashkëshorti, për të qenë sa më korrekt, i është referuar certifikatës për vërtetim pronësie datë 6.10.2008 dhe hartës treguese të regjistrimit bashkëngjitur, të lëshuara nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Pogradec. Në certifikatën për vërtetim pronësie datë 6.10.2008, pasuria nr. ***, e ndodhur në Pogradec, Lagjja Nr. *, rruga “** Janari”, është pasqyruar e llojit truall, me sipërfaqe totale 72 m², nga kjo ndërtesa 72 m², pa u specifikuar në këtë dokument numri i kateve të ndërtesës. Pra, bashkëshorti i është përmbajtur të dhënave të dokumentit certifikatë për vërtetim pronësie datë 6.10.2008 dhe hartës treguese të regjistrimit bashkëngjitur, të lëshuara nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Pogradec. Theksoj se bashkëshorti nuk ka pasur asnjë lloj interesi për të mos cilësuar numrin prej dy katesh të ndërtesës me nr. pasurie *** dhe sipërfaqen e kateve në deklaratën *Vetting*, për sa kohë në atë ndërtesë në bashkëpronësi të bashkëshortit me familjarët e tjerë të tij, unë dhe bashkëshorti nuk kemi bërë asnjë lloj ndryshimi në planimetri dhe asnjë lloj investimi në përmirësimin e strukturës së saj”.*

117. Për të provuar pretendimin e saj, subjekti ka depozituar aktin e ekspertimit datë 22.3.2024 të ekspertit G.B. Sipas këtij akti rezulton se: *“Duke krahasuar planimetritë e gjendjes faktike të hartuar, krahasuar me planimetritë e vitit 1997, të lëshuara nga ASHK Pogradec, për këto pasuri nuk konstatohet ose nuk ka ndryshime në sipërfaqe dhe në funksion. Në pasurinë nr. *** nuk kemi ndryshime në planimetrinë e ndërtesës. Po t’i referohemi fotografimit ajror 2007 – 2008 (data e fotografimit 13.7.2007) dhe fotografimit ajror 2015 – 2017 (data e fotografimit*

⁵⁶ Për më shumë referojuni parashtrimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti pas kalimit të barrës së provës.

6.7.2015), në pjesën e tarracës kemi një tendë të mbështetur mbi 6 (gjashtë) profile hekuri, me përmasa profile (3x3) cm dhe të mbuluar me plastmasë (polikarboniko) ngjyrë jeshile. Nga pamja kjo tendë është plotësisht e amortizuar. Kjo tendë është bërë mbi tarracë për mbrojtje nga dielli dhe shiu. Kjo tendë nuk hyn në objektet që kërkojnë leje ndërtimi. Pra, kjo tendë nuk krijon volum, por hyn në shpenzime mirëmbajtjeje për banesën. Sot ajo tendë është krejtësisht e amortizuar.

Në lidhje me ortofotot e viteve 2001, 2007 e 2015, sqaroj se:

- Në ortofoton e vitit 2001, unë si ekspert nuk mund të dalloj qartësi të objektit.

- Në ortofoton e vitit 2007 dalloj ndërtesën, ku pjesën e çatisë në anën jugore e kemi të mbuluar me llamarinë, gjendje ekzistuese dhe sot.

- Krahasuar me ortofoton e viteve 2015 – 2019 kemi ndryshim vetëm në tenda (sot e amortizuar plotësisht).

Vlera e tendës plastike me profile hekuri në vitin 2015 është 34,815 lekë”.

118. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, si dhe aktin e ekspertimit, sipas të cilit rezulton se ndryshimi në planimetri vjen nga vendosja e një tende me profile hekuri, si dhe nga vërtetimi faktik nuk rezulton ndryshim në planimetrinë e objektit, vlerëson se provohet që nga ana e subjektit nuk janë kryer investime në këtë pasuri.

118.1 Për sa i përket mosdeklarimit të faktit që kjo pasuri përbëhej nga dy kate në deklaratën *Vetting*, Komisioni vlerëson se kemi të bëjmë me një pasaktësi në deklaram, pasi bashkëshorti i subjektit duhet të deklaronte qartësisht këtë pasuri por, për sa kohë kemi të bëjmë me një pasuri e cila: (i) është e amortizuar; (ii) nuk përdoret më nga subjekti dhe bashkëshorti i saj; (iii) origjina e saj rrjedh nga dëshmia e trashëgimisë; (iv) pjesa takuese e bashkëshortit është ¼; si dhe (v) nuk ngrihen dyshime për fshehje pasurie – çmohet se kjo pasaktësi nuk mund të klasifikohet si deklaram i pamjaftueshëm, në kuptim të nenit 61/3 të ligjit nr. 84/2016.

119. Në përfundim të hetimit, konkludohet se nuk lindin dyshime apo paqartësi në lidhje me këtë pasuri të bashkëshortit të subjektit.

120. Truall⁵⁷ me sipërfaqe 365 m², i regjistruar në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Pogradec, me nr. *** pasurie, i ndodhur në Pogradec, Lagjja Nr. *. Pjesa takuese: ¼.

Burimi i krijimit: “Kjo pasuri është përfituar me trashëgimi nga trashëgimlënësi, babai im P. K, dhe është në bashkëpronësi, ku pjesa ime takuese është ¼”.

Hetimi⁵⁸/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni

121. Me vendimin nr. ***, datë 4.1.1996, “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”, KKKP Bashkia Pogradec ka vendosur të njohë dhe t’i kthejë shtetasit P.K një sipërfaqe trualli prej 365 m², të ndodhur në Gradishtë.

121.1 Mbi bazën e këtij vendimi, në datën 31.1.1996, në Zyrën e Hipotekës Pogradec është kryer regjistrimi i pasurisë truall me sip. 365 m², në bashkëpronësi të trashëgimtarëve K.

⁵⁷ Subjekti ka depozituar: (i) certifikatë për vërtetim pronësie datë 4.4.2005, në ZVRPP-në Pogradec; (ii) vendim nr. ***, datë 4.1.1996, nga Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave.

⁵⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 3.10.2017, e ZQRPP-së, drejtuar ILDKPKI-së.

121.2 Referuar përgjigjes së ZVRPP-së Pogradec, ky truall është regjistruar me nr. pasurie ***, z. k. ***, vol. **, f. ***, në bashkëpronësi të trashëgimtarëve K.

121.3 Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga subjekti i rivlerësimit rezulton se bashkëpronarët K janë pajisur me certifikatë pronësie për pasurinë nr. ***, në datën 4.4.2005.

121.4 Bashkëshorti i subjektit e ka deklaruar këtë pasuri në DPV-në e vitit 2004, me përshkrimin “Truall me sip. 365 m², me vlerë 150,000 lekë, me pjesë në zotërim 25%”.

122. Në përfundim të hetimit, konkludohet se nuk lindin dyshime apo paqartësi në lidhje me këtë pasuri të bashkëshortit të subjektit. Bashkëshorti i subjektit ka kryer deklarim të saktë dhe në përputhje me ligjin.

123. Apartament banimi me sipërfaqe 127 m², i ndodhur në Pogradec, Lagjja Nr. *, rruga “A.X”, porositur sipas kontratës së sipërmarrjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 2.10.2012.

Kjo pasuri është trajtuar gjerësisht në pikën 54 të këtij vendimi.

124. Në përfundim të hetimit, Komisioni ka kryer një analizë financiare⁵⁹ për subjektin e rivlerësimit, duke mos përfshirë gjendjen *cash* në shumën 42,000 USD. Sipas kësaj analize, subjekti rezulton me mungesë burimesh të ligjshme vetëm në vitin 2008, në vlerën - 3,712,027.68 lekë.

125. Në lidhje me këtë barrë prove, subjekti dha të njëjtat shpjegime⁶⁰, sikurse janë trajtuar më lart në këtë vendim. Qëndrimi i Komisionit në lidhje me gjendjen *cash* është trajtuar gjerësisht në pikën 85 të këtij vendimi, për rrjedhojë me përfshirjen e gjendjes *cash* në analizë financiare subjekti rezulton me burime të mjaftueshme për krijimin e pasurive.

Konkluzion i Komisionit për vlerësimin e pasurisë

126. Bazuar në konkluzionet më lart për të gjitha pasuritë e deklaruara të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur, trupi gjykues i Komisionit, në vlerësimin tërësor të kriterit të pasurisë, krijoi bindjen se subjekti i rivlerësimit Luljeta Kolonja ka një nivel të besueshëm për kriterin e pasurisë, pasi nga një vlerësim proporcional dhe objektiv nuk u vërejtën shkaqe, të tilla që të përmbushnin qëllimin e aplikimit të masës disiplinore të shkarkimit nga detyra për efekt të procesit të rivlerësimit kalimtar të subjekteve. Në këtë vlerësim, trupi gjykues u bazua në bindjen e brendshme, pas vlerësimit objektiv të të gjitha pasurive dhe mjeteve monetare të krijuara nga subjekti i rivlerësimit në harkun kohor prej 12 vitesh në funksionin e gjyqtarës, ekzistencën e mjeteve financiare në dispozicion, të cilat përmbushin plotësisht kërkesat e nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe rrethanave specifike të rezultuara nga hetimi administrativ për subjektin Luljeta Kolonja.

127. Komisioni vlerëson të ndalet në lidhje me krijimin e kursimeve të bashkëshortit të subjektit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, të cilat kanë shërbyer për krijimin e llogarive bankare të tij në vitin 2004. Komisioni çmon se periudha në të cilën bashkëshorti i subjektit ka investuar për krijimin e këtyre llogarive bankare ka qenë përtej kohës kur personi i lidhur dhe subjekti ishin në kushtet e bashkësisë ligjore, si dhe kur ata vepronin financiarisht në autonomi të plotë. Trupi gjykues konstaton se pavarësisht problematikave që mund të rezultojnë si pasojë e analizës financiare për provueshmërinë e ligjshmërisë së të ardhurave të personit të lidhur, që

⁵⁹ Referojuni tabelës me emërtimin “Analizë nga fillimi i detyrës deri në deklaratën *Vetting*”.

⁶⁰ Për më shumë referojuni parashtrimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti pas kalimit të barrës së provës.

kanë shërbyer si burime për krijimin e llogarive bankare, nga hetimi administrativ në Komision nuk u ngritën dyshime lidhur me krijimin e këtyre të ardhurave nga aktivitete të kundërligjshme të personit të lidhur. Si rrjedhojë, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk është në kushtet e dënjës dhe të pranimit të faktit që ka pranuar të përdorë të ardhura për të cilat ka ditur se është krijuar nga të ardhura me burime të kundërligjshme, situatë kjo që do ta bënte të cenueshëm besimin e publikut për subjektin e rivlerësimit. Për këto arsye, trupi gjykues, në vlerësim të situatës faktike, çmon se problematikat e konstatuara lidhur me krijimin e llogarive bankare të bashkëshortit të subjektit nuk janë mjaftueshme për të arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarament të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë sipas përcaktimit të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, dhe se ato nuk konsiderohen se mund të mjaftojnë si shkaqe objektive e proporcionale të vendosura në procesin e rivlerësimit kalimtar, për të ngarkuar drejtpërdrejt me masë disiplinore subjektin e rivlerësimit.

128. Në lidhje me problematikat e konstatuara në vlerësimin e kriterit të pasurisë, trupi gjykues çmon se balanca negative e fondeve në vitin 2008, e konstatuar gjatë hetimit administrativ për gjithë periudhën e kontrolluar, vjen për shkak të pasaktësisë në deklaramentet periodike vjetore, e cila vlerësohet nga trupi gjykues si pasaktësi, që nuk është kryer për ndonjë shkak të caktuar, apo të ketë pasur qëllim akumulimin e shumave monetare për krijimin e pasurive, e sidomos të shoqëruara me faktin provues të ekzistencës së saj në llogarinë bankare të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, krijuan bindjen e plotë se është një pasaktësi, që mbetet e veçuar e që nuk mund e nuk duhet të shoqërohet me aplikim penalizues për subjektin e rivlerësimit. Në këtë vlerësim të përgjithshëm, trupi gjykues ka mbajtur në konsideratë edhe faktin se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të janë pronarë të vetëm një apartamenti, pagesa e të cilit është kryer nëpërmjet sistemit bankar dhe është deklaruar saktësisht si në deklarament *Vetting*, ashtu edhe në deklaramentet periodike. Ata nuk ndodhen përpara ndonjërit prej shkaqeve të parashikuara në nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, ku të ngriheshin dyshime të arsyeshme se pasaktësia në deklarament ka qenë e qëllimshme.

129. Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikojë ligjërisht, si dhe ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht në deklarament *Vetting* pasuritë e saj dhe të personave të lidhur me të, siç parashikohet në pikën 1 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

130. Subjekti ka dorëzuar në kohë deklaramentet e pasurisë dhe ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së saj. Nga hetimi ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit nuk është përpjekur të fshehtë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, zotërim ose në përdorim të saj. Kjo do të thotë që në rastin e subjektit të rivlerësimit Luljeta Kolonja nuk vërtetohen shkaqet që Kushtetuta i ka parashikuar të tilla që, nëse vërtetohen, do të zbatoheshin parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit.

131. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit Luljeta Kolonja ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të shkronjës “a” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

B. KONTROLLI I FIGURËS

132. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklaramenteve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të

papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, AKSIK-ja ka dërguar fillimisht një raport me shkresën nr. *** prot., datë 2.11.2017, me konstatimin për përshtatshmërinë në vazhdimin e detyrës.

132.1 Në këtë shkresë, AKSIK-ja shprehet se bashkëshorti i subjektit figuron person me precedent penal kriminal në datën 16.2.2012 nga sektori për Hetimin e Krimit Ekonomik-Financiar në Drejtorinë Vendore të Policisë së Korçës, për veprën penale “Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”.

133. Në vijim, me shkresën nr. *** prot., datë 23.1.2023, AKSIK-ja ka dërguar raportin e përditësuar për subjektin e rivlerësimit, deklasifikuar pjesërisht me vendimin nr. **, datë 30.1.2023, të KDZH-së. Sipas këtij raporti, informacionet e ardhura nga autoritetet verifikuese në kohështirje gjatë periudhës së rivlerësimit bëjnë me dije se për subjektin e rivlerësimit, znj. Luljeta Kolonja, disponohen të dhëna mbi përfshirjen e saj në veprimtari të kundërligjshme, shfaqur në formën e shpërdorimit të detyrës.

133.1 Për rrjedhojë, AKSIK-ja gjykon se konkluzioni për përshtatshmërinë ose jo të subjektit të rivlerësimit mbetet në vlerësimin e Komisionit, nën dritën e informacioneve të tjera që mund të disponohen si pjesë e gjetjeve/konstatimeve të dala nga procedurat e hetimit administrativ që po kryhen ndaj subjektit.

134. Komisioni, si organ i legjitimuar nga Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016 për të bërë rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, ka hetuar në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur⁶¹, ashtu sikurse të gjitha faktet⁶² dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016. Nga hetimi i kryer nga Komisioni nuk ka rezultuar procedim penal⁶³ në emër të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit dhe që subjekti të ketë pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar.

135. Në përfundim të rivlerësimit për kriterin e kontrollit të figurës, Komisionit i rezulton se subjekti i rivlerësimit Luljeta Kolonja arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës sipas parashikimit të nenit 59/1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, pasi nga verifikimet e kryera nuk rezultoi se ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, ka dorëzuar në kohë deklaratën për figurën, si dhe nuk ka bërë deklaratime të pasakta ose nuk ka fshehur kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

136. Vlerësimi i aftësive profesionale nga Komisioni është bazuar në:

- raportin për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit të kryer nga KLGJ-ja;
- kriteret e vlerësimit të parashikuara në nenin 71 e vijues të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

⁶¹ Kthim përgjigje nr. *** prot., datë 5.7.2023, e Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar; kthim përgjigje nr. *** prot., datë 8.5.2023, e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit; kthim përgjigje nr. *** prot., datë 4.7.2023, e Prokurorisë së Rrethit Korçë.

⁶² Shihni dosjen sekrete të subjektit të rivlerësimit.

⁶³ Kthim përgjigje nr. *** prot., datë 4.5.2023 dhe nr. ***prot., datë 23.5.2023, të Prokurorisë së Rrethit Korçë.

- denoncimet e paraqitura pranë Komisionit.

Raporti i hartuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor

137. Ky raport është përgatitur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor si organi ndihmës për vlerësimin profesional, që kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit, bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

138. Hartimi i këtij raporti është bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (i) formularit të vetëdeklarimit, të tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit; (ii) pesë dosjeve gjyqësore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; (iii) të dhënave nga burimet arkivore të KLGJ-së.

139. Raporti ka analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kritereve të vlerësimit: (a) aftësive profesionale; (b) aftësive organizative; (c) etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale; (ç) aftësive personale dhe angazhimit profesional.

140. Nga verifikimi i tri dokumenteve ligjore të depozituara nga subjekti, Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit për një vendim, gjykimin e të cilit është realizuar në shkelje të afatit kohor standard 6-mujor të parashikuar nga neni 5, shkronja “e” e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit. Në lidhje me këtë gjykim, subjekti shpjegoi qartësisht veprimet e saj procedurale, nga analizimi i të cilave rezultoi se kjo vonesë nuk kishte ardhur për shkaqe që vareshin nga subjekti i rivlerësimit, por për nevoja të zhvillimit të gjykimin.

141. Nga analizimi i pesë dosjeve të përzgjedhura me short, subjektin iu kërkuan shpjegime për dosjen nr. 3.

Dosja nr. 3 – Çështja civile me nr. *** regjistri themeltar, datë 18.3.2015 regjistrimi, që u përket palëve: paditëse R.M kundër të paditurit R.M, me objekt “Zgjidhjen e martesës me të paditurin, lënien për rritje dhe edukim të fëmijës mua paditëses, caktim pensioni ushqimor etj., në bazë të nenit 132 e vijues të Kodit të Familjes”, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 7.12.2015. Çështja u regjistrua në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec në datën 13.3.2015 dhe me shortin elektronik të datës 18.3.2015 iu caktua subjektin. Me vendimin e datës 18.3.2015, subjekti caktoi seancën e pajtimit në datën 16.4.2015, ora 09:00. Si pasojë e pamundësisë së njoftimit të të paditurit dhe mungesës së palës paditëse për arsye shëndetësore, subjekti ka zhvilluar 8 seanca pajtimi. Në seancën e datës 11.9.2015 ka vijuar gjykimin në mungesë të të paditurit dhe vendosi kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore, në datën 5.10.2015. Në vijim janë zhvilluar 6 seanca gjyqësore, ku në seancën e datës 7.12.2015 ka vendosur “Pranimin e kërkesëpadisë. Zgjidhjen e martesës midis paditëses R.Dh.M dhe të paditurit R.S.M”, duke marrë paditësjë mbiemrin e saj para martesë etj.”. Vendimi i mësipërm ka marrë formë të prerë pa u ankimuar nga palët.

Dosja gjyqësore dhe vendimi gjyqësor janë dorëzuar në sekretarinë gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Pogradec në datën 17.12.2015, brenda 10 ditëve nga shpallja, pra në respektim të afatit 10-ditor të parashikuar nga neni 308, paragrafi 2 i Kodit të Procedurës Civile.

Gjykimin e çështjes nga subjekti i rivlerësimit ka zgjatur gjithsej 8 muaj e 19 ditë, në intervalin kohor 18.3.2015 – 7.12.2015.

Konstatohet se gjatë procesit gjyqësor u ezauruan gjithsej 14 seanca gjyqësore, nga të cilat vetëm 5 ishin produktive. Shkak për dështimin e 9 seancave ishte pamundësia e gjykatës për njoftimin e të paditurit, pasi nuk dihej adresa e saktë e tij (4 seanca), mungesa e paditëses për shkaqe shëndetësore e familjare (3 seanca), mungesa e gjyqtarës për shkaqe objektive (2 seanca). Subjekti mund të kishte menaxhuar më mirë çështjen në fillim të gjykimit kur, për të evituar shtyrjen e seancave për mungesë të të paditurit, mund të kishte konstatuar padinë me të meta dhe t'i linte detyrë paditëses të gjente adresën e saktë të të paditurit dhe pastaj të kryente njoftimin e tij.

Kohëzgjatja e gjykimit është në tejkalim të afatit standard 4-mujor, të përcaktuar nga pika 5, shkronja “d” e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit. Rrjedhimisht, nuk është respektuar standardi i procesit të rregullt ligjor, i parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së.

Në lidhje me këtë konstatim, subjekti ka listuar⁶⁴ të gjitha veprimet e saj procedurale, duke qartësuar edhe kryerjen e tyre.

Komisioni vlerëson se vonesa në gjykim në këtë rast nuk mund të klasifikohet si mungesë aftësish profesionale, pasi shtyrja e seancave nuk u bë për faj të subjektit dhe është në diskrecion të saj të vendosë në lidhje me gjykimin e çështjes.

TË DHËNA NGA BURIME ARKIVORE TË KLD-së

142. Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave, rezulton se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit, 8.10.2013 – 8.10.2016, për subjektin janë paraqitur 4 ankesa (3 në vitin 2014 dhe 1 në vitin 2016) në Inspektoratin e ish-KLD-së. Ndërkohë që 3 ankesa (2 në vitin 2014 dhe 1 në vitin 2016) janë arkivuar pas shqyrtimit fillestar, me arsyetimin se pretendimet zgjidhen përmes apelimit gjyqësor, 1 ankesë e vitit 2014 verifikuar për mosrespektim formal ligji, i është regjistruar gjyqtarës për efekt vlerësimi profesional dhe etik.

Hetimi i Komisionit

143. Komisioni ka administruar informacionin e paraqitur nga KLGJ-ja⁶⁵, ku evidentohet se nga kontrolli i kryer nga ky institucion, në periudhën 1.1.2006 deri në datën e dërgimit të informacionit 12.2.2021, rezultojnë 25 ankesa në emër të subjektit të rivlerësimit.

143.1 Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga KLGJ-ja, rezulton se pjesa më e madhe e këtyre ankesave lidhet me pretendimet mbi zgjidhjen në themel të çështjeve gjyqësore, të cilat nuk mund të shqyrtoheshin nga Inspektorati i KLD-së dhe, për pasojë, janë arkivuar.

143.2 Komisioni është ndalur në analizimin e ankesave dhe informacioneve periodike të dërguara në KLGJ nga kryetari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, të cilat kanë si objekt mosrespektimin formal të ligjit, zvarritjen e gjykimit etj.

143.3 Nga analizimi i këtyre ankesave ka rezultuar si vijon:

i) Informacioni periodik nr. * prot., datë 30.11.2017, ardhur nga kryetari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec**

Inspektorati i KLD-së, bazuar në urdhrin e verifikimit nr. *** prot., datë 8.2.2017, verifikoi informacionin e paraqitur nga kryetari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, ku raportohet ndër të tjera në lidhje me veprimtarinë gjyqësore të subjektit Luljeta Kolonja për sa i përket

⁶⁴ Për më shumë referojuni parashtrimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti pas kalimit të barrës së provës.

⁶⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 12.2.2021, e KLGJ-së.

gjkimit të çështjes civile me nr. *** regjistri themeltar, datë 1.10.2014, që ka zgjatur mbi 2 vjet. Rezulton se çështja u regjistrua në gjykatë në datën 1.10.2014 dhe po në këtë datë i ka kaluar për gjykim subjektit. Në po të njëjtën datë, kjo çështje i kaloi një tjetër gjyqtari, duke qenë se rezultoi se i njëjti gjykim ishte pushuar më herët nga ai. Në datën 1.12.2014, ky i fundit ka paraqitur dorëheqjen nga gjykimi dhe me shortin e datës 3.12.2014 kjo çështje i kaloi një tjetër gjyqtari, i cili e ka mbajtur në gjykim deri në datën 10.3.2016, kur me vendim është përjashtuar nga gjykimi.

Subjekti e ka mbajtur në gjykim çështjen nga data 17.3.2016 deri më 16.2.2017, në total për një afat 11 muaj, në tejkallim të afatit të parashikuar nga neni 5, shkronja “c” e vendimit të KLD-së “Mbi kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore”, ku afati i parashikuar për këtë kategori çështjesh është 6 muaj, duke u tejkalluar afati standard i gjykimit.

Subjekti pas dërgimit të rezultateve të hetimit ka shpjeguar⁶⁶ të gjitha veprimet procedurale të ndërmarra nga ana e saj në secilën seancë të zhvilluar për këtë proces. Bazuar në deklaratimet e subjektit, çështja ka vijuar edhe përtej datës 16.2.2017, duke përfunduar në datën 4.5.2018.

Nga analizimi i shpjegimeve të subjektit rezulton se të gjitha seancat janë shtyrë për shkaqe objektive, që kanë lidhje me kryerjen e veprimeve procedurale të domosdoshme në funksion të ecurisë së gjykimit, me sjelljen e palëve dhe kompleksitetin e çështjes dhe nuk konstatohet ndonjë mungesë kujdesi nga ana e subjektit në menaxhimin e procesit gjyqësor. Të gjitha veprimet procedurale të kryera prej saj lidhen me gjykimin e çështjes në respektim të kriterëve që lidhen me procesin e rregullt ligjor.

ii) Ankesë datë 14.11.2014 e shtetasit J.A

Ky shtetas i është drejtuar KLD-së me ankesë, me anë të së cilës ngre pretendime lidhur me veprimtarinë gjyqësore të subjektit të rivlerësimit lidhur me fakte që kanë të bëjnë me mosrespektimin formal të ligjit dhe me vendimmarrjen në çështjen, me objekt “Sigurim padie, pezullim i veprimeve përmbarimore”.

Nga verifikimi i kryer nga aktet e dosjes gjyqësore⁶⁷, subjekti me vendimin e datës 8.10.2014 ka vendosur kalimin e çështjes gjyqësore në datën 13.10.2014, brenda afatit 5-ditor. Në këtë seancë rezulton të mos ketë marrë njoftim personi i tretë, zyra përmbarimore, ndërsa palët e tjera kanë qenë të pranishme. Për këtë arsye, seanca është shtyrë në datën 16.10.2014. Në këtë seancë, subjekti u ka komunikuar palëve se autorizimi i paraqitur nga personi i tretë nuk përfshin tagrat për përfaqësimin në çështje me objekt “Sigurim padie”. Në këto kushte, gjykata i ka dhënë kohë personit të tretë të përfaqësohet rregullisht në gjykim dhe ka shtyrë seancën në datën 20.10.2014. Në këtë seancë, subjekti ka vendosur rrëzimin e kërkesës dhe afatin 5-ditor për ankimimin e vendimit.

Nga tërësia e veprimeve procedurale të kryera nga subjekti i rivlerësimit, duket se nuk është respektuar afati 5-ditor i parashikuar nga neni 511/1 i Kodit të Procedurës Civile për shqyrtimin e kërkesës për sigurim padie, pasi vendimi rezulton të jetë dhënë mbas 12 ditësh nga depozitimi i kërkesëpadisë.

⁶⁶ Për më shumë referojuni parashtrimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti pas kalimit të barrës së provës.

⁶⁷ Kopja e dosjes gjyqësore është vënë në dispozicion nga KLGJ-ja.

Pas dërgimit të rezultateve të hetimit, subjekti ka shpjeguar⁶⁸ se sapo e ka marrë çështjen për shqyrtim në datën 8.10.2014, ka marrë vendim në po të njëjtën datë për caktimin e seancës gjyqësore për gjykimin e çështjes brenda afatit 5-ditor, në datën 13.10.2014, ora 10:00.

Referuar përmbajtjes së procesverbaleve të seancave gjyqësore, mosrespektimi i afatit 5-ditor për shqyrtimin e kërkesës për marrjen e masës së menjëhershme për sigurimin e padisë ka ardhur për shkaqe objektive, procedurale, konkretisht për të njoftuar personin e tretë, shoqërinë “P.B.S” sh.p.k., për t’u paraqitur në gjykim, meqenëse nuk kishte dijeni për seancën gjyqësore të datës 13.10.2014, si dhe për t’i lënë kohë kësaj shoqërie për të paraqitur një akt të rregullt përfaqësimi. Nuk ka në rastin konkret shtyrje të seancave pa shkak të përligjur. Rezulton se gjatë këtij procesi gjyqësor janë shtyrë vetëm dy seanca gjyqësore në një interval kohor të shkurtër, përkatësisht 3-ditor dhe 4-ditor dhe vendimi në lidhje me kërkesën për marrjen e masës për sigurimin e padisë është dhënë pas 12 ditësh nga depozitimi i kërkesës.

Komisioni vlerëson se shpjegimet e subjektit janë bindëse dhe se vonesat nuk kanë ardhur si pasojë e mungesës së organizimit nga ana e saj.

iii) Ankesë e shtetasit P.M

Subjekti me vendimin nr. **, datë 9.1.2007, ka vendosur refuzimin e kërkesës së kërkuarit Sh. M, me objekt “Kundërshtimin e vendimit të refuzimit të Zyrës së Përmbarimit Pogradec dhe rivënien në ekzekutim të vendimit nr. ***, datë 20.3.2000, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec”.

Në pjesën argumentuese, subjekti shprehet se kërkuari Sh.M nuk ka cilësinë e kreditorit në fazën e ekzekutimit të detyrueshëm të titullit ekzekutiv në vendimin gjyqësor nr. **, datë 20.3.2000, pasi, duke iu referuar dispozitivit të këtij vendimi të zgjidhjes në themel të çështjes së ngritur nga kërkuari Sh.M, nuk rezulton që të jetë vendosur që dega e AKP-së Pogradec dhe shtetasit Nj.D e K.M, si palë të paditura, të japin diçka ose të kryejnë apo të mos kryejnë një veprim të caktuar në dobi të kërkuarit në këtë gjykim.

Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se:

- a. Në datën 20.3.2000, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec me vendimin nr. *** ka vendosur:
 - Pranimin e padisë së paditësit Sh.M, duke konstatuar si absolutisht të pavlefshme kontratën e shitjes.
 - Detyrimin e degës së AKP-së Pogradec t’i paguajë të paditurit vlerën e trullit dhe objektit të blerë.
 - Fshirjen e regjistrimit nga hipoteka të kontratave të konstatuara absolutisht të pavlefshme.
- b. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec, me vendimin nr. ***, datë 13.4.2001, ka vendosur lëshimin e urdhrit të ekzekutimit për vendimin civil nr. ***, datë 20.3.2000, të kësaj Gjykate.

⁶⁸ Për më shumë referojuni parashtrimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti pas kalimit të barrës së provës.

Bazuar në vendimet e mësipërme, rezulton se paditësi ka qenë shtetasi Sh.M, i cili në rastin në fjalë është edhe kreditor.

Për sa më sipër, duket se subjekti nuk e ka argumentuar vendimin, duke cenuar të drejtën e palës paditëse për ekzekutimin e vendimit.

Pas kalimit të barrës së provës, subjekti ka shpjeguar⁶⁹ se, pavarësisht se shtetasi Sh.M me cilësinë e paditësit ishte gjyqfitues, pjesa urdhëruese e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec nr. **, datë 20.3.2000, nuk i jepte paditësit Sh.M cilësinë e kreditorit në fazën e ekzekutimit të detyrueshëm të vendimit gjyqësor nr. ***, datë 20.3.2000, pasi në dispozitivin e këtij vendimi të zgjidhjes në themel të padisë së ngritur nga ky shtetas, është disponuar për konstatimin si absolutisht të pavlefshëm të dy kontratave të shitjes dhe nuk rezulton të jetë vendosur që dega e AKP-së Pogradec dhe shtetasit Nj.D dhe K.M si palë të paditura të japin diçka ose të kryejnë apo të mos kryejnë një veprim të caktuar në dobi të paditësit Sh.M. Subjekti është shprehur se: *“Në këtë kontekst, në kushtet që kërkuesi Sh.M nuk gëzonte cilësinë e kreditorit në fazën e ekzekutimit të detyrueshëm të vendimit gjyqësor nr. ***, datë 20.3.2000, mendoj se vendimmarrja ime për rrëzimin e kërkesës së kërkuesit Sh.M për kundërshtimin e veprimeve përmbare më është e ligjshme, e bazuar në dispozitat procedurale civile, që normojnë ekzekutimin e urdhrin të ekzekutimit mbi bazën e kërkesës së kreditorit dhe parashikojnë kundërshtimin e veprimeve të përmbareuesit gjyqësor nga palët... vendimmarrja ime është konfirmuar duke u vlerësuar nga Gjykata e Apelit Korçë si e drejtë dhe në përputhje me ligjin. Konkretisht, Gjykata e Apelit Korçë, me vendimin nr. ***, datë 8.11.2007, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. **, datë 9.1.2007. Nga verifikimi i akteve të dosjes rezulton se ndaj vendimit nr. ***, datë 8.11.2007, të Gjykatës së Apelit Korçë, nuk është bërë rekurs në Gjykatë të Lartë, duke u konfirmuar në mënyrë përfundimtare vendimmarrja ime”.*

Bazuar në shpjegimet e subjektit, por edhe duke marrë në konsideratë faktin që kjo çështje është lënë në fuqi nga gjykatat më të larta, Komisioni nuk mund të vijojë më tej me vlerësimin e kësaj çështjeje.

iv) Ankesë e shtetasit S.Y

Nga verifikimi i ankesës konstatohet se subjekti, në datën 17.5.2007, me vendimin nr. *** ka vendosur pushimin e gjykimit, me argumentimin se paditësi dhe përfaqësuesi i posaçëm i tij nuk u paraqitën në seancë gjyqësore pa shkaqe të arsyeshme.

Në pjesën argumentuese të vendimit, subjekti shprehet: *“Gjykata çmon të theksojë se në orën 12:45 të datës 17.5.2007 paditësi S.Y ndodhej në ambientet e Gjykatës, por nuk u paraqit në sallën ku do të zhvillohej gjykimi... Sekretarja e seancës në këtë moment ka njoftuar paditësin për t’u paraqitur në seancë gjyqësore, por ai është përgjigjur: “Nuk vij në seancë, kam avokat dhe lajmëroje ti këtë avokat për të ardhur në seancë”. Në këtë kohë, sekretarja gjyqësore konstatoi se avokati K.R nuk ndodhej në ambientet e Gjykatës”.*

Nga analizimi i argumentimit të subjektit rezulton se pala paditëse është paraqitur në ambientet e gjykatës. Në këto kushte duket se nuk janë plotësuar kërkesat e parashikuara nga neni 179 i Kodit të Procedurës Civile.

⁶⁹ Për më shumë referojuni parashtrimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti pas kalimit të barrës së provës.

Për rrjedhojë, duket se subjekti nuk ka argumentuar vendimin, duke cenuar të drejtën e palës paditëse për një proces të rregullt ligjor dhe brenda një afati të arsyeshëm.

Pas kalimit të barrës së provës, subjekti ka shpjeguar⁷⁰ se nga përmbajtja e vendimit rezulton se në të ajo ka paraqitur faktet me natyrë procedurale dhe veprimet procedurale të kryera lidhur me verifikimin e paraqitjes së paditësit dhe përfaqësuesit të paditësit dhe verifikimin e kryer në sekretarinë e gjykatës, për sa i përket ekzistencës së ndonjë shkakut për mosparaqitje të paditësit dhe përfaqësuesit të paditësit.

Në pjesën arsyetuese janë përshkruar në mënyrë të detajuar faktet lidhur me mosparaqitjen e paditësit dhe përfaqësuesit të tij me të drejta të plota, avokatit K.R, në seancën gjyqësore të datës 17.5.2007, ora 12:30, në sallën ku zhvillohej gjykimi, si dhe është pasqyruar fakti që paditësi dhe përfaqësuesi i tij nuk kishin paraqitur para gjykatës dhe as në sekretarinë e gjykatës ndonjë shkak të arsyeshëm për mosparaqitjen në gjykim deri në orën 13:00, orë deri në të cilën janë pritur dhe është çelur seanca gjyqësore, i vërtetuar ky fakt sipas vërtetimit nr. *** regj., të lëshuar edhe nga kryesekretarja e gjykatës. Gjithashtu, në pjesën arsyetuese të vendimit është pasqyruar se përfaqësuesi i paditësit kishte dijeni rregullisht për ditën dhe orën e seancës gjyqësore nga seanca e mëparshme gjyqësore e datës 9.5.2007, ku kishte qenë i pranishëm.

Në përputhje me nenin 174/2 të Kodit të Procedurës Civile, i cili ka qenë në fuqi në kohën e shqyrtimit të çështjes, sekretarja gjyqësore ka thirrur paditësin për t'u paraqitur në seancë gjyqësore, pra në sallën ku zhvillohej gjykimi, dhe ka kryer verifikimin e paraqitjes së avokatit të paditësit. Sipas nenit 174/2 të Kodit të Procedurës Civile, paditësi dhe përfaqësuesi i tij duhej të zinin vendin përkatës në sallën e gjyqit, por ndërkohë ka rezultuar se paditësi është shprehur se nuk vinte në seancë, duke kërkuar që avokati të lajmërohej nga sekretarja për të ardhur në seancë.

Subjekti deklaroi: *“Bashkëngjitur shpjegimeve, ju paraqes vendimin e Gjykatës së Apelit Korçë nr. ***, datë 26.11.2007, të dhënë në lidhje me ankimin e bërë nga paditësi S.Y ndaj vendimit nr. ***, datë 17.5.2007. Nga verifikimi i akteve të dosjes nuk rezulton që të jetë bërë rekurs në Gjykatën e Lartë ndaj vendimit të Gjykatës së Apelit Korçë nr. ***, datë 26.11.2007”.*

Pasi analizoi shpjegimet e subjektit, Komisioni vlerëson se ato nuk janë bindëse. Referuar vetë shpjegimeve të subjektit, paditësi është paraqitur në seancë, por ka kërkuar prezencën e avokatit të tij, duke u larguar për ta kërkuar.

Komisioni ka analizuar edhe vendimin e Gjykatës së Apelit, të cilit i referohet vetë subjekti. Bazuar në këtë vendim, rezulton se Gjykata e Apelit ka prishur vendimin e dhënë nga subjekti. Gjykata argumenton si më poshtë në lidhje me vendimmarrjen e subjektit: *“Është evident fakti i një nxitimi të pajustificueshëm në marrjen e vendimit të pushimit, kjo për shkak se është vërtetuar që pas verifikimit të palëve vetë paditësi ka qenë i pranishëm në ditën dhe orarin e caktuar nga gjykata. Përpjekja e tij për të siguruar edhe praninë e avokatit, siç ndodh rëndom edhe në procese të tjera gjyqësore, përpjekje kjo që vazhdoi për një kohë të tolerueshme prej 20-30 minutash, nuk duhej ta kishte lejuar Gjykatën të kalonte në ekstrem. Konform nenit 179 të Kodit të Procedurës Civile, ajo ka pasur detyrimin ligjor jo vetëm të fillonte verifikimin, siç ka bërë, por të saktësonte deri në fund arsyen e mosparaqitjes së avokatit, nëse ishte e ligjshme*

⁷⁰ Për më shumë referojuni parashtrimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti pas kalimit të barrës së provës.

apo jo, për më tepër kur vetë paditësi fillimisht ka qenë i pranishëm dhe pas disa minutash mungesë është paraqitur sërish në sallën e Gjykatës”.

Në përfundim, Komisioni vlerëson se në këtë rast subjekti nuk ka vepruar në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, duke shfaqur mangësi në drejtim të aftësive të arsyetimit ligjor sipas parashikimit të nenit 72, pika 3 e ligjit nr. 96/2016.

v) Në lidhje me gjykimin e kësaj çështjeje, nga informacioni i datës 29.9.2008 të inspektorese F.H, konstatohet se subjekti ka zhvilluar 21 seanca gjyqësore në një afat kohor prej 11 muajsh. Një pjesë e seancave janë shtyrë për të marrë informacion nga ZRPP-ja, për t'i dhënë kohë ekspertit për aktin e ekspertimit ose për njoftimin e palëve, edhe pse kanë pasur dijeni.

Subjekti në lidhje me zhvillimin e këtij gjykimi duhet të kishte marrë masë për zhvillimin e seancave gjyqësore, pasi disa prej tyre janë shtyrë për mungesë të organizimit të punës nga ana e subjektit. Për sa më sipër, duket se subjekti ka gjykuar çështjen në tejkalim të afateve ligjore.

Pas dërgimit të rezultateve të hetimit, subjekti ka shpjeguar⁷¹ të gjitha veprimet procedurale të kryera, ku evidentohen përpjekjet e saj për të zhvilluar procesin brenda një afati të arsyeshëm, duke respektuar të drejtat e palëve në gjykim.

Në lidhje me këtë gjykim, rezulton se subjekti ka shtyrë disa herë seancat për njoftimin e palës paditëse, por ndërkohë nuk ka kërkuar paraqitjen e tij forcërisht. Gjithashtu, subjekti në disa raste ka shtyrë seancat gjyqësore për të siguruar praninë e palëve të treta, veprime të cilat tregojnë që çështja nuk është menaxhuar siç duhet nga subjekti. Në përfundim, vlerësohet se subjekti nuk ka marrë të gjitha masat e nevojshme procedurale, duke tejkaluar afatet e gjykimit, por këto veprime të subjektit, duke qenë se kanë pasur për qëllim realizimin e një procesi sa më të rregullt, nuk mund të klasifikohen si mangësi profesionale.

vi) Nga verifikimi i ankesës së shtetasës S.D, konstatohet se subjekti ka gjykuar çështjen në një periudhë kohore 1 vit e 5 muaj, nga data 17.5.2010 deri më 28.10.2011.

Në lidhje me këtë ankesë, subjekti ka sqaruar se⁷²: *“Kohëzgjatja e procesit gjyqësor në tejkalim të afatit kohor standard ka qenë e arsyeshme, kjo konstatuar nga veprimet konkrete procedurale që janë ndërmarrë nga ana ime gjatë gjykimit dhe shkaqet e shtyrjes së seancave. Nga aktet e çështjes civile dhe procesverbalet e seancave përgatitore dhe gjyqësore konstatohet se nuk ka vonesa procedurale të shkaktuara për shkaqe subjektive të miat si gjyqtare. Rezulton se tri seanca gjyqësore nuk janë zhvilluar për shkak të pamundësisë sime objektive, konkretisht për arsye shëndetësore, vërtetuar me raport mjekësor dhe një seancë nuk është zhvilluar për shkak të qenies pushim zyrtar, festa e Bajramit... Të gjitha seancat janë shtyrë për shkaqe objektive, që kanë lidhje me sjelljen e palëve, me kryerjen e veprimeve procedurale të domosdoshme në funksion të ecurisë së gjykimit, me kompleksitetin e çështjes dhe nuk konstatohet ndonjë mungesë kujdesi nga ana ime në menaxhimin e procesit gjyqësor. Të gjitha veprimet procedurale të kryera nga ana ime lidhur me gjykimin e kësaj çështjeje, theksoj se janë në respektim të kriterëve që lidhen me procesin e rregullt ligjor”.*

vii) Nga verifikimi i ankesës së shtetasit R.L, konstatohet se subjekti e ka gjykuar çështjen në një periudhë kohore 1 vit e 1 muaj, nga data 27.4.2010 deri më 9.6.2011.

⁷¹ Për më shumë referojuni parashtrimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti pas kalimit të barrës së provës.

⁷² Për më shumë referojuni parashtrimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti pas kalimit të barrës së provës.

Në lidhje me këtë ankesë, subjekti ka sqaruar se⁷³: *“Kohëzgjatja e procesit gjyqësor në tejkalim të afatit kohor standard ka qenë e arsyeshme, kjo referuar veprimeve konkrete procedurale, që janë ndërmarrë nga ana ime gjatë gjykimit dhe shkaqeve të shtyrjes së seancave.*

Pasi ka marrë çështjen për shqyrtim me shortin e datës 24.3.2010, menjëherë ka marrë vendimin e datës 24.3.2010 për caktimin e seancës përgatitore për gjykimin e çështjes. Bazuar në nenin 171/a të Kodit të Procedurës Civile, gjatë procesit gjyqësor ka marrë masa dhe ka ushtruar të drejtat e përcaktuara nga Kodi i Procedurës Civile për zhvillimin sa më mirë të procesit gjyqësor, për të garantuar ecurinë e gjykimit, kjo në kuadrin e respektimit të të gjitha kriterëve që lidhen me procesin e rregullt ligjor, si një e drejtë e garantuar nga neni 6 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe neni 42 i Kushtetutës... Të gjitha seancat janë shtyrë për shkaqe objektive, të përligjura që kanë lidhje me sjelljen e palëve, me kryerjen e veprimeve procedurale të domosdoshme për ecurinë normale të gjykimit dhe hetimin e plotë dhe të gjithanshëm, me kompleksitetin e çështjes dhe nuk konstatohet ndonjë mungesë kujdesi nga ana ime në menaxhimin e procesit gjyqësor. Të gjitha veprimet procedurale të kryera lidhur me gjykimin e kësaj çështjeje thekson se janë në respektim të kriterëve që lidhen me procesin e rregullt ligjor”.

143.4 Pasi analizoi shpjegimet e subjektit, Komisioni vlerëson se tejkalimi i afatit të gjykimit në të dyja rastet e mësipërme nuk ka ardhur si pasojë e neglizhencës, por ka qenë pasojë e shtyrjes së seancave gjyqësore për arsye të procesit të gjykimit. Në përfundim, në lidhje me këto dy ankesa, nuk rezulton që subjekti të ketë shfaqur mangësi në aspektin e aftësive profesionale.

144. Ministria e Drejtësisë me shkresën nr. *** prot., datë 10.2.2021, informon se ndaj subjektit administrohen 2 ankesa, nga analizimi i të cilave rezulton se:

- Shtetasja L.T ankohet se djali i saj po mbahet pa të drejtë në burg dhe se gjykata ka zhvilluar 30 seanca dhe ende nuk ka dalë me një vendim.

144.1 Në lidhje me këtë ankesë, konstatohet se nga procesverbalet e vëna në dispozicion subjekti ka zhvilluar 14 seanca gjyqësore, nga të cilat vetëm një produktive, ndërkohë të gjitha të tjerat janë shtyrë, pasi:

- në 9 raste, seanca nuk është zhvilluar për mosformim trupi gjykues;
- në 4 raste, seanca nuk është zhvilluar për mosparaqitje të ekspertit.

144.2 Për sa më sipër, duket se subjekti ka tejkualuar afatet e gjykimit, duke mos marrë masat e nevojshme për përfundimin e tij në kohë.

144.3 Pas kalimit të barrës së provës, subjekti ka sqaruar se⁷⁴: *“Në lidhje me marrjen e masave për përfundimin e procesit brenda një afati të arsyeshëm, shpjegoj se në seancat ku ka rezultuar që ekspertja psikiatre ligjore nuk është paraqitur, është vendosur të dërgohet shkresë në Institutin e Mjekësisë Ligjore Tiranë, duke kërkuar marrjen e masave për paraqitjen në gjykim të ekspertes, duke theksuar se ekspertja ishte bërë shkak për shtyrjen e gjykimit. Rezulton se i janë dërguar Institutit të Mjekësisë Ligjore shkresat e datës 28.12.2016, 12.1.2017, 22.2.2017, 9.3.2017, 16.3.2017, 24.5.2017. Në seancën që trupi gjykues është vënë në dijeni të faktit që kërkuesi nuk ishte shoqëruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve në Institutin e Mjekësisë*

⁷³ Për më shumë referojuni parashtrimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti pas kalimit të barrës së provës.

⁷⁴ Për më shumë referojuni parashtrimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti pas kalimit të barrës së provës.

Ligjore me qëllim ekzaminimin e tij, është reaguar, duke disponuar për njoftimin me shkresë të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, duke kërkuar marrjen e masave për të kryer shoqërimin e kërkuarit në Institutin e Mjekësisë Ligjore. Gjithashtu, gjatë procesit gjyqësor i janë dërguar shkresa Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, duke kërkuar vënien në dispozicion të gjykatës dhe të ekspertës psikiatre ligjore të kartelës personale të kërkuarit N.T, kjo në funksion të hartimit të aktit të ekspertimit psikiatrik ligjor. Nga të gjitha aktet e kryera dhe procesverbalet e seancave gjyqësore provohet se nuk ka vonesa procedurale të shkaktuara për shkaqe subjektive të miat si gjyqtare kryesuese. Rezulton se dy seanca gjyqësore nuk janë zhvilluar për shkak të pamundësisë sime objektive, konkretisht për arsye shëndetësore familjare, qenies me raport mjekësor “Kujdes për fëmijën”. Vetëm një seancë gjyqësore është shtyrë për shkak të pamundësisë sime objektive, marrjes pjesë në trajnimin me temë “Të drejtat dhe liritë themelore të personave me aftësi të kufizuara”, të zhvilluar në qytetin e Korçës sipas dhe agjendës së këtij trajnimi”.

Pasi analizoi shpjegimet e subjektit, Komisioni vlerëson se ato janë bindëse, pasi ka provuar se vonesat nuk janë lidhur me organizimin e çështjes gjyqësore nga ana e saj, por për shkak të mosformimit të trupit gjykues ose mosparaqitjes së ekspertës ligjore.

DENONCIME

Për subjektin e rivlerësimit janë administruar 14 denoncime (ku në dy raste janë përsëritur 6 herë) të paraqitura pranë Komisionit. Komisioni i ka kërkuar shpjegime subjektit ose i ka kaluar barrë prove në lidhje me denoncimet si vijon:

145. Denoncime të shtetasve B dhe E.M⁷⁵

Denoncuesit ankohen për vendimmarrje të padrejtë të subjektit të rivlerësimit në çështjen gjyqësore me vendimin nr. (***)-***, datë 11.11.2019, duke pretenduar se përmes kësaj vendimmarrjeje ajo ka favorizuar “viktimën e veprës penale”, i cili ushtronte funksionin e gjyqtarit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

Referuar akteve të vëna në dispozicion nga denoncuesit, rezulton se Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec ka paraqitur në gjykatë kërkesën për dërgimin në gjyq të çështjes penale në ngarkim të të pandehurit (denoncuesit) E.M, si i akuzuar për veprën penale “Kanosja e gjyqtarit”, parashikuar nga neni 317 i Kodit Penal. Gjykimi i kësaj çështjeje është kryer nga subjekti i rivlerësimit Luljeta Kolonja.

Në përmbajtje të vendimit përfundimtar datë 11.11.2019, subjekti ka argumentuar se: *“Viktima e veprës penale ushtron detyrën e gjyqtarit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë dhe ka gjykuar çështjen civile me të paditur denoncuesin E. M, duke dhënë një vendim i cili është lënë fuqi edhe nga Gjykata e Apelit. Pas disa kohësh, gjyqtari i çështjes dhe shtetasi E.M janë ndeshur në qytet dhe ky i fundit ka kanosur seriozisht për vrasje gjyqtarin e çështjes”.*

Subjekti ka çmuar se pretendimi i viktimës për kanosje qëndron dhe ka vendosur deklarinimin e tij fajtor për kryerjen e veprës penale “Kanosja e gjyqtarit” dhe dënimin e tij me gjobë në shumën 150,000 lekë.

⁷⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 4.3.2020; shkresë nr. *** prot., datë 7.2.2020; shkresë nr. *** prot., datë 24.7.2022; shkresë nr. *** prot., datë 22.9.2020; shkresë nr. *** prot., datë 16.9.2020; shkresë nr. *** prot., datë 24.7.2022.

Referuar informacionit të dërguar nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, rezulton se ky vendim është ankimuar dhe çështja ndodhet për gjykim pranë Gjykatës së Apelit Korçë.

Nga analizimi i vendimit konstatohet se subjekti në marrjen e vendimit është bazuar vetëm në deklaratimet e shtetasit B.Sh, ndërkohë që gjatë procesit nuk është administruar asnjë provë për të provuar deklaratimet e tij se shtetasi E.M i kishte thënë se “do të djeg me familje dhe me fëmijë”. Subjekti në vendim pohon faktin se fjalët kanosëse nuk janë shoqëruar nga ana e të pandehurit me ndonjë veprim konkret. Të dy dëshmitarët e pyetur nuk e kanë konfirmuar deklaratimin e kallëzuesit. Shtetasi A.Ç, i cili ka qenë prezent në momentin e pretenduar të kanosjes, ka deklaruar se nuk ka dëgjuar që shtetasi B.Sh të ketë debatuar me të pandehurin.

Për sa më sipër, duket se subjekti nuk e ka argumentuar vendimin.

Pas kalimit të barrës së provës, subjekti ka sqaruar se⁷⁶: *“Në vendimin gjyqësor janë paraqitur në mënyrë të hollësishme rrethanat e faktit të provuara në gjykim nga provat shkresore dhe me dëshmitarë, ku nga trajtimi në tërësi i këtyre rrethanave kam konkluduar se veprimet e të pandehurit përbënin kanosje të gjyqtarit në kuptim dhe interpretim të nenit 317 të Kodit Penal. Si rrethana të vlerësuara në tërësi nga ana ime, në lidhje me vendimmarrjen për deklaratimin fajtor të të pandehurit përmend: gjyqtari B.Sh ka dhënë vendimin gjyqësor nr. *-*** (***) , datë 22.11.2016, duke pranuar padinë e paditësit të kundërpaditur A.Q, të ngritur ndërmjet të tjerash dhe kundër të paditurit kundërpaditës, të pandehurit E.M, si dhe rrëzuar kundërpadinë e ngritur nga i padituri kundërpaditës E.M. Pra, gjyqtari B.Sh ka dhënë një vendim gjyqësor në ushtrim të detyrës së tij, vendim i cili nuk është në favor të të pandehurit; i pandehuri nuk ka qenë dakord me vendimin gjyqësor të dhënë nga gjyqtari B.Sh, vendim që i është nënshtruar kontrollit gjyqësor mbi bazën e ankimit të të pandehurit dhe është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Korçë; i pandehuri, për shkak të dhënies së vendimit gjyqësor nga gjyqtari B.Sh, në të cilin ka qenë gjyqumbës, e ka nxjerrë gjyqtarin në emisionin investigativ “STOP”; viktima, gjyqtari B.Sh, ka deklaruar gjatë dëshmisë së tij se i pandehuri në datën 8.9.2018, me një zë të ulët që dëgjohej vetëm nga viktima, me një gjysmë buzëqeshje, i është drejtuar me fjalët “do të djeg me familje dhe me fëmijë, sepse the vetë që kam dhënë vendim të gabuar”; i pandehuri në datën 8.9.2018 i është drejtuar gjyqtarit B.Sh me fjalë pikërisht lidhur me dhënien e vendimit gjyqësor jo në favor të tij, kjo sipas deklaratimeve të dëshmitarit M.H, i cili nuk i ka dëgjuar fjalët; i pandehuri ka deklaruar në pyetjen e tij se ditën e ngjarjes i ka thënë viktimës fjalët “s’je njeri i mirë, sa lekë more”, ku ka theksuar se i ka thënë viktimës “s’je njeri i mirë”, pasi nuk i pëlqente viktima, ndërsa fjalët “sa lekë more” i ka thënë pasi viktima kishte në dorë banane, ndërkohë që fjalën banane nuk e ka përmendur. Në analizën në tërësi të rrethanave të përmendura, në vlerësim të provave shkresore dhe me dëshmitarë, duke u nisur nga mekanizmi i ngjarjes, thënia e fjalëve me përmbajtje kanosëse viktimës gjyqtar nga i pandehuri me një zë të ulët, që dëgjohej vetëm nga viktima, kam krijuar bindjen se janë plotësisht të vërteta dhe reale deklaratimet e viktimës, se i pandehuri për shkak të dhënies së një vendimi gjyqësor civil jo në favor të tij e ka kanosur viktimën për jetën e tij dhe të anëtarëve të familjes së tij me fjalët “do të djeg me familje dhe me fëmijë”.*

Pasi analizoi shpjegimet e subjektit, Komisioni vlerëson se ato nuk janë bindëse. Sikundër sqaron edhe subjekti, nga provat me dëshmitarë nuk provohet që i pandehuri të ketë kanosur

⁷⁶ Për më shumë referojuni parashtrimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti pas kalimit të barrës së provës.

shtetasin B.Sh, pasi shprehja “*nuk je njeri i mirë*” nuk mund të klasifikohet si kërcënim, për më tepër gjatë procesit gjyqësor nuk rezultoi të jetë administruar ndonjë provë që të provojë deklarin e viktimës. Në dhënien e vendimit, subjekti është mbështetur vetëm në deklarin e viktimës dhe në asnjë provë tjetër, duke shfaqur mangësi në drejtim të aftësive të arsyetimit ligjor sipas parashikimit të nenit 72, pika 3 e ligjit nr. 96/2016.

i) Në denoncimin nr. *** prot., datë 7.2.2020, denoncuesit pretendojnë gjithashtu për zbatim të gabuar të ligjit nga subjekti i rivlerësimit në dhënien e vendimit nr. (**)-**, datë 20.9.2019, ku objekt gjykimi ka qenë kërkesa e shtetasit B.M “Për përjashtimin e gjyqtarit të çështjes nga gjykimi i çështjes penale – ankim ndaj mosfillimit të procedimit penal, regjistruar në datën 17.7.2019”. Sipas denoncuesit, gjyqtari i çështjes ka gjykuar dhe ka dhënë vendim për një çështje ku palë ka qenë E.M.

Në lidhje me këtë vendimmarrje të subjektit nuk vërehen fakte apo rrethana që mund të përbëjnë provë në lidhje me kriterin e vlerësimit profesional të subjektit të rivlerësimit.

ii) Në denoncimet nr. ***, datë 10.10.2023 dhe nr. ***, datë 27.9.2023, denoncuesi pretendon se subjekti nuk ka zbardhur ende një vendim të dhënë në datën 26.6.2023.

Për sa më sipër, duket se subjekti nuk e ka zbardhur brenda afateve ligjore vendimin.

Pas kalimit të barrës së provës, subjekti ka sqaruar se⁷⁷: “*Shtetasi B.M ka qenë palë me cilësinë e kallëzuesit në çështjen penale me kërkuese Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, me objekt “Pushimin e çështjes penale nr. *** të vitit 2020, për veprat penale “Ekspertimi i rremë”, parashikuar nga neni 309 i Kodit Penal dhe “Falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal”. Në lidhje me këtë çështje penale, unë kam dhënë vendimin nr. *** (** SP), datë 26.6.2023, me anë të të cilit kam vendosur pranimin e kërkesës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, pushimin e çështjes penale nr. ***, viti 2020, për veprat penale “Ekspertimi i rremë” dhe “Falsifikimi i dokumenteve”, të parashikuara nga nenet 309 dhe 186 të Kodit Penal. Vendimi penal nr. *** (** SP), datë 26.6.2023, është dorëzuar i arsyetuar në datën 24.10.2023, pasqyruar data e dorëzimit në fletën përkatëse të regjistrimit për dorëzimin e dosjeve”.*

Subjekti gjithashtu ka shpjeguar se: “*Vonesa në dorëzimin e vendimit gjyqësor të arsyetuar është shkaktuar vetëm për shkaqe objektive të ligjshme, si:*

- *Ngarkesa e lartë e numrit të çështjeve që kam pasur për shqyrtim, çështje të mbartura që nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec, siç edhe duket nga formati i raportimit tremujor i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, i datës 22.1.2024.*

- *Zhvillimi i disa seancave të mbajtura në audio për periudhën nga data 26.6.2023 (data e dhënies së vendimit gjyqësor) deri më 30.6.2023, gjatë muajit korrik të vitit 2023 dhe gjatë muajit tetor të vitit 2023, konkretisht deri në datën 23.10.2023, kjo referuar informacioneve mbi çështjet gjyqësore sipas sistemit ICMIS të muajve qershor 2023, korrik 2023 dhe tetor 2023.*

- *Qenia gjyqtare e gatshme, e angazhuar për shqyrtimin e kërkesave penale, kërkesave dhe kërkesëpadive civile të karakterit urgjent për periudhën nga data 26.6.2023 – 2.7.2023 dhe për periudhën nga data 2.10.2023 – 8.10.2023, referuar urdhrit nr. ** prot., datë 7.6.2023, “Mbi*

⁷⁷ Për më shumë referojuni parashtrimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti pas kalimit të barrës së provës.

*planifikimin e gjyqtarëve të gatshëm për gjykimin e kërkesave penale dhe civile” dhe urdhrin nr. *** prot., datë 16.10.2023, “Për një ndryshim në urdhrin nr. *** prot., datë 14.9.2023 “Mbi planifikimin e gjyqtarëve të gatshëm për gjykimin e kërkesave penale dhe civile” të zv.kryetarit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë.*

- Qenia me leje vjetore në muajin gusht të vitit 2023.

- Angazhimi me dhënien e përgjigjeve në kuadër të procesit të rivlerësimit për periudhën nga data 7.9.2023 – 23.9.2023, në lidhje me pyetësonin nr. 1 të dërguar nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit”.

Pasi analizoi provat dhe shpjegimet e subjektit, Komisioni vlerëson se nga ana e saj, pavarësisht ngarkesës në punë, duhej të kishte treguar kujdes për të zbardhur brenda afateve ligjore vendimin.

146. Denoncim i shtetasit D.H⁷⁸

Denoncuesi ankohet lidhur me vendimmarrjen e subjektit të rivlerësimit në dy gjykime, në të cilat ka qenë palë në proces djali i tij, D.H.

i) Për çështjen e parë gjyqësore, ai pretendon se subjekti ka vendosur në mënyrë të padrejtë shpalljen fajtor dhe dënimin e shtetasit D.H për kryerjen e veprës penale “Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve”. Denoncuesi shprehet se procesi penal ka përfunduar në datën 31.5.2022 dhe, deri në datën e depozitimit të denoncimit (25.7.2022), gjyqtarja e çështjes nuk ka zbardhur ende vendimin e arsyetuar, duke i mohuar kështu të drejtën e ushtrimit të ankimit ndaj këtij vendimi.

Komisioni ka administruar një kopje të këtij vendimi, nga përmbajtja e të cilit rezulton se ai është shpallur nga subjekti i rivlerësimit në datën 31.5.2022.

Referuar shënimit të sekretarisë, vendimi është ankimuar nga i pandehuri dhe dosja është dërguar në Gjykatën e Apelit Korçë, në datën 19.9.2022.

Për sa më sipër, duket se vendimi i arsyetuar është dorëzuar në sekretari nga subjekti i rivlerësimit, jashtë afatit 15-ditor të parashikuar nga neni 382 i Kodit të Procedurës Penale⁷⁹.

Në lidhje me këtë ankesë, subjekti ka sqaruar se⁸⁰: “Vendimi penal nr. (***)-***, datë 31.5.2022, është dorëzuar i arsyetuar në datën 29.7.2022, pasqyruar data e dorëzimit në fletën përkatëse të regjistrit për dorëzimin e dosjeve”.

Në lidhje me vonesën e dorëzimit të vendimit të arsyetuar, subjekti ka shpjeguar: “Ngarkesa e lartë e numrit të çështjeve që kam pasur për shqyrtim gjatë vitit 2022, ku theksoj se në këtë vit kam përfunduar 609 çështje, si dhe pasqyrohet në formularin nr.* “Ngarkesa e gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, vjetore, viti 2022”.

Zhvillimi i një numri të lartë të seancave të mbajtura në audio (seanca lehtësisht të verifikueshme, përderisa janë mbajtur në audio) nga ora 09:00 deri në orën 15:00 gjatë ditëve të punës, për periudhën nga data 31.5.2022 (data e dhënies së vendimit) dhe deri në afërsi të

⁷⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 27.7.2022.

⁷⁹ Neni 382 i Kodit të Procedurës Penale përcakton se: “Kur vendimi shpallet i përmbledhur, ai arsyetohet i plotë brenda 30 ditëve nga shpallja e tij. Kur personi i dënuar është në masë sigurimi personal, sipas neneve 237 dhe 238 të këtij Kodi, vendimi arsyetohet brenda 15 ditëve nga data në të cilën është shpallur...”.

⁸⁰ Për më shumë referojuni parashtrimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti pas kalimit të barrës së provës.

datës që është zbardhur vendimi, siç dhe duket nga kalendari i planifikimit të gjykimeve i vitit 2022.

Qenia gjyqtare e gatshme, e angazhuar për shqyrtimin e kërkesave penale dhe kërkesave/kërkesëpadive civile të karakterit urgjent për periudhën nga data 16.6.2022 — 30.6.2022 dhe për periudhën nga data 16.7.2022 dhe deri në datën 28.7.2022, referuar urdhrin nr. 3 prot., datë 10.1.2022, “Mbi planifikimin e gjyqtarëve për gjykimin e kërkesave të palëve gjatë fazës së hetimeve paraprake, të kërkesëpadive me objekt lëshim i urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes/lëshim i urdhrin të mbrojtjes, të kërkesave civile /penale me objekt përjashtim gjyqtari dhe të personelit administrativ”, pikës 1 të zv.kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec.

*Qenia e deleguar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan për gjykimin e çështjes penale në ngarkim të të pandehurve A.F dhe K.I, të akuzuar për kryerjen e veprës penale “Falsifikimi i akteve të gjendjes civile”, sipas vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. ***, datë 25.6.2021, ku kam pasur Seanca të planifikuara për gjykim në muajt qershor dhe korrik të vitit 2022, siç edhe duket tek kalendari i planifikimit të gjykimeve. Për këtë çështje kam dhënë vendimin e datës 11.11.2022”.*

Pasi analizoi provat dhe shpjegimet e subjektit, Komisioni vlerëson se vonesa në zbardhjen e vendimit ka ardhur për shkaqe objektive, duke marrë në konsideratë edhe kohën e zbardhjes së saj.

ii) Për çështjen e dytë gjyqësore, denoncuesi shprehet se sërish subjekti i rivlerësimit nuk ka zbardhur në kohë vendimin përfundimtar. Edhe në këtë rast, denoncuesi pretendon se subjekti ka disponuar në mënyrë të padrejtë me dënimin e djalit të tij me 16 muaj burg, për kryerjen e veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, duke mos marrë në konsideratë provat e depozituara nga avokati i tij mbrojtës.

Komisioni ka administruar kopjen e këtij vendimi, nga përmbajtja e të cilit rezulton se ai është shpallur nga subjekti i rivlerësimit në datën 2.3.2023. Rezulton se edhe në këtë rast është proceduar me gjykim të shkurtuar, pasi të pandehurit kanë pranuar fajësinë. Referuar shënimit të sekretarisë, vendimi është ankimuar nga i pandehuri dhe dosja është dërguar në Gjykatën e Apelit Korçë, në datën 7.10.2022.

Referuar datës së dërgimit të dosjes në Gjykatën e Apelit, duket se vendimi i arsyetuar është dorëzuar në sekretari nga subjekti i rivlerësimit jashtë afatit 15-ditor të parashikuar nga neni 382 i Kodit të Procedurës Penale.

Në lidhje me këtë ankesë, subjekti ka sqaruar se⁸¹: “Vendimi penal nr. (***)-**, datë 2.3.2022, është dorëzuar i arsyetuar në datën 6.9.2022, pasqyruar data e dorëzimit në fletën përkatëse të regjistrit për dorëzimin e dosjeve”. Më pas, subjekti ka vijuar duke dhënë të njëjtat argumente si më lart.

Pasi analizoi shpjegimet dhe provat e subjektit, Komisioni vlerëson se në këtë rast subjekti nuk ka zbardhur në kohë vendimin, duke tejkuluar afatet. Është e vërtetë që subjekti ka pasur ngarkesë në punë, por kjo ngarkesë nuk justifikon faktin që një vendim i muajit mars të zbardhet më vonë se një vendim i muajit maj, sikundër ka vepruar subjekti.

⁸¹ Për më shumë referojuni parashtrimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti pas kalimit të barrës së provës.

147. Denoncim i shtetasit I.Z⁸²

Ky shtetas ankohet lidhur me vonesën në zbardhjen e vendimit përfundimtar nga subjekti i rivlerësimit. Ai shprehet se procesi gjyqësor në të cilin është shpallur fajtor për kryerjen e veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, ka përfunduar në datën 2.3.2022 dhe, deri në datën e paraqitjes së denoncimit (30.8.2022), vendimi i arsyetuar nuk është zbardhur nga subjekti. Ankesa e këtij shtetasi është trajtuar në pikën 146/ii) më lart, pasi kemi të bëjmë me të njëjtin vendim gjyqësor.

NË LIDHJE ME TË DHËNAT NGA BURIME TË HAPURA

148. Komisioni ka konstatuar një artikull⁸³ në media, nga ku pretendohet se subjekti prej më shumë se 1 viti nuk ka zbardhur vendimet e ndërmarra në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec.

148.1 Komisioni i ka kërkuar subjektit të japë shpjegime, si dhe të depozitojë listën e vendimeve të marra për vitin 2023, shoqëruar me fletën e regjistrit të protokollit, ku të dalë qartë data e marrjes së vendimit, si dhe data e zbardhjes së tij, pasi duket se ajo ka tejkaluar afatet e zbardhjes së vendimeve.

148.2 Në lidhje me këtë konstatim, subjekti ka sqaruar se⁸⁴ vonesat në arsyetimin e vendimeve gjyqësore janë ndikuar nga rrethana objektive të ligjshme, si vijon: “Ngarkesa e lartë e numrit të çështjeve që kam pasur për shqyrtim, e zgjatur në kohë.

Numri i vogël i gjyqtarëve në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec ndër vite, ku theksoj se organika ka qenë 4 gjyqtarë, por faktikisht ngarkesa e çështjeve një pjesë të madhe të kohës ndër vite është përballuar nga unë dhe një gjyqtar tjetër.

*Qenia gjyqtare e gatshme, e angazhuar për shqyrtimin e kërkesave penale të karakterit urgjent për vleftësimin e arrestimeve në flagrancë dhe ndalimeve, caktimin e masave të sigurimit me karakter personal dhe pasuror dhe të çdo kërkesë tjetër në fazën e hetimeve paraprake, si dhe të kërkesave/kërkesëpadive civile të karakterit urgjent për lëshimin e urdhrat të menjëhershëm të mbrojtjes dhe lëshimin e urdhrat të mbrojtjes për çdo muaj ndër vite, nga një javë në muaj, si dhe dy javë në muaj gjatë periudhave që kemi qenë dy gjyqtarë. Theksoj periudhën nga muaji shkurt i vitit 2022 deri në fund të muajit prill të vitit 2023, gjatë së cilës kam qenë gjyqtare e gatshme dy javë çdo muaj. Kjo rrethanë vërtetohet nga urdhrat mbi planifikimin e gjyqtarëve për gjykimin e kërkesave të palëve gjatë fazës së hetimeve paraprake dhe të personelit administrativ nr. * prot., datë 1.2.2016, nr. ** prot., datë 30.12.2016, nr. * prot., datë 6.3.2017, nr. * prot., datë 15.2.2018, nr. * prot., datë 15.1.2020, nr. * prot., datë 1.1.202, të kryetarit të Gjykatës dhe urdhri nr. * prot., datë 10.1.2022, i zv.kryetarit të Gjykatës, bashkëngjitur.*

Zhvillimi i një numri të lartë të seancave të mbajtura në audio (seanca lehtësisht të verifikueshme përderisa janë mbajtur në audio), nga ora 09:00 deri në orën 15:00, gjatë viteve 2021, 2022 dhe 2023, si dhe konfirmohet nga kalendari i planifikimit të gjykimeve të këtyre viteve.

Qenia ime e infektuar me COVID-19 dy herë gjatë vitit 2021, ku kam kryer periudhën e karantinimit nga data 2.3.2021 deri në datën 18.3.2021 dhe për periudhën nga data 12.8.2021

⁸² Shkresë nr. *** prot., datë 1.9.2022.

⁸³ <https://prapaskena.com/2024/01/30/pse-eshte-harruar-ne-vetting-gjyqtarja-matrapaze-e-korces-luljeta-kolonja-kush-po-e-mbron/>

⁸⁴ Për më shumë referojuni parashtrimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti pas kalimit të barrës së provës.

deri në datën 27.8.2021, kjo sipas vërtetimit nr. *** prot., datë 13.3.2024, të lëshuar nga njësia vendore e kujdesit shëndetësor Pogradec.

Nisur nga rrethanat e mësipërme, ju shpjegoj se vonesat në arsyetimin e vendimeve gjyqësore kanë qenë të kushtëzuara vetëm nga shkaqe objektive dhe jo nga veprimtaria ime, pasi gjithmonë i kam kushtuar rëndësi arsyetimit të vendimeve gjyqësore, cilësisë së arsyetimit, ku kjo duket dhe nga fakti që gjatë gjithë periudhës së ushtrimit të detyrës nuk kam pasur kërkesa për ndreqjen e vendimeve gjyqësore, për sqarimin apo interpretimin e vendimeve gjyqësore që kam dhënë. Gjithashtu, theksoj se vonesat në arsyetimin e vendimeve gjyqësore në kushtet aktuale përbëjnë një problematikë për gjyqtarët, kjo ndikuar nga ngarkesa në numër çështjesh dhe numri i vogël i gjyqtarëve në gjykata. Në lidhje me vonesat në arsyetimin e vendimeve gjyqësore si pjesë e procesit të rregullt ligjor, i referohem edhe qëndrimit të mbajtur së fundmi nga Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 68, datë 7.12.2023, në pikat 36 dhe 37, ku kjo Gjykatë thekson: “36. Duke i analizuar treguesit e mësipërm, Gjykata çmon se vonesa në gjykimin e çështjes së kërkueses është pasojë e ngarkesës së lartë në Gjykatën Administrative të Apelit dhe të gjyqtarës relatores, shkaktuar nga zbatimi i reformës në drejtësi. Kjo gjendje është duke zgjatur prej disa vitesh dhe metodat e identifikuara nga vetë gjykatat dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor, në cilësinë e organit kushtetues, që ka përgjegjësinë për të siguruar mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor (neni 147, pika 1 e Kushtetutës), tregojnë se mekanizmat e parashikuar nga nenet e Kodit të Procedurës Civile i shërbejnë një kohe normale të veprimtarisë gjyqësore, pra jo situatës së jashtëzakonshme, në pikëpamje të volumit, që ndodhet tashmë sistemi i drejtësisë. 37. Gjykimi përtej afatit të arsyeshëm, bazuar vetëm në faktin se shteti ka dështuar të marrë masa efikase, nuk mund të përliqjë cenimin e të drejtave kushtetuese të individëve, në kushtet kur mbingarkesa në gjykata tashmë është një situatë e njohur dhe e zgjatur në kohë, e cila nuk varet nga individët. Në këtë pikë, Gjykata evidenton se sjellja e autoriteteve shtetërore, në veçanti e atyre që miratojnë ligjet dhe politikat e sistemit të drejtësisë, nuk është në nivelin e duhur të efikasitetit, pasi bën të nevojshme ndërhyrje të mëtejshme, veçanërisht legislative, për të shmangur vonesat e paarsyeshme të gjykimin të çështjeve në gjykata, në kushtet kur mjetet ligjore ekzistuese nuk i përgjigjen situatës aktuale”.

148.3 Subjekti ka depozituar listën e vendimeve të dhëna së bashku me fletën e protokollit të dorëzimit të tyre në sekretari.

148.4 Nga dokumentacioni i depozituar nga subjekti vërehen vonesa në zbardhjen e vendimeve. Këto vonesa kanë ardhur edhe si pasojë e ngarkesës në punë të subjektit, ku konstatohet se ajo ka gjykuar një numër të konsiderueshëm çështjesh gjyqësore, si dhe ka qenë në fazë transferimi, pasi Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec është mbyllur dhe subjekti është transferuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë.

149. Komisioni ka konstatuar një artikull⁸⁵ në media, ku pretendohet se subjekti ka fshehur një aksident automobilistik, duke mos e raportuar në polici, edhe pse ishte vetë e pranishme dhe dëshmitare e këtij incidenti. Për më tepër, nuk ka raportuar në polici situatën konfliktuale deri në përplasje fizike mes dy personave të përfshirë në aksident. Kjo pasi ka pasur arsye për të fshehur një situatë të tillë, ku ishte vetë dëshmitare dhe i përfshirë në këtë rast ka qenë bashkëshorti i saj, z. G.K.

⁸⁵ <https://sot.com.al/aktualitet/burri-pesoi-aksident-me-makine-dhe-kercenoi-te-demtuarin-si-gjyqtarja-i639752>

149.1 Në lidhje me këtë artikull, subjekti ka sqaruar se⁸⁶: *“Nuk ka ndodhur asnjëherë aksident automobilistik ku të ketë qenë i përfshirë si shkaktar i aksidentit bashkëshorti im dhe nuk ka pasur asnjë lloj situatë konfliktuale apo përplasje fizike mes bashkëshortit tim dhe ndonjë personi konkret. Theksoj se nuk ka asnjë provë apo indicie në lidhje me sa është përmendur në artikullin në fjalë”*.

Nga hetimi i Komisionit nuk ka rezultuar i provuar pretendimi i ngritur në këtë artikull.

150. Komisioni ka konstatuar se në një emision investigativ⁸⁷ është trajtuar një material, sipas të cilit subjekti ka dhënë vendimin në datën 17.12.2021 ku, edhe pse kanë kaluar më shumë se 6 muaj, ajo nuk ka zbardhur ende vendimin.

150.1 Në lidhje me këtë artikull, subjekti ka sqaruar se⁸⁸ vendimi është zbardhur në datën 20.6.2022, si dhe ka justifikuar vonesën me arsyet si më sipër. Në këtë pikë, subjekti ka shpjeguar se kjo vonesë ka ardhur edhe për shkaqe familjare, pasi disa ditë pas dhënies së vendimit gjyqësor, datë 17.12.2021, ka pasur një fatkeqësi familjare, ka ndërruar jetë nëna e saj në mënyrë të papritur, siç edhe konstatohet nga certifikata e vdekjes datë 13.9.2023 (sipas certifikatës, ndërruar jetë në datën 28.12.2021).

150.2 Pasi analizoi shpjegimet e subjektit, si dhe provat e paraqitura prej saj, Komisioni vlerëson se ato nuk janë të mjaftueshme për të justifikuar një vonesë më shumë se 6 muaj për zbardhjen e një vendimi, i cili për më tepër duhej të ekzekutohej nga zyra e përmbarimit, në mënyrë të tillë që kërkuesi të realizonte të drejtat e tij. Në lidhje me ngarkesën në punë, kjo është një rrethanë e cila mund të merret në konsideratë, por që nuk justifikon këtë vonesë në zbardhjen e vendimit. Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit duhej të ishte treguar më e kujdesshme në lidhje me respektimin e afatit të zbardhjes së vendimit, duke treguar se sjellja e saj në disa raste nuk ka qenë në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e nenit 74 të ligjit nr. 96/2016, lidhur me aftësitë organizative të një gjyqtari.

Konkluzion i Komisionit për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale

151. Pas shqyrtimit të raportit të hartuar nga KLGJ-ja, denoncimeve të depozituara në Komision dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, si më sipër, trupi gjyqësor vëren se nuk mund të ngrihen dyshime për paaftësi profesionale apo cilësi që cenojnë figurën e gjyqtarit.

152. Në përfundim të vlerësimit të kriterit të aftësive profesionale, trupit gjyqësor i rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale. Pavarësisht nga ky konstatim, si dhe nga sa u përshkrua më sipër, rezultoi se sjellja e subjektit të rivlerësimit në disa raste nuk ka qenë në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e nenit 74 të ligjit nr. 96/2016 dhe nenit 72 të ligjit nr. 96/2016. Si rrjedhojë e sa më sipër, Komisioni vlerëson se problematikat e konstatuara nuk ngrihen në nivelin e shkakut që e bëjnë subjektin e rivlerësimit të papërshtatshëm në kuptim të nenit 44, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016, për të justifikuar vendosjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, sipas parashikimeve të nenit 61, pika 4 e këtij ligji.

⁸⁶ Për më shumë referojuni parashtrimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti pas kalimit të barrës së provës.

⁸⁷ <https://youtu.be/44X2eUK3zSA>

⁸⁸ Për më shumë referojuni parashtrimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti pas kalimit të barrës së provës.

153. Për sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të shkronjës “c” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

KONKLuzion Përfundimtar

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatores së çështjes, dëgjoji subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha shpjegimet dhe provat e parashtruara prej saj, konkludon se subjekti:

- a. arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. ka një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

Për këto arsye,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, referuar në nenin 4, pika 2, nenin 58, pika 1, shkronja “a”, si dhe në nenin 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Luljeta Kolonja, gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të arsyetuar.
4. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, në datën 05.04.2024.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Roland ILIA
Kryesues

Genta Tafa (BUNGO)
Relatore

Suela ZHEGU
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Etmonda Hoxha

